

**Vllado Gërçarevski
Jasna Baçovska**

BAZAT E TË DREJTËS

VITI IV

të arsimit të mesëm profesional

Shkup, 2014

Autorë:

Vllado Gërņçarevski
Jasna Baçovska

Recensentë:

Jadranka Daboviç Anastasovska
Ana Axhievska
Pandorka Josifovska

Përkthyes:

Xheladin Memeti

Redaksia profesionale:

Doc. Dr. Afrim Osmani

Lektore:

Arjeta Çajlani

Botuesi: Ministria e arsimit dhe shkencës e Republikës së Maqedonisë

Shtypi: Graficki centar dooel, Shkup

Me vendim nr. 22-1371/1 nga 14.06.2012 të Komisionit kombëtar për libra, lejohet përdorimi i këtij libri.

CIP- Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека „Св. Климент Охридски“, Скопје

34 (075.3)

ГРНЧАРЕВСКИ, Владо

Основи на правото: избран предмет: IV година средно стручно образование-профил правен техничар / Владо Грнчаревски, Јасна Бачовска.
-Скопје: Министерство за образование и наука на Република Македонија,
2013. - 189 стр. : илустр. ; 26 см

ISBN 978-608-226-354-0

1. Бачовска, Јасна [автор]

COBISS.MK-ID 91873034

PARATHËNIE

Libri i titulluar si “Bazat e të drejtës” është pjesë e përzgjedhur dhe relativisht specifike, ku janë përfshirë përmbajtjet e lëndës bazat e të drejtës për nxënësit nga viti i katërt të arsimit të mesëm profesional për drejtimin ekonomik, juridik dhe tregtar.

Gjatë konceptimit dhe shkrimit të librit, llogaritej edhe në aspektet shkencore dhe pedagogjike.

Nga aspekti shkencor, libri ofron njohuri të plota teorike për problematikën përkatëse, gjegjësisht shtetin dhe të drejtën dhe njohuri për rëndësinë dhe rolin e këtyre kategorive.

Nga aspekti pedagogjik, prioritet ishte stili i thjeshtë në prezantimin e problematikës së lëndës, duke i marrë parasysh njohuritë dhe informatat eventuale paraprake, para së gjithash laike, të nxënësve të kësaj moshe për shtetin dhe të drejtën. Pasi libri i dedikohet arsimit të mesëm profesional, edhe atë drejtimin ekonomik, juridik dhe tregtar, ku nevojitet tejkallim më i gjerë i materies juridike dhe praktikisht arsimim juridik i nxënësve në një mënyrë dinamike, gjegjësisht përmes shembujve dhe krahasimeve, janë prezantuar njohuri specifike dhe të zgjeruara për të drejtën dhe shtetin.

Libri është strukturuar në mënyrën vijuese: hyrje, pjesë e parë e titulluar “shteti” dhe pjesë e dytë e titulluar “e drejta”.

Pjesa hyrëse përmban përcaktim kuptimor të shtetit dhe të së drejtës dhe të dhëna bazike për zhvillimin historik të shtetit dhe të drejtës. Hyrja në fakt ofron përgjigje të pyetjeve: çfarë është shteti dhe çfarë është e drejta?

Në pjesën e parë të këtij libri të emërtuar "SHTETI" janë përfshirë përmbajtjet në lidhje me përcaktimin e shenjave të shtetit, organizimin e pushtetit shtetëror, formën e sundimit të së drejtës, regjimin politik dhe rregullimin shtetëror.

Pjesa e dytë e emërtuar "E DREJTA" i përfshin përmbajtjet e ndërlidhura me të drejtën. Kjo pjesë u mundëson nxënësve njohje me esencën e normave shoqërore për sjelljen e njerëzve në përgjithësi dhe të normave juridike konkretisht. Në kuadër të kësaj pjese elaborohet i tërë sistemi kategorial i të drejtës, si: rendi juridik, aktet juridike, marrëdhëniet juridike, subjektet e të drejtës, veprat juridike, degët juridike, etj.

Në përpunimin e librit, pjesëmarrës aktiv ishte edhe Mr. Aleksandar Lj. Spasov, asistent i shkencave juridike hyrëse dhe teorike në Fakultetin juridik "Justinijani i Parë" pranë Universitetit "Shën Qirili dhe Metodij" në Shkup. Pjesëmarrja e Mr. Spasov veçanërisht ishte e rëndësishme në kuadër të kapitujve "Shenja dhe funksione të shtetit", "Forma të shtetit", "Organizimi shtetëror", "Aktet juridike" dhe "Marrëdhëniet juridike", ku si koautorë merrte pjesë me tekst të tij. Me këtë rast dëshirojmë t'i falënderohemi Mr. Spasov për pjesëmarrjen aktive dhe për mbështetjen e plotë gjatë përgatitjes së këtij libri.

KAPITULLI I

Lënda dhe metodat

1. Lënda e disiplinës mësimore - shkencore – bazat e të drejtës

Lëndë e një shkence ose disipline mësimore-shkencore është problemi ndaj të cilit ajo shkencë është fokusuar dhe të cilin e hulumton dhe e shpjegon. Përmes përmbajtjeve të disiplinës mësimore-shkencore bazat e të drejtës shpjegohen nocionet themelore të shtetit dhe të së drejtës si dukuri objektive shoqërore. Tendenca është që në vija të shkurtra të përshkruhet paraqitja, zhvillimi dhe funksionimi i shtetit dhe i të drejtës, si dhe rëndësia e tyre në shoqëri dhe në jetën e njerëzve.

Për dallim nga disiplinat tjera juridike, në bazat e të drejtës, shteti dhe e drejta studiohen në kuptim të gjerë. Patjetër duhet të potencohet fakti se shteti dhe e drejta ekzistojnë vetëm si dukuri konkrete, gjegjësisht shtete dhe të drejta konkrete, për shembull, Republika e Maqedonisë dhe e drejta e saj aktuale, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe e drejta e tyre, ose shteti romak dhe e drejta romake që kanë ekzistuar më herët. Qëllimi nuk është shpjegim dhe hulumtim i një shteti konkret, por përcaktim i nocioneve të përgjithshme - shtet dhe e drejtë: çfarë është e përbashkët për çdo shtet dhe e drejta, pa marrë parasysh ku dhe kur kanë ekzistuar? Dome thënë, në bazat e të drejtës ofrohet një shqyrtim abstrakt dhe gjenerik i shtetit dhe i të drejtës, shembull përmes studimit të shteteve të ndryshme arrihet në konkludimin se çdo shtet ka popullsinë, territorin që e kontrollon, pastaj pushtetin publik i cili disponon forcë fizike (ushtri, polici, burgje), etj.

Vetë emri i kësaj disipline mësimore-shkencore “bazat e të drejtës” përkujton që ofrohen të dhëna të përgjithshme dhe themelore për shtetin dhe të drejtën, të elaboruara në stil pozitiv juridik, me qëllim të përfitimit të të dhënave fillestare për problematikën shtetërore-juridike. Kështu, përmes përmbajtjeve të lëndës mësimore “bazat e të drejtës”, nxënësi e aprovon alfabetin në botën e të drejtës. Këtu kuptojmë çka është shteti, pushteti shtetëror, format e sundimit, çfarë janë ligji dhe kushtetuta, çfarë është marrëdhënia juridike, çfarë është hierarkia e të drejtës, etj.

Pyetja për përcaktimin e saktë të lëndës së një shkence, njëkohësisht është edhe pyetje e përkufizimit të qartë të shkencave reciprokisht.

Sipas asaj në cilin segment të realitetit është fokusuar shkenca, shkencat ndahen në shoqërore, humanitare dhe natyrore-biologjike dhe teknike.

Duke u nisur nga studimi i ndryshëm shkencor për shtetin dhe të drejtën, janë krijuar kushte për ndarje të shkencave juridike.

Shkencat juridike ndahen në katër grupe: historike-juridike, pozitive-juridike, konkrete-juridike dhe të përgjithshme-hyrëse, gje-gjesisht shkenca teorike juridike.

Shkencat historike-juridike e hulumtojnë zhvillimin historik të shtetit dhe të drejtës. Lëndë e hulumtimeve të tyre çdoherë paraqet zhvillimi historik i shtetit dhe i të drejtës, të gjitha shteteve ose i vetëm një shteti, si për shembull, studimi i shtetit dhe i të drejtës së një shteti konkret në shoqëri njëklasore. Gjithashtu e studiojnë krijimin dhe zhvillimin në të kaluarën të një shteti dhe të drejte të pacaktuar, ose të shtetit dhe të drejtës konkrete, si për shembull, shteti dhe e drejta athiniane ose romake.

Shkencat pozitive-juridike studiojnë shtet aktual. Kjo do të thotë shtet ndërkombëtarisht të pranuar, ku vlen e drejtë e caktuar pozitive. Shkenca të tilla janë: e drejta kushtetuese, e drejta penale, e drejta e punës, etj.

Shkencat konkrete-juridike studiojnë shtet dhe të drejtë konkrete. Me këto shkenca mundësohet një studim dhe përcaktim më i gjerë se çfarë është e përbashkët për gjitha ose për shtete dhe të drejta konkrete. Çdo shtet krijon strukturë të ndryshme të sistemit të saj juridik, e cila dallon nga sistemet e shteteve tjera. Në grupin e shkencave konkrete-juridike në sistemin tonë juridik ekzistojnë: e drejta kushtetuese, e drejta ndëshkuese, e drejta administrative, e drejta e punës, e drejta obligative, etj. Në vetë studimin e lëndës së disiplinave juridike, në aspekt të shkencave pozitive-juridike ekziston dallim në studim, sepse këto dy grupe të disiplinave juridike paraqiten me emër të njëjtë – e drejtë, dallimi është se te shkencat pozitive-juridike krijohen kushte për disiplina më të përgjithësuara juridike, sepse si lëndë e studimit nuk merret vetëm shtet dhe e drejtë e caktuar, por ofrohen mundësi për një krahasim shkencor të një sferë juridike ose në më tepër shtet dhe të drejta ekzistuese. Shkencat konkrete-juridike tërësisht mundësojnë studimin e rendit juridik të çdo shteti konkret në një sferë konkret, kështu për shembull, e drejta kushtetuese ose e drejta ndëshkuese tërësisht mundëson studimin e sistemeve kushtetuese-juridike ose ndëshkuese-juridike të shteteve tjera.

Te shkencat e përgjithshme-hyrëse, gjegjësisht teorike-juridike, shteti dhe e drejta studiohen në mënyrë abstrakte. Këto shkenca nuk e studiojnë të drejtën e një shteti konkret në të kaluarën dhe të tashmen, por studiojnë në mënyrë të përgjithësuar atë që është e përbashkët për gjitha shtetet dhe të drejtat. Në këtë grup të shkencave hyjnë: filozofia e të drejtës, teoria e të drejtës dhe hyrja në të drejtën.

2. Metoda për studimin e shtetit dhe të drejtës

Si arrijmë tek të dhënat për shtetin dhe të drejtën? Cilat janë veglat për studimin e tyre? Vallë shteti dhe e drejta mund të studiohen në laborator? Vallë dihet gjithçka për këto dy dukuri? Si

duhet t'i përkufizojmë? Këto pyetje janë me karakter metodologjik, ndërsa pyetjet për metodën dhe metodologjinë janë tepër të rëndësishme në botën e shkencës.

Nocioni metodë rrjedh nga fjala latine *methodus* (rrugë, mënyrë) dhe ka domethënie e rrugës ose përmbledhjes së procedurave dhe mjeteve përmes të cilave arrihet në të dhëna përkatëse. Ekziston edhe shkencë e veçantë, e a.q. metodologji që merret me zbulimin e metodave më të mira për studimin e dukurive përkatëse në natyrë ose shoqëri. Mënyra e studimit të dukurive natyrore dhe shoqërore dallon. Të ndryshme janë metodat e studimit në sferën e kimisë, biologjisë, mjekësisë, elektroteknikës nga metodat për studimin e ekonomisë, sociologjisë, historisë, etj. Domethënë, metodat e shfrytëzuara varen nga natyra e lëndës gjegjësisht problemit i cili hulumtohet.

Metoda është pjesë përbërëse dhe tepër e rëndësishme e shkencës. Nga cilësia e aparatit metodologjik, gjegjësisht nga zbatimi i drejtë i metodave varet cilësia dhe saktësia e të dhënave të fituara. Shkenca shoqërore zbulon shumë të vërteta të ndryshme në marrëdhëniet shoqërore, të cilat janë në një dinamikë dhe ndryshueshmëri të vazhdueshme. Dinamika dhe ndryshueshmëria e tillë i dedikohet shtetit dhe të drejtës, të cilat nga krijimi e deri më sot gjenden në proces të lëvizjes dhe ndryshimit të vazhdueshëm.

Në shkencë ekzistojnë tri lloje të problemeve metodologjike, edhe atë: logjike, organizative-teknike dhe strategjike. Problemet logjike u dedikohen kategorive themelore të hulumtimit shkencor, gjegjësisht si do të përkufizohen nocionet themelore, si formohen tezat, si shpjegohen fenomenet. Problemet organizative-teknike u dedikohen aspekteve teknike, gjegjësisht grumbullimit të dhënave, vëzhgimit, procedurave hulumtuese, ndërtimit të ekipeve hulumtuese, shfrytëzimit të meta-hulumtimit, etj. Problemet strategjike u dedikohen qëllimit të një shkence. Qëllimi i shkencës bashkëkohore është të jetë pragmatike dhe aplikative dhe të zgjidh sërë probleme që ekzistojnë në një shoqëri.

3. Llojet e metodave

Sipas një klasifikimi klasik, në bazë të kriterit të fazave në procesin hulumtues, metodat në shkencat juridike ndahen në ndihmës teknike, të veçanta dhe të përgjithshme.

Metodat ndihmëse-teknike janë procedura operative (teknika dhe instrumente) me të cilat fillon hulumtimi. Në këtë rreth të metodave bien: eksperimenti, vëzhgimi, anketa dhe intervista, metoda monografike, teknikat statistikore, analiza e përmbajtjes, analiza e rastit, etj.

Metoda të veçanta. Përveç metodës së përgjithshme shkencore ekzistojnë edhe metoda të veçanta, e ato janë: metoda juridike, sociologjike, historike dhe krahasuese. *Metoda juridike* është metoda më e vjetër e shkencave juridike. Përmes kësaj metoda studiohet sistemi i normave juridike. Me metodën juridike zbulohet më karakteristikja dhe më specifika për të drejtën. Metoda juridike quhet edhe metodë dogmatike, sepse normat juridike i shpjegon ashtu siç janë, si dogma, gjegjësisht nga momenti i sjelljes së tyre ekzistojnë si të tilla dhe nuk mund të ndryshohen. Teoricien të caktuar metodën juridike e quajnë edhe metodë logjike, sepse gjatë studimit të së drejtës çdoherë fokusohet në bazën logjike të normave juridike dhe ndërlidhjes së tyre në atë bazë. E drejta paraqet sistem fortë i organizuar prej normave juridike, të cilat i sjellin organet shtetërore, si të obliguara për zbatimin e atyre normave. Metoda juridike nuk ka për qëllim shpjegimin e shtetit dhe të së drejtës si të tillë, e as të bëjë vlerësimin e tyre, por vetëm ofron shqyrtim dhe përshkrim të rregullave juridike. Në këtë mënyrë përcaktohet përmbajtja logjike e normave juridike dhe fitohet shfaqje për të drejtën si tërësi rreptësisht e sistematizuar dhe padiskutueshëm logjike.

Metoda sociologjike. Përmes kësaj metode tejkalohe kufizueshmëria e metodës juridike. Më saktë, deri tek esenca e shtetit dhe të së drejtës nuk mund të arrihet vetëm përmes analizës së rregullave të shkruara juridike. Përmes një qasjeje sociologjike ose metodës sociologjike arrijmë në përgjigje të pyetjes cilat janë faktorët

shoqërorë që i kanë prodhuar shtetin dhe të drejtën. Metoda sociologjike merret me hulumtimin dhe analizimin e faktorëve shoqërorë të cilët kanë rezultuar me krijim dhe zhvillim të shtetit dhe të drejtës. Vetëm përmes metodës sociologjike mund të arrihet te përgjigjet e sërë pyetjeve: cilët faktorë shoqërorë në zhvillimin historik të shoqërisë njerëzore kanë qenë vendimtare për krijimin e shtetit dhe të drejtës, pse gjitha shtetet nuk kanë shkallë të njëjtë të zhvillimit, pse gjitha shtetet nuk kanë të drejtë të njëjtë, cili është roli i shtetit dhe të drejtës në shoqëri dhe një sërë pyetje tjera.

Metoda historike. Dukuritë shoqërore kanë gjenezën e tyre. Në këtë kontekst, edhe shteti dhe e drejta paraqiten në shkallë të caktuar të zhvillimit historik dhe vazhdimisht ndryshohen. Për shembull, ka dallim esencial ndërmjet të drejtës e cila ka ekzistuar në formacionin shoqëror skllavosundues dhe të së drejtës bashkëkohore. Përmes metodës historike analizohet zhvillimi i shtetit dhe e drejtës nga paraqitja e tyre deri sot. Patjetër duhet të konstatohet se normat juridike janë në dinamikë të vazhdueshme, gjegjësisht ndryshohen dhe përshtaten ndaj kohës, gjegjësisht situatës shoqërore ku vlejnë.

Metoda krahasuese mundëson studimin e dukurive shoqërore përmes krahasimit të tyre me dukuri tjera të ngjashme. Shembull, mund ta studiojmë Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë përmes krahasimit me Kushtetutën e Republikës së Sllovenisë, ose gjithashtu mund të krahasohet Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë nga viti 1991 me Kushtetutën e Republikës Popullore të Maqedonisë nga viti 1946. Krahasimi çdoherë paraqet një bazë të qëndrueshme për tejkalimin e mospajtimeve të caktuara për studimin e dukurisë përkatëse. Kjo metodë ka rëndësi të madhe edhe në praktikën juridike-politike, ku ekziston nevoja për harmonizim të rendeve të caktuara juridike të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian. Nga ky aspekt, vazhdimisht bëhen krahasime të sistemeve juridike të më tepër shteteve.

Me metodat e përgjithshme analizohen të dhënat e grumbulluara, sillen konkludime teorike dhe të njëjtat interpretohen. Ato

janë metoda mendore, të cilat e reflektojnë edhe vizionin e shkencëtarit – hulumtuesit. Analiza dhe sinteza shkencore, zbulimi i ligjeve të caktuara, ndërlidhja e tyre në teori përkatëse, bëhet përmes metodave të përgjithshme. Të tilla janë: metoda marksiste, funksionale, strukturale, pozitiviste, etj.






Figura 1

**Figura 2****Figura 3**




Figura 4

Pyetje:

1. Çfarë hulumton disiplina mësimore-shkencore bazat e të drejtës?
2. Bëj dallimin ndërmjet metodës dhe metodologjisë!
3. Si ndahen metodat juridike?
4. Përshkruaj metodën juridike të studimit të së drejtës!
5. Cilat lloje të problemeve metodologjike hasen te shkencat shoqërore?
6. Çfarë studion konkretisht metoda juridike?

KAPITULLI II

Krijimi i shtetit

1. Krijimi i shtetit

Prej kur ekziston shteti, pse është krijuar, cilat janë funksionet e tij, etj. janë pyetje jashtëzakonisht të rëndësishme, të cilave mendimi sociologjik-historik mundohet t'i përgjigjet. Me analizën historike-krahasuese afrohemi të civilizimet mjaft të vjetra, me qëllim të afrimit të pasqyrës për tërësinë e marrëdhënieve shoqërore të cilat e kanë prodhuar institucionin shtet.

Në shkencë ekzistojnë debate rreth asaj kur dhe si është krijuar shteti?! Të dhënat historike vërtetojnë se shteti nuk është institucioni i vetëm që zbaton pushtet, sepse kanë ekzistuar edhe shoqëri para shtetërore ku është ushtruar pushteti, por të cilat nuk i kanë poseduar karakteristikat esenciale të shtetit.

Qëndrim dominues në mendimin teorik është shpjegimi materialistik për krijimin e shtetit. Esenca e këtij shpjegimi materialistik është se shteti është rezultat i zhvillimit të përgjithshëm të shoqërisë dhe nevojave të saj. Nga ky aspekt, zhvillimi psikologjik, ekonomik, politik, infrastrukturor, teknik-teknologjik i njerëzimit në përgjithësi ndikon edhe mbi paraqitjen dhe zhvillimin e shtetit. Ekzistojnë edhe shpjegime tjera për krijimin e shtetit, për shembull, shpjegimi religjioz (në religjionet politeiste dhe monoteiste), të cilat pohojnë se autoriteti hyjnor e krijon dhe siguron shtetin.

Si bashkëngjitje e shpjegimit materialist për krijimin e shtetit janë dëshmitë nga hulumtimet historike, antropologjike, etnologji-

ke dhe sociologjike. Shkurtimisht do ta arsyetojmë shpjegimin materialist për krijimin e shtetit. Paraqitja e shtetit në fakt ndërlidhet për ndarjen e parë shoqërore të punës, e kjo është ndarja e bujqësisë nga blegtoria.

Zhvillimi i shoqërisë fillestare është shpjeguar në mënyrë interesante në veprën “Origjina e familjes, pronës private dhe shtetit” nga Fridrih Engels. Ai flet për dy faza, gjegjësisht epoka të zhvillimit të shoqërisë fillestare, e ato janë egërsia dhe barbarizmi. Këto dy epoka ai i ndan në shkallë të ulët, të mesme dhe të lartë. Secila shkallë shënon hapë para në procesin e zhvillimit të forcave prodhuese (teknologji për prodhim) të njerëzve në atë shoqëri. Egërsia është periudhë nga zhvillimi i shoqërisë fillestare, ku njerëzit përvetësojnë produkte të gatshme nga natyra.

Barbarizmi është periudhë në të cilën paraqitet blegtoria dhe bujqësia, ku njeriu përfiton nevojën për zmadhimin e prodhimit të mirave për nevoja personale. Pas këtyre dy periudhave, krijohet periudha e civilizimit, ku njeriu përfiton njohuri dhe përsosje për përpunimin e produkteve natyrore. Shoqëria fillestare, si shoqëri pa klasa, karakterizohet me ekzistimin e pronës kolektive mbi mjetet e prodhimit dhe me punën kolektive të anëtarëve. Nuk ekziston vetëdije e zhvilluar sepse në bashkësi ekziston mendimi kolektiv. Për bashkësinë primitive është karakteristike bashkësia e farefisnisë së gjakut. Aty të gjithë anëtarët janë të barabartë dhe të lirë. Nuk ekziston ndarje në klasa, e as interesa të kundërta.

Periudha e dikos ose e njohur si koha e gurit, karakterizohet me përvetësimin e mjeteve të gatshme, veglave primitive të marra nga natyra, e disa të krijuara, të cilat kanë shërbyer si mjete ndihmëse për prodhim.

Periudha e barbarizmit ndahet në dy epoka, e bronzit dhe e hekurit. Në epokën e bronzit krijohet blegtoria, kulturat bujqësore, përsosen mjetet për prodhim, paraqiten shigjeta, bisturi, çani,

sëpata, thika, etj. Me ndryshimin e raportit prodhuese dhe përveçsimit kolektiv të prodhimeve, krijohen më tepër kushte për paraqitjen e pronës komunale. Në këtë mënyrë, organizimi shoqëror i tufës fillestare ndryshohet në farefisni. Farefisnia ose gensi paraqet një grup shoqëror që është i ndërlidhur në mënyrë të gjakut dhe i cili funksionon me një grumbullim të njerëzve, domethënë është grup me origjinë nga një stërgjysh. Farefisnitë më vonë bashkohen në vëllazëri (frateri), ndërsa vëllazëritë në fise. Tre deri në pesë fise krijojnë aleancë fisnore. Me shkallën e këtyre të zhvillimit paraqitet nevoja për implementim të pushtetit publik. Edhe pse ai formalisht dhe juridikisht nuk ka ekzistuar, prapë ai ekziston si pushtet detyrues, të cilin në mënyrë të brendshme e krijojnë vetë anëtarët e aleancës.

Në çdo farefisni, vëllazëri, aleancë fisnore, janë emëruar liderë të cilët i përfaqësojnë dhe sjellin vendime në emër të anëtarëve. Gensi (farefisnia) në shoqërinë fillestare funksionon me rregulla të pashkruara, të cilat kanë qenë të obligueshme për të gjithë anëtarët. Secili gens ka territorin e tij, prijësin e tij, pronën kolektive, rregullin për pranimin e të huajve, sanksion për të padëgjueshmit, vendimet janë sjellë nga gjithë anëtarët, etj.

Civilizimet më të vjetra në fakt paraqiten me përqendrimin e njerëzve përskaj ujit, lumenjve, ku ka tokë pjellore (në Afrikën e Veriut përskaj lumit Nil, në Azinë Perëndimore përskaj lumenjve Tigër dhe Euftrat, në Azinë Jugore dhe Lindore përskaj lumenjve Ind, Gang, Jangcekjan dhe Huang-Ho). Në këto hapësira ka ndodhur revolucion agrikor, ndërtim i sistemeve të ujitjes, kanaleve, pendëve, vendbanimeve të mëdha ku kanë jetuar njerëzit dhe fuqia punëtore e cila ka përpunuar tokën. Ndërtimi dhe mirëmbajtja e këtyre sistemeve ka sjellë nënshtrim (ushtarak ose ekonomik) të vendbanimeve më të vogla ndaj atyre më të mëdha. Në atë periudhë edhe shoqëria diferencohet në sundues dhe të sunduar. Formohen shtete të mëdha dhe të fuqishme, të drejtuara nga pushteti qendror i cili trashëgohej.

Pushteti në shtetet – qytete të para ka qenë tepër i fuqishëm dhe është ruajtur përmes riteve (respektit të veçantë ndaj sundimtarëve përmes përljes, mistifikimit të personalitetit të sundimtarëve përmes veshjeve speciale dhe veçimit nga populli, ndërtimit të tempujve imponante, etj.). Këto rite gradualisht kanë fituar rëndësi zakonore-juridike. Zakonet (e drejta zakonore ose zakoni juridik) e krijuara në periudhën e vendosjes së civilizimeve të lashta dhe të kushtuara politeizmit dhe mbrojtjes së shtetit, kanë qenë ndër burimet më të rëndësishme të së drejtës. Këto zakone e kanë siguruar pushtetin dhe kanë përshkruar dënime shumë të rënda për kundërshtuesit e shtetit dhe pushtetit. Në krijimin e të drejtës, rol të madh kanë luajtur edhe organet gjyqësore të cilat i kanë mbrojtur interesat e klasave pronësore dhe të privileguara. Funksionin gjyqësor në kohë të parë e kanë kryer personat të cilët kanë zbatuar ceremoni religjioze, si dhe vetë sunduesit ose personat e emëruar nga ai. Është gjykuar dhe dënuar për rebelim kundër sunduesit, për mospagesë të tatimeve, të borxheve, kundërvajtje, vjedhje, vrasje, etj. Këto vepra në shoqërinë fillestare kanë qenë të panjohura. Është paraqitur i a.q. “interes publik”, gjegjësisht mbijetesa dhe jeta e bashkësisë ka qenë më e rëndësishme se jeta e individit (individët kanë qenë të detyruar ta respektojnë bashkësinë, të paguajnë tatime, ta respektojnë pushtetin, të mos vjedhin, të mos vrasin, etj.). Kur trupat gjyqësor kanë vendosur për ndonjë kontest, atëherë në bazë të atij vendimi janë zgjidhur edhe rastet tjera të ngjashme në të ardhmen, gjegjësisht është krijuar “e drejta precedente” ose precedenti gjyqësor.

Është paraqitur nevoja që këto rregulla t’i dinë të gjithë banorët, domethënë të jenë të informuar si dënohen delikte të caktuara dhe për këtë arsye është imponuar nevoja për shënim të rregullave. Së pari rregullat janë kalitur në pllaka të mëdha prej guri, të vendosura në vend përkatës që të shihen nga të gjithë. Kështu janë paraqitur ligjet e para të shkruara (për shembull, Kodi i Hamurabit 1792-1750

p.e.s., që paraqet pllakë prej guri që sot është ekspozuar në muzeun Luvr të Francës, ku janë shënuar sërë rregulla juridike nga ajo periudhë).

Shoqëria pa shtete – Bashkësitë e para. Në të kaluarën kanë ekzistuar shoqëri të cilat nuk kanë qenë të organizuara si shtete, por kanë pasur forma tjera të organizimit. Këto shoqëri, të cilat i kanë parapri shtetit, në literaturën historike-sociologjike quhen bashkësi fillestare njerëzore. Në ato bashkësi ekziston nivel tepër i ulët i zhvillimit të teknologjisë për prodhimin e të mirave për nevojat njerëzore (gurë i gdhendur dhe i pagdhendur, hark dhe shigjetë, heshtë, etj.). Nevojat janë plotësuar me përvetësimin e produkteve të gatshme (për shembull, gjueti dhe peshkim nga natyra). Niveli i këtillë i zhvillimit të teknologjisë për prodhim ka imponuar nevojën për bashkëpunim në raportet prodhuese, gjegjësisht njerëzit kanë qenë të detyruar në aksion të përbashkët në mposhtjen e natyrës. Kështu për shembull, gjuetia e egërsirave ka qenë e gjykuar në dështim pa bashkim paraprak të njerëzve dhe forcave.

Në ato shoqëri kanë ekzistuar rregulla të sjelljes me të cilat janë rregulluar raportet shoqërore, por të cilat nuk kanë qenë e drejtë. Që në fillet e shoqërisë njerëzore është paraqitur nevoja për rregullim të sjelljes njerëzore. Çfarë është e lejuar, çfarë është e obliguar, çfarë është sjellje e dëshirueshme dhe e mirë e dimë në bazë të përvojës së gjeneratave para nesh. Në shoqërinë fillestare, rregullator themelor i raporteve ndër-njerëzore kanë qenë zakonet, të cilat kanë qenë obligim personal i secilit anëtarë nga shoqëria fillestare. Mosrespektimi i këtyre zakoneve ka shkaktuar mllëfin e bashkësisë dhe të zotëve, ndaj të cilëve njerëzit kanë pasur respekt dhe frikë. Domethënë, zakonet janë të lidhura me paragjykimet mistike, njerëzit kanë qenë të detyruar të ndjejnë frikë dhe dënim nga diçka, këtë herë dënim nga zotët për t'i respektuar rregullat e jetesës, domethënë zakonet.

Pushteti në shoqërinë fillestare ka pasur karakter difuz, pasi është realizuar pa zbatim të masave të veçanta detyruese. Detyrimi është varur nga vetë shoqëria ku kanë ekzistuar kushte tepër të rënda për jetesë, e cila ka imponuar rregulla për respekt dhe përrulje ndaj atyre që kanë qenë më të fortë, më të aftë, më të urtë dhe nga të cilët është varur mbijetesa e bashkësisë. Dënimi më i rëndë ka qenë dëbimi i anëtarit nga bashkësia, sepse askush nuk ka mundur të mbijeton jashtë grupit, duke mos mundur të ballafaqohet me kushtet natyrore. Andaj dëbimi i individit nga bashkësia krahasohet me dënimin me vdekje. Rëndom pushtetin e ka pasur prijësi i fisit, por ai nuk ka mundur vetë të vendos dhe të kundërshtojë dëshirën e gjithë anëtarëve të bashkësisë, andaj nuk mund të flitet për zbatim formal-juridik të pushtetit. Pushteti në bashkësinë fillestare është krijuar në bazë të dy faktorëve. Njëri faktor çdoherë është nisur nga opinioni i pandarë publik i tërë bashkësisë, ndërsa tjetri nga autoriteti dhe suksesi i prijësve të fisit.

2. Qasjet e ndryshme në aspekt të krijimit të shtetit

Ekzistojnë mendime të kundërta në aspekt të çështjes së krijimit të shtetit. Qasjet e ndryshme janë rezultat i supozimeve të ndryshme teorike dhe historike. Për krijimin e shtetit, përgjithësisht ekzistojnë tre shpjegime dhe qasje të ndryshme teorike, gjegjësisht: filozofike, juridike dhe sociologjike.

3. Qasja filozofike

Qasja filozofike paraqitet në kuadër të mendimit të vjetër shekullor dhe spekulativ. Sipas kësaj qasjeje, shteti është i barabartë me bashkësinë politike, gjegjësisht tërësia e shoqërisë është shteti. Kjo bashkësi, nga pikëpamja filozofike, për të qenë shtet duhet të jetë e vetëmjaftueshme, gjegjësisht t'i plotësojë të gjitha nevojat e anëtarëve të saj.

Përfaqësues i qasjes filozofike është Aristoteli, i cili pohon se njeriu për nga natyra e tij është qenie politike. Sipas Aristotelit, interesat e shtetit janë të barabarta me interesat e individit dhe shteti është rezultat i instinktit social (si shoqëria), ndërsa vetëm zotat dhe kafshët janë të vetëmjaftueshëm dhe mund të mbijetojnë jashtë shtetit.

Sipas mësimave të filozofisë së mesjetës, qëllimi final i gjitha shkencave është e mira. Shteti gjithashtu synon të mirën, e ajo e mirë është drejtësia, ndërsa bazë e ekzistimit të tij janë ligjet morale. Qëllimi i shtetit, përveç sigurimit të ekzistimit fizik të qytetarëve të tij, është edhe avancimi i jetës morale të qytetarëve të tij. Në filozofinë e shekullit të vjetër, qëllimi shprehet përmes polisit, i cili çdoherë gjendet mbi qytetarin.

Qasja filozofike nuk ofron përgjigje në pyetjen kur dhe ku është krijuar shteti, por e shpjegon korrelacionin dhe raportin e shtetit me individin, familjen, vëllazërinë, etj., të cilët në një mënyrë historike ose biologjike ekzistojnë edhe para shtetit. Shtetin e shpjegon si instinkt, si instinkt social, nevojë e natyrës njerëzore.

Hegel, përfaqësuesi i filozofisë klasike gjermane, shtetin e interpreton si tërësi që i paraprin familjes dhe shoqërisë qytetare. Hegel për shtetin flet sikur për "unitet substancial" dhe "tërësi absolute dhe e palëvizshme". Sipas tij, individi në shtet jeton në mënyrë të drejtë etike.

4. Qasja juridike

Qasja juridike ndërlidhet për idenë e të drejtës racionale juridike. Kjo ide paraqitet dhe ekziston në periudhën e mesjetës, ndërsa veçanërisht popullarizohet në kohën e revolucioneve borgjeze, kur borgjezia e shfrytëzon këtë ide për asgjësimin e fuqisë së feudaleve. Sipas konceptit të së drejtës natyrore, njerëzit kanë të drejta përkatëse sipas fuqisë së natyrës dhe nacionalitetit (për shembull:

e drejta e jetesës, e lirisë, e pronës, etj.) dhe këto të drejta askush nuk guxon t'i abrogojë ose kufizojë, ndërsa shteti është i obliguar t'i mbrojë.

Më vonë në shek. XIX dhe XX, nga ideja për të drejtën natyrore ndërtohen konceptet "sundim i të drejtës" gjegjësisht "shteti juridik". Në epokën borgjeze zhvillohet edhe teoria për marrëveshjen shoqërore. Sipas kësaj teorie, krijimi i shtetit është proces shoqëror ku njerëzit vetvetiu arrijnë marrëveshje për krijim të shtetit.

Në aspekt të krijimit të shtetit dhe të drejtës, ndërmjet qasjes filozofike dhe juridike ekzistojnë ngjashmëri dhe dallime. Ngjashmëria në të dyja qasjet është se nuk konsiderojnë ndonjë gjendje faktike politike mbi të cilën konkretisht është krijuar shteti. Dallimi shpjegohet me atë se në teorinë për marrëveshjen shoqërore (për dallim nga qasja filozofike), individi vjen para shtetit. Sipas teorisë për marrëveshje shoqërore, shteti mund të kuptohet si e keqe e domosdoshme, e jo si e mirë e përgjithshme, siç interpretonte qasja filozofike.

Teoria për marrëveshjen shoqërore ka kontribut në procesin demokratik shoqëror, duke potencuar se sovraniteti popullor është i patjetërsueshëm, që domethënë nëse sundimtari nuk i përmbahet dhe nuk vepron sipas dispozitave të marrëveshjes shoqërore, populli ka të drejtën e plotë për organizim të rezistencës dhe revokimit të dhunshëm nga pushteti. Me këtë refuzohen gjitha teoritë e mëparshme për pushtetin e monarkut, se sundimi i tij është i përjetshëm dhe e përfiton nga momenti i lindjes.

5. Qasja sociologjike

Me zhvillimin e hulumtimeve empirike në gjysmën e dytë të shek. XIX dhe XX, aktualizohet studimi sociologjik i shtetit dhe i të drejtës, gjegjësisht shqyrtohen faktorët shoqëror të cilët i prodhojnë.

Në kontekst të kësaj qasjeje do t'i përmendim teorinë marksiste dhe teorinë e forcës. Teoria marksiste pohon që shteti është kategori shoqërore-historike. Sipas kësaj teorie, shteti është rezultat i paraqitjes së pronës private dhe klasave shoqërore. Me paraqitjen e pronës private diferencohen klasat shoqërore në të pasur dhe të varfër. Të pasurit fillojnë të sundojnë dhe ta imponojnë vullnetin e tyre. Teoria e forcës e shpjegon krijimin e shtetit me procesin push-tues, gjegjësisht me nënshtrimin përmes forcës të disa fiseve nga fiset tjera. Shteti është produkt i zhvillimit shoqëror dhe krijohet kur dallimet ndërmjet klasave të ndryshme shoqërore bëhen të patejkalueshme. Shteti paraqitet si një organizim specifik i forcave politike të cilat sundojnë dhe ky pushtet dallon nga organizimi fisnor – farefisnor për arsye se si pushtet publik çdoherë është i organizuar dhe kontrolluar nga klasë e caktuar shoqërore dhe mbështetet mbi fuqinë (formacione të armatosura dhe të organizuara). Që të mund të funksionon pushteti publik dhe aparati i tij (nëpunës, ushtri, polici), patjetër duhet të grumbullon tatime nga popullata.

6. Krijimi i shtetit te popuj të caktuar

Procesi shoqëror i krijimit të shtetit fillon që në organizimin gjentil të bazuar në lidhjet farefisnore. Procesi i krijimit të shtetit mund të konkretizohet dhe ndiqet përmes shembullit të shtetit athinas, romak dhe gjerman.

Shteti athinas ka filluar të krijohet në kuadër të fiseve athiniane. Ky shtet zhvillohet në një formë të pastër dhe krijohet me diferencim të brendshëm, gjegjësisht me vetështresim të gensit. Në vetështresim vjen për shkak të zhvillimit të teknologjisë për prodhim dhe ndarjes shoqërore të punës. Pronësia e përbashkët gjentile mbi mjetet prodhuese zëvendësohet me pronën private, me ç'rast krijohet pabarazi dhe diferencim në të pasur dhe të varfër. Me këtë rast, mënjanohet solidariteti si parim i fisit, gjegjësisht krijohen dy

klasa shoqërore antagonistë – pronar dhe rob. Kjo njëkohësisht është edhe arsyeja për krijimin e shtetit.

Për dallim nga shteti athinian, në shtetin romak aristokracia ka qenë e painteresuar në organizimin e saj shoqëror përkundër rritjes së plebsit, i cili ka qenë jashtë bashkësisë gjentile. Vjen deri te përplasja ndërmjet aristokracisë dhe plebsit, i cili arrin ta shkatërrojë organizimin gjentil aristokrat dhe në rrënojat e tij krijohet shteti. Në gjensin romak, për dallim nga ai athinian, dhuna e brendshme ka mundësuar krijimin e shtetit.

Shteti gjerman krijohet si rezultat i luftërave pushtuese të fiseve gjermane ndaj Perandorisë së dobësuar romake. Tek fitimtarët gjerman, shteti krijohet bashkë me pushtimin e territoreve të huaja, si rezultat i zgjerimit të konsiderueshëm territorial i fiseve gjermane. Me qëllim të mbajtjes në përlësi të popullatës që ka jetuar në territoret e pushtuara, ka ardhur deri tek formimi i aparatit shtetëror, domethënë shtetit.

Pyetje:

- 1. Cili është mendimi dominues në shkencë në aspekt të krijimit të shtetit?*
- 2. Çfarë karakteri ka pasur shteti në shoqërinë fillestare?*
- 3. Ekzistojnë më tepër qasje në shpjegimin e krijimit të shtetit, numëroi dhe shpjegoni dallimin ndërmjet tyre!*
- 4. Shpjegoni procesin e formimit të shtetit te popujt e ndryshëm!*

KAPITULLI III

Shteti në sistemin politik të shoqërisë

1. Vendi i shtetit në sistemin politik

Bashkësitë ose shoqëritë njerëzore kanë nevojë për organizim dhe administrim, sidomos kur janë në fazat më të larta të zhvillimit. Secila shoqëri ka diferencuar interesa të ndryshme individuale ose grupe, të cilat shpesh e kundërshtojnë njëra tjetrën. Problemet e organizimit dhe administrimit me shoqëri i përfshijnë sistemin politik të shoqërisë. Në përbërjen e sistemit politik përfshihen: shteti, partitë politike, organizatat, institucionet dhe asociacionet tjera të veprimtarisë politike, si dhe një sërë procese, sikur procesi zgjedhor.

Shteti ka vend qendror në sistemin politik, sepse proceset më të rëndësishme politike zhvillohen në lidhje me të.

Shteti ka vendosje dhe strukturë të caktuar institucionale (për shembull: legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor), që varet nga tradita dhe kultura politike në shoqërinë përkatëse. Shteti disponon aparat për detyrim fizik (ushtri, polici, burgje).

2. Ndikimi reciprok i shtetit dhe i të drejtës

Pyetja për ndikimin reciprok të shtetit dhe të së drejtës është tepër aktuale në shkencën juridike-politike. Shteti dhe e drejta janë dy entitete të veçanta, të cilat janë në raport të vazhdueshëm dhe interaktiv. Ekzistimi i shtetit dhe i të drejtës është reflektim i nevojave ekzistenciale njerëzore. Norma është natyrë imanente njerëzore.

Njeriu është qenie sociale, që domethënë se jeton në bashkësi me njerëz tjerë (shoqëri), me të cilët është në raporte të vazhdueshme (biologjike, kulturore, ekonomike, religjioze, politike, etj.). Varësisht nga zhvillimi (ekonomik, kulturor, teknologjik) dhe traditat historike, çdo shoqëri formon normat e tij, qofshin ato zakone, morale ose juridike. Prej këtyre, më serioze janë normat juridike, sepse miratohen dhe sigurohen nga shteti.

Shteti e miraton të drejtën vetëm në nivel institucional. Kjo do të thotë se shteti nuk e krijon drejtësinë, por vetëm sjell drejtësi e cila më së tepërmi i përputhet kushteve dhe nevojave përkatëse shoqërore. Gjithashtu shteti, si organizim politik i përbërë nga organe që disponojnë me mjete të ndryshme për detyrim fizik, është faktor tepër i rëndësishëm në sigurimin e respektimit të normave juridike.

Në shkencën juridike shteti trajtohet si faktor më i rëndësishëm në formimin e rendit juridike dhe funksionimit të tij. Nga ana tjetër, përmes normave juridike konstituohet shteti dhe përcaktohen funksionet e tij.

E drejta si kategori tërësisht e etalon strukturën dhe organizimin e brendshëm të aparatit shtetëror, të organeve shtetërore dhe të gjithë bartësve të pushtetit politik.

Pyetje:

- 1. Çfarë nënkuptohet nën nocionin sistem politik?*
- 2. Cili është roli dhe vendi i shtetit në sistemin politik?*
- 3. Shpjegoni ndikimin ndërkombëtar të shtetit dhe të drejtës!*
- 4. Cili është roli i shtetit gjatë mbrojtjes së të drejtës?*

KAPITULLI IV

Regjimi politik

1. Regjimi politik (nacioni)

Nën nocionin regjim politik nënkuptohet mënyra e organizimit të pushtetit më të lartë në shtet.

Në kontekst të përkufizimit të këtillë, mund t'i parashtrojmë pyetjet vijuese: kush është bartës politik i pushtetit sovran në një shtet, populli ose ndonjë individ ose grup i fuqishëm?! Për regjim demokratik politik flitet atëherë kur pushteti tërësisht i takon popullit, më saktë shumicës. Populli në esencë paraqitet si bartës i vetëm politik i sovranitetit.

Të kuptuarit bashkëkohor të demokracisë është model i sundimit të shumicës. Demokratizimi ose jodemokratizimi i një shteti është në korrelacion me faktin nëse popullit, gjegjësisht shumicës së tij i është dhënë e drejta për pjesëmarrja aktive në jetën politike dhe vetë t'i administrojë çështjet shtetërore, ose në vend të popullit të marrin pjesë individë ose grupe.

2. Llojet e regjimit politik

Regjimet politike ndahen në tri lloje: demokratike, autokratike dhe totalitare. Në regjimin demokratik, popullit tërësisht i është mundësuar e drejta për pjesëmarrje në vendosje për çështjet shtetërore dhe ekziston sigurim i plotë i të drejtave njerëzore. Regjimi autokratik karakterizohet me faktin se administrimi me shoqërinë

është në duar të individit ose grupit më të vogël të njerëzve. Regjim totalitar është ai në të cilin nuk pranohen ose kufizohen të drejtat dhe liritë e personit dhe zbatohet kontrollim i plotë nga një qendër e caktuar.

Regjimet politike demokratike bazohen në parime të caktuara, sikur: mundësim i pushtetit të shumicës, kritikë e lirë e pushtetit nga ana e opozitës, mbrojtje e pakicës, lojalitet i pakicës ndaj shtetit, etj. Në regjimet politike jodemokratike nuk ekziston raport konstruktiv ndërmjet njeriut si individ dhe shtetit.

3. Regjimi politik jodemokratik (absolutist)

Në grupin e regjimeve politike jodemokratike (absolutiste) bëjnë pjesë: autokracia, dhespotia, tirania, lloji evropian i mbretërisë absolutiste, diktatura (cezariste, bonapartiste dhe totalitare), aristokracia dhe oligarkia.

Karakteristikë themelore e gjitha formave të numëruara është shteti i fuqishëm, ndërsa shoqëria është e izoluar dhe jashtë aparatit shtetëror.

Fjala autokraci përbëhet nga fjala greke autos (vetë) dhe krateon (sundon). Në këtë regjim politik sundon individi (mbreti, pushtetmbajtësi). Tërë jetën politike e drejtojnë individë të zgjedhur, të cilët i janë nënshtruar shefit të shtetit. Në dekadat e fundit, në gjitha shtetet autokrate me aktet më të larta juridike (kushtetutë dhe ligje) janë proklamuar liritë dhe të drejtat e qytetarëve, mirëpo ato liri dhe të drejta ngelin formale, vetëm në letër. Edhe nëse në shtetet bashkëkohore autokratike ekzistojnë organe të caktuara përfaqësuese, për shembull, parlamenti, ato nuk e përfaqësojnë popullin me të vërtetë, pasi të gjithë personat emërohen ose vendosen nga organet më të larta, ose drejtpërdrejtë nga kryetari i shtetit. Numri i shteteve autokratike në nivel global shënon rënie.

Diktatura personale është lloj i autokracisë ku një person ka pushtet të pakufizuar. Në këtë lloj të regjimit politik mund të ekzistojnë organe dhe organizata të caktuara politike (për shembull, organ ligjvënës, qeveri, ministri, madje edhe parti politike). Këto organe i nënshtrohen një personi. Diktatori, për ta arsyetuar sundimin e tij dhe përgjegjësinë në sjelljen e vendimeve, formalisht këto çështje ia lë organeve më të larta. Shembuj për diktatura personale që kanë ekzistuar në të kaluarën janë ajo e Musolinit, Hitlerit, Frankos.

Tirania është e ngjashme me diktaturën personale. Në këtë regjim politik, me shtetin administrojnë një person me pushtet të pakufizuar. Sundimi i tij bazohet në metoda të dhunshme: terror, shtypje, ndëshkim.

Dheshpotia si regjim politik paraqitet në shtetet e vjetra antike. Ajo është pushtet i pakufizuar i një personi ose i grupit të vogël të personave të zgjedhur. Ngjashëm sikur tek tirania, edhe tek dheshpotia pushteti gjendet jashtë ligjit. Zbatohet brutalitet, represion nga ana e vetë dhespotit kundër popullatës. Dhespoti është person me pushtet absolut dhe të pakufizuar, i cili nuk përgjigjet para Kushtetutës dhe ligjit.

Aristokracia si formë e sundimit paraqitet në shoqërinë feudale dhe paraqet pushtet të shtresës së pasur shoqërore, e cila mund të jetë tokësore dhe shpirtërore (shtresa e teologëve).

Oligarkia gjithashtu paraqet sundim të shtresës së pasur dhe të fuqishme shoqërore. Për dallim nga aristokracia, oligarkia në korniza të caktuara shoqërore paraqet grup të porsaformuar, i pasuruar kohë më parë, grup i cili është pasuruar për shkak të rrethanave përkatëse të volitshme ekonomike. Në bazë të pasurisë së tij, ky grup përfiton fuqi.

Plutokratia është e ngjashme me oligarkinë dhe paraqet grup më të ngushtë të pasurve, i cili për shkak të pasurisë sundon dhe administrojnë me shtetin.

4. Demokracia (nocioni)

Në kuptimin tekstual, demokracia domethënë të gjithë të sundojnë dhe bashkërisht të sjellin vendime, të cilëve u paraprin debati. Por, ky është ideali antik i demokracisë. Gjegjësisht, në qytetet e vjetra greke (polise) ka qenë e mundur të gjithë qytetarët e shoqërisë të vendosin bashkërisht.

Kjo ka qenë e mundur për shkak të organizimit specifik politik të qytetit – shtet, gjegjësisht këto shtete kanë qenë të vogla për nga territori dhe numri i banorëve, andaj ka qenë e mundur në kuptimin fizik të fjalës të grumbullohen në shesh dhe të bisedojnë e vendosin.

Në shtetet bashkëkohore, të cilat janë masive, është e pamundur realizimi i demokracisë në këtë mënyrë, gjegjësisht sundimi i popullit. Andaj kërkohen mënyrë që të gjithë të jenë pjesëmarrës në procesin e vendosjes. Sot demokracia është përmbledhje e procedurave të cilat e mundësojnë vendosjen me shumicë: përfaqësues të zgjedhur – deputet, zgjedhje, ndarje e pushtetit, mënyrë e sjelljes së ligjeve të cilat kalojnë nëpër faza, mandej gjenden mënyra për kontrollimin e pushtetit. Sa i përket debatit, gjegjësisht bisedës nëpër sheshet e qyteteve të vjetra greke, kjo sot bëhet përmes partive politike, të cilat e institucionalizojnë dhe e disiplinojnë debatin në nivel shoqëror.

Demokracia bashkëkohore çdoherë nisët nga dhënia e mundësisë për vendosje të përgjegjësisë së plotë dhe ndryshueshmërisë së çdo qeverie, e cila vjen përmes zgjedhjeve të lira dhe shumëpartiake. Demokracia tërësisht i garanton njeriut lirinë e vetëdijes, besimit, krijimtarisë shkencore dhe artistike, arsimimit, mendimit personal, kritikës së organeve shtetërore, mendimit politik dhe shfrytëzimit të plotë të të gjitha të drejtave ndërkombëtarisht të pranuar.

5. Demokracia indirekte dhe e drejtpërdrejtë

Në teorinë juridike-politike njihen dy lloje të demokracisë: indirekte dhe e drejtpërdrejtë. Diferencimi i këtillë bëhet në bazë të

kriterit nëse pushteti realizohet drejtpërdrejtë nga populli ose realizohet në emër të popullit. Nën demokraci indirekte nënkuptohet realizimi i pushtetit përmes përfaqësuesve të zgjedhur (deputet) nga ana e popullit. Përfaqësuesit sjellin vendime në bazë të zgjedhjeve legjitime në emër të popullit. Në shtetet bashkëkohore, partitë politike në një mënyrë kanë monopol mbi të drejtën e kandidimit (kush do të kandidohet). Formalisht-juridikisht, nën kushte të caktuara çdo qytetar mund të jetë kandidat, por kandidat mund të propozojnë edhe grup i qytetarëve të cilët kanë të drejtën e votës. Në demokracinë indirekte, me rëndësi të veçantë është pyetja e raportit ndërmjet përfaqësuesve dhe të përfaqësuarve, sepse çdoherë mund të krijohen kushte për rrezik nga alienacioni (tjetërsimi), nëse nuk vendosen instrumente për pengim të tij. Me zgjedhjen e përfaqësuesve, ata formalisht-juridikisht thënë, fitojnë mandat. Në bazë të kriterit përgjegjësi e përfaqësuesit para zgjedhësve të tij, në teorinë e demokracisë përfaqësuese ekzistojnë dy lloje të mandateve: mandat përfaqësues dhe imperativ.

Mandati përfaqësues domethënë që përfaqësuesit e zgjedhur gjatë kohëzgjatjes së mandatit nuk janë përgjegjës për punën e tyre para zgjedhësve. Për veprimet e tyre politike në trupin përfaqësues dhe jashtë tij, nuk janë të detyruar të parashtrajnë raport para zgjedhësve dhe nuk mund të revokohen.

Mandati imperativ është i kundërt me atë përfaqësues dhe domethënë që përfaqësuesit e zgjedhur janë të obliguar vazhdimisht të japin raport për punën e tyre para zgjedhësve dhe të njëjtit mund të revokohen nga vetë zgjedhësit gjatë mandatit.

6. Institucionet themelore të demokracisë përfaqësuese

Institucione themelore të demokracisë liberale-përfaqësuese janë: zgjedhjet e lira dhe trupi përfaqësues (parlamenti).

Zgjedhjet e lira paraqesin themel të demokracisë. Ato bazohen mbi të drejtën e votës së qytetarit. Në zgjedhjet e lira, qytetarët me bindje dhe vullnet të lirë përcaktohen për kandidat, gjegjësisht opion politik përkatës.

Ekziston e drejtë zgjedhore aktive dhe pasive. E drejta zgjedhore aktive domethënë çdo qytetar i cili plotëson kushte të mund të zgjedh (të votojë). Ndërsa e drejta zgjedhore pasive domethënë çdo qytetar të mund të zgjidhet për përfaqësues (të votohet).

Të drejtat zgjedhore aktive dhe pasive mund të jenë të përgjithshme dhe të kufizuara. Për të drejtë të përgjithshme të votës flasim atëherë kur gjithë shtetasit madhor dhe shpirtërisht të shëndetshëm të një shteti posedojnë të drejtën zgjedhore. Për të drejtë të kufizuar të votës flasim atëherë kur për arsye të ndryshme, të gjithë qytetarët nuk posedojnë të drejtën e votës.

Sistemet zgjedhore në demokracinë përfaqësuese

Sistemi zgjedhor në fakt paraqet përmbledhje të rregullave dhe normave të cilat e rregullojnë problematikën për mënyrën dhe teknikën e votimit. Në këtë kontekst bëhet fjalë për: lista zgjedhore, njësi zgjedhore, e drejta e votës, mënyra e votimit, mënyra e propozimit të kandidatëve për përfaqësues, mënyra ose modeli sipas të cilit do të llogaritet përzgjedhja e kandidatëve, etj.

Në praktikën politike janë të njohura tre modele të sistemeve zgjedhore: i shumicës, proporcional dhe i kombinuar.

Sistemi zgjedhor i shumicës është modeli i parë zgjedhor në kuadër të demokracisë liberale. Te sistemi zgjedhor i shumicës, i zgjedhur llogaritet kandidati që ka fituar numrin më të madh të votave nga njësia zgjedhore. Nëse kemi sistem politik dypartiak, atëherë si-

pas rregullit zgjedhja mbaron në një rreth. I zgjedhur llogaritet kandidati që ka fituar shumicën e votave me shumicë të thjeshtë. Në sistemet politike të cilat kanë më tepër se dy parti politike dhe të cilat marrin pjesë në zgjedhje, lejohet edhe rreth i dytë, nëse kandidati nuk zgjidhet në rrethin e parë. Në rrethin e dytë garojnë vetëm dy kandidatët e parë, gjegjësisht ata që kanë fituar më së tepërmi vota në rrethin e parë.

Sistemi zgjedhor proporcional reflekton ndarjen e mandateve ndërmjet partive politike pjesëmarrëse në zgjedhje, edhe atë proporcionalisht me votat e fituara. Me këtë model mundësohet përfaqësim më i mirë dhe më përkatës i trupit përfaqësues.

Sistemi i kombinuar zgjedhor në fakt është zgjedhje mesatare, përmes të cilit duhet të mënjanohej dobësitë e modelit të shumicës dhe atij proporcional. Karakteristikë për këtë sistem është se numër i caktuar nga përfaqësuesit popullor zgjidhen përmes sistemit të shumicës, ndërsa pjesa tjetër me atë proporcional. Kështu për shembull, me ndryshimet në Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë dhe ligjet e reja zgjedhore, zgjedhjet e treta parlamentare në vitin 1998 janë mbajtur me sistem të kombinuar zgjedhor.

1. Demokracia e drejtpërdrejtë

Nën demokraci të drejtpërdrejtë nënkuptojmë model kur populli tekstualisht vendos vetë dhe drejtpërdrejtë. Në çdo shtet bashkëkohor, demokracia e drejtpërdrejtë ka rëndësi shumë më të vogël krahasuar me demokracinë indirekte. Kjo si rezultat i sërë faktorëve ose arsyeve objektive të cilat mund t'i specifikojmë si arsye shoqërore, teknike (fizike) dhe profesionale. Arsyet shoqërore janë të natyrës kulturore, ekonomike, arsimore, psikologjike, etj. Arsyet teknike ose fizike janë në madhësinë e territorit të një shtetit, numrit të popullatës ose strukturës nacionale. Arsyet profesio-

nale në fakt janë njohuritë dhe informimi i atyre të cilët duhet të sjellin vendim.

Format e demokracisë së drejtpërdrejtë janë: referendumi, forma kuvendare e demokracisë së drejtpërdrejtë, nisma popullore-ligjvënëse, e drejta e vetos dhe e drejta e revokimit.

2. Referendumi

Referendumi është formë e demokracisë së drejtpërdrejtë, në të cilin qytetarët drejtpërdrejtë janë pjesëmarrës në realizimin e pushtetit. Kjo pjesëmarrje realizohet me votim të përgjithshëm të tërë elektoratit. Në këtë formë të demokracisë së drejtpërdrejtë, qytetarët deklarohen me “për” ose “kundër”. Sipas zbatimit të tij, referendumi mund të jetë: obligues dhe fakultativ.

Referendum obligues kemi, për shembull, për ndryshim të kufijve të Republikës së Maqedonisë.

Referendum fakultativ në rast të nenit 73, paragrafi 1 nga Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, ku thuhet “Kuvendi vendos për shpalljen e referendumit për çështje të caktuara nga kompetenca e tij, me shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve”. Përveç Kuvendit, shpallje të referendumit fakultativ mund të kërkojnë edhe numër i caktuar me Kushtetutë i qytetarëve, si nismë qytetare. Fakultativiteti reflektohet në atë vallë trupi përfaqësues do të vendosë që një pyetje ta parashtrijë në referendum ose jo.

Për pyetje të caktuara, ky lloj i referendumit mund të jetë i obligueshëm për trupin përfaqësues, vetëm nëse është parashikuar në Kushtetutë. Sa i përket faktit për cilat pyetje mund të vendoset në referendum, nuk ekzistojnë rregulla të veçanta. Referendum mund të shpallet edhe për pyetje në lidhje me kontest territoriale në një shtet, kontest ndërmjet dy shteteve sovrane. Në këtë rast shpallet referendum arbitrazh, kur qytetarët deklarohen për ndonjë

pyetje në kompetencë të organeve më të larta të pushtetit, për të cilën ndërmjet tyre nuk ekziston pajtueshmëri në lidhje me kompetencën.

Forma kuvendare e demokracisë së drejtpërdrejtë. Me këtë formë, në mënyrë të drejtpërdrejtë u mundësohet të gjithë qytetarëve të moshuar të bashkësisë së caktuar që vetë, në mënyrë të drejtpërdrejtë, të vendosin për çështje në interes të tyre të përbashkët. Kjo formë paraqitet si iniciale krahasuar me format tjera të demokracisë së drejtpërdrejtë. Në shkencën juridike ekziston mendim sipas të cilit kjo formë e demokracisë së drejtpërdrejtë është më e pastër, sepse qytetarët në mënyrë më të drejtpërdrejtë, bashkërisht i parashtrajnë dhe zgjidhin gjitha pyetjet me interes të tyre. Qytetarët përmes diskutimit publik demokratike mund të parashtrajnë pyetje për shpallje të referendumit ose nismës së caktuar popullore, të parashtrajnë pyetje për besim, revokim të organit shtetëror ose personit zyrtar.

Nisma popullore ligjvënëse. Nisma popullore është formë e demokracisë së drejtpërdrejtë sipas të cilës qytetarët kanë të drejtë kushtetuese të kërkojnë nga organet shtetërore zgjidhje të pyetjeve të caktuara ose revidim të akteve konkrete pozitive-juridike. Si për shembull, revidim i Kushtetutës, ligjeve dhe akteve tjera nënligjore juridike. Me Kushtetutën e shtetit, përmes nismës popullore mund që numrit të caktuar të qytetarëve t'iu lejohet përgatitja dhe propozimi i projektit ligjor dhe të kërkohet nga organi ligjvënës miratimin e ligjit nga sfera përkatëse.

Ana pozitive tek nisma ligjvënëse është se qytetarëve çdoherë u mundësohet vetë të propozojnë ligje. Ana negative e kësaj nisme përbëhet në elementet e pakualifikuara dhe laike gjatë vendosjes për pyetje (nga e drejta dhe politika), për të cilat është e domosdoshme ekzistimi i profesionalitetit dhe ekspertizës. Nismën popullore ligjvënëse e parashih edhe Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, ashtu që qytetarët mund të paraqi-

ten si nismëtarë për miratimin e ligjit (neni 71), nëse këtë e kërkojnë më së paku 10.000 zgjedhës, ose ndryshim të Kushtetutës (neni 130), nëse kjo është vullnet i më së paku 150.000 zgjedhësve. Gjithashtu Kuvendi i Republikës së Maqedonisë obligueshëm parasheh referendumin nëse nisma është përkrahur nga 150.000 zgjedhës.

E drejta e vetos. Fjala veto ka origjinë latine, që ka domethënie të ndalojë. Përveç të drejtës së vetos, që i takon shefit të shtetit (absolute ose suspenzive), për aktet që i miraton organi përfaqësues, veton si të drejtë mund ta shfrytëzojnë edhe organe tjera shtetërore më të larta, të cilat kanë të drejtën e vendosjes së ndalesës për zbatimin e akteve të miratuara nga organe më të ulëta shtetërore.

Të drejtën e vetos mund ta shfrytëzojnë numër i caktuar i qytetarëve, të cilët në afat të caktuar mund të refuzojnë ligj tashmë të miratuar. E drejta e vetos gjithashtu mund të zbatohet në njësitë e vetëqeverisjes lokale gjatë sjelljes së ndonjë akti.

Institut juridik tepër i ngjashëm me të drejtën e vetos është e drejta e petitionit. Ajo vjen në shprehje kur qytetarët në mënyrë të shkruar mund të parashtrojnë kërkesë përkatëse. Në disa shtete këtë të drejtë e llogarisin si bazë juridike prej ku burojnë edhe veprime tjera. Peticioni paraqet një lloj të pakënaqësisë gjithëpopullore për punën e organeve shtetërore, njëkohësisht edhe indikator për disponimin e masave të gjera popullore ndaj mënyrës së sundimit.

E drejta e revokimit. Kjo e drejtë gjithashtu trajtohet si formë e demokracisë përfaqësuese. Takohet në shtetet ku përfaqësuesit popullor janë me mandat imperativ. E drejta e revokimit domethënë ndërprerje e parakohshme e mandatit të përfaqësuesit të zgjedhur. Mandatin ia kanë dhënë zgjedhësit dhe ata kanë të drejtë që me shumicë votash ta revokojnë, gjegjësisht t'i ndërpritet mandati përfaqësuesit të zgjedhur (deputet), rëndom për shkak të pakënaqësisë nga puna e tij.

Në Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë nuk është parashikuar mundësia për revokimin e deputetëve, në nenin 62 paragrafi 3 thuhet “Deputeti i përfaqëson qytetarët dhe në Kuvend vendos sipas bindjes së tij”, ndërsa në paragrafin 4 “Deputetin nuk mund të revokohet”.




Figura 5

Pyetje:

1. Çfarë nënkuptohet nën nocionin regjim politik?
2. Cilat lloje të regjimit politik ekzistojnë?
3. Shpjegoni dallimin ndërmjet autokracisë dhe tiranisë!
4. Çfarë është diktatura personale, e çfarë dhespotizmi?
5. Përkufizoni nocionin demokraci?
6. Cili është dallimi ndërmjet demokracisë indirekte dhe të drejtpërdrejtë?
7. Cilat modele të sistemeve zgjedhore janë të njohura?
8. Çfarë është e drejta e vetos, e çfarë e drejta e revokimit?
9. Shpjegoni dallimin ndërmjet nismës popullore-ligjvënëse dhe formës kuvendare të demokracisë së drejtpërdrejtë?
10. Cilat janë kushtet e nevojshme për shpalljen e referendumit?
11. Cilat lloje të vetos ekzistojnë?

KAPITULLI V

Karakteristika të shtetit

1. Përgjithësisht për karakteristikat e shtetit

Në teorinë e të drejtës veçanërisht është e rëndësishme pyetja për karakteristikat e shtetit. Për çfarë në të vërtetë bëhet fjalë? Karakteristikat e shtetit janë elemente esenciale dhe konstitutive të cilat e veçojnë shtetin nga organizatat tjera shoqërore dhe e shpjegojnë strukturën dhe funksionin e veçantë të tij në kuadër të shoqërisë së bashkësi më e gjerë njerëzore. Duke i hulumtuar karakteristikat e shtetit, e konkretizojmë nocionin shtet dhe më lehtë e kuptojmë esencën dhe funksionimin e tij.

Në teorinë e shtetit dhe të së drejtës ekzistojnë më tepër koncepte në lidhje me karakteristikat e shtetit dhe numër i madh teoricienësh kanë krijuar botëkuptime të ndryshme në lidhje me elementet e tija konstitutive. Qëndrim dominues është se ekzistojnë tri karakteristika esenciale, edhe atë: territori, popullata dhe pushteti publik.

2. Territori si karakteristikë e shtetit

Shteti është bashkësi territoriale sepse pushteti i tij publik është i kufizuar në territor të caktuar në kuadër të cilit jeton popullsia e caktuar. Për dallim nga bashkësia fillestare (gjendje para-shtetërore), e cila krijohet dhe mbijeton në bazë të lidhjeve farefisnore, shteti bashkëkohor bazohet mbi parimin territorial, gjegjësisht popullsia e

tij përcaktohet si popullsi e shtetit të caktuar vetëm duke u nisur nga fakti se jeton në territor të caktuar, e jo për shkak të ekzistimit ose mosekzistimit të lidhjes reciproke farefisnore.

Territori si shenjë e shtetit është i domosdoshëm që të mund një pushtet shtetëror të zbatohet dhe të funksionon. Me të drejtë teoricien të caktuar e konsiderojnë territorin si supozim të domosdoshëm për ekzistimin dhe veprimin e shtetit. Vallë mund të ekzistojë shtet pa territor? Pyetja e këtillë parashtrohet pasi ekzistojnë shumë raste në histori kur qeverive të caktuara, rëndom për shkak të detyrimit (agresion nga shtet tjetër ose presion nga ana e rebelëve të armatosur në vetë shtetin) shtete tjera ose bashkësia ndërkombëtare ua ka pranuar legalitetin dhe legjitimitetin (të drejtën e përfaqësimit dhe paraqitjes në emër të shtetit të caktuar), edhe pse ato qeveri faktikisht nuk kanë zbatuar pushtet mbi territorin përkatës. Ato të a.q. “qeveri në egzil” pas një periudhe të caktuar ose sërish e kanë ndërmarrë pushtetin faktik ose e kanë humbur mbështetjen nga qeveritë e shteteve tjera dhe organizatave ndërkombëtare. Për këto arsye, koncepti për “shtet pa territor” ose më saktë thënë “qeveri pa territor” është nocion konciz politik dhe nga aspekti juridik është problematik.

Territori si karakteristikë e shtetit është kategori polivalente. Ai përkufizohet si brendshëm, ashtu edhe jashtëm, ndaj shteteve tjera. Territori i brendshëm ndahet në njësi territoriale të cilat mundësojnë funksionim efikas të aparatit shtetëror. Për shembull: komuna, autonomi, krahina, rajone autonome, njësi federative, etj. Në kuptim të jashtëm, territori është tredimensional, gjegjësisht tokësor, ajror dhe ujor.

Territori tokësor i shtetit e përfshin truallin, gjegjësisht pjesën tokësore në të cilën zbatohet pushteti shtetëror. Gjitha pasuritë xehore dhe llojet tjera të pasurive që gjenden nën hapësirën tokësore, mandej fundet e deteve, lumenjve dhe oqeanëve, të cilat hyjnë në kuadër të ujërave territoriale të një shteti, i përkasin shtetit përkatës sovran.

Territori ujor e përfshin pjesën e shtetit me hapësira ujore (liqene, lumenj dhe oqeanë). Në aspekt të hapësirave detare dhe oqeanike, për territor shtetëror konsiderohen ujërat bregdetare ndaj gjerësisë detare ose oqeanike. Jashtë nga ujërat detare dhe oqeanike, territori ka status të “ujërave të lira ndërkombëtare”, gjegjësisht territor mbi të cilin asnjë shtet nuk ka pushtet sovran. Përcaktimi i ujërave territoriale (hapësirë ujore që është pjesë e territorit të një shteti dhe mbi të cilën ai realizon pushtet sovran), si dhe shfrytëzimi i ujërave ndërkombëtare, përfshirë edhe fundin detar, bëhet me konventa të veçanta ndërkombëtare.

Territori ajror e përfshin shtyllën ajrore e cila fillon nga kufijtë e jashtme tokësore territoriale dhe shtrihet në lartësi. Lartësia e shtyllës ajrore (gjegjësisht hapësira ajrore që konsiderohet pjesë e territorit të tij dhe mbi të cilën ai ushtron pushtet sovran), si dhe shfrytëzimi i gjithësisë, përcaktohet me konventa ndërkombëtare të cilat janë pjesë e të drejtës publike ndërkombëtare. Në aspekt të territorit si karakteristikë e shtetit, veçanërisht i rëndësishëm është edhe nocioni eksterritorialitet. Ai është kategori e të drejtës publike ndërkombëtare (e drejtë diplomatike dhe konsullore), që është vendosur në bazë reciproke ndërmjet dy ose më tepër shteteve të bashkësisë ndërkombëtare. Përmes eksterritorialitetit, pjesë të caktuara nga territori i shtetit, si dhe objekte të caktuara lundruese dhe fluturuese, madje edhe persona të caktuar (më tepër në pjesën për popullsinë) përjashtohen nga juridiksioni i pushtetit të caktuar shtetëror dhe ndaj tyre zbatohet rendi juridik i shtetit tjetër ose rregullat e organizatës së caktuar ndërkombëtare. Si për shembull, godinat e përfaqësive diplomatike, konsullatave, ambasadave të ndërtuara në territor të shtetit tjetër. Ato llogariten si pjesë përbërëse e territorit të shtetit që e përfaqësojnë. Për ta, sikurse për personat që punojnë si përfaqësues diplomatik, vlejnë ligjet e shtetit amë. Askush nuk ka të drejtë dhunshëm të futet në ato objekte, sepse e njëjta konsiderohet cenim i territorit të huaj.

3. Popullata si karakteristikë e shtetit

Popullatën si karakteristikë të shtetit e përfaqësojnë të gjithë njerëzit që jetojnë në territor të caktuar shtetëror. Ekziston supozimi natyror se pushteti publik është dhënë për të administruar me njerëzit dhe për rregullimin e raporteve ndërnjerëzore.

Ndarja themelore e popullatës që jeton në territor të caktuar shtetëror është në shtetas dhe të huaj. Shtetasit e një shteti posedojnë shtetësinë e atij shtetit (lidhje juridike-politike me shtet të caktuar).

Shtetësia është status personal i një personi dhe paraqet përmbledhje të autorizimeve dhe obligimeve që vendosen ndërmjet shteteve dhe individëve anëtarë të bashkësisë përkatëse shtetërore. Shtetësia është lidhje juridike ndërmjet shtetit dhe shtetasve të tij, nga e cila burojnë të drejta dhe obligime reciproke. Domethënë, me përfitimin e shtetësisë të një shteti, vendosen të drejta dhe obligime reciproke, si të shtetit ndaj shtetasve të tij, ashtu edhe të shtetasve ndaj shtetit.

Shteti ka të drejtë të kërkon nga shtetasit të plotësojnë obligime dhe punë të caktuara në interes të shtetit (ta mbrojnë dhe respektojnë rendin juridik). Nga ana tjetër, shteti është i obliguar ta garantojë sigurinë juridike, t'i sigurojë kushtet e domosdoshme për jetë dhe punë, t'i sigurojë të drejtat civile dhe politike dhe qytetari të mbrohet nga gjitha veprimet joligjore nga individ ose organe shtetërore.

Kohë të gjatë njeriu është konsideruar në shoqëri si rob i shtetit, që ka pasur vetëm obligime, e kurrfarë të drejte. Me paraqitjen e shtetit civil, për herë të parë individi e përfiton statusin e qytetarit në vend të robit.

Të huaj janë personat të cilët jetojnë në territorin e shtetit, por nuk kanë nënshtetësi. Mirëpo, edhe përkundër faktit që nuk janë shtetas të atij shteti, edhe ndaj atyre zbatohet rendi juridik i shte-

tit. Përjashtim ekziston, kur të drejta ose obligime të caktuara janë rezervuar rreptësisht për shtetasit e shtetit përkatës (për shembull, e drejta dhe obligimi për mbrojtje të shtetit, përfshi edhe obligimin për shërbim në afat të caktuar në forcat e armatosura, mandej e drejta zgjedhore, edhe atë e drejtë për të zgjedhë dhe për të qenë i zgjedhur, etj.).

Në rendet juridike bashkëkohore, çdo ditë e më tepër zvogëlohen dallimet në të drejtat të cilat vlejné vetëm për shtetasit, e jo edhe për të huajt. Falë zhvillimit të konceptit për të drejtat dhe liritë njerëzore, e sidomos të konventave të numërta ndërkombëtare të cilat i përcaktojnë dhe sigurojnë garanci për të drejtat dhe liritë njerëzore (e drejta ndërkombëtare për të drejtat njerëzore), diskriminimi i të huajve konsiderueshëm është zvogëluar në botë. Republika e Maqedonisë, si pjesë e kontinentit evropian, anëtare e organizatës më të vjetër evropiane pas luftës së Dytë botërore, Këshillit të Evropës dhe si kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian, ka firmosur Konventën më të rëndësishme për të drejtat njerëzore në Evropë, Konventën për të drejtat njerëzore dhe liritë themelore, të miratuar nga Këshilli i Evropës në vitin 1951. Me firmosjen dhe ratifikimin e Konventës, ajo bëhet pjesë e rendit juridik vendor të Republikës së Maqedonisë dhe ka fuqinë e njëjtë juridike sikurse ligjet tjera.

Mënyrat e përfitimit dhe humbjes së nënshtetësisë

Pasi nënshtetësia është çështje esenciale për shtetet, mënyrat për përfitimin dhe humbjen e saj rregullohen me ligj të veçantë për nënshtetësi. Në esencë ekzistojné katër mënyra për përfitim të nënshtetësisë: me lindje në territorin e shtetit të caktuar (*ius soli*); me lidhje të gjakut (*ius sanguines*); me natyralizim, gjegjësisht me kërkesë të personit të shtetit tjetër për pranim të shtetësisë së shtetit tjetër (*ius domicil*); dhe me ndryshim të kufijve shtetëror (përmes luftës ose vetëvendosjes së popullatës për bashkim ndaj bashkësisë tjetër shtetërore).

Nënshtetësia rëndom ndërpritet: me ligj, me marrje nga ana e shtetit, me revokim të shtetasit dhe me vdekje.

Në praktikën ndërkombëtare takohen persona të cilët për shkak të disa rrethanave nuk posedojnë shtetësi të asnjë shteti. Këta persona quhen apatridë. Gjithashtu, disa persona posedojnë dy nënshtetësi, të a.q. bipatridë dhe polipatridë, ose persona me dy ose më tepër nënshtetësi. Paraqitja e apatridëve (personave pa nënshtetësi) është e padëshirueshme në të drejtën publike ndërkombëtare, andaj Kombet e Bashkuara kanë miratuar Konventën për personat pa nënshtetësi, qëllimi i së cilës është zvogëlimi i numrit të këtyre personave në botë, ndërsa shumica e shteteve në rendet e tyre vendore juridike kanë rregulla të cilat mundësojnë që këta persona të përfitojnë nënshtetësi nëse jetojnë në territorin e atij shteti.

4. Pushteti publik si karakteristikë e shtetit

Pushtetin publik mund ta veçojmë si karakteristikën më esenciale të shtetit. Nocioni i pushtetit në kuptimin sociologjik të fjalës sillet në korrelacion me nocionin fuqi. Sipas njërit prej themeluesve të sociologjisë, Maks Veber, fuqia është përkufizuar si shkallë e probabilitetit një subjekt ta imponojë vullnetin e tij ndaj subjektit tjetër, madje edhe në raste kur ekziston rezistencë. Baza e fuqisë mund të jetë e ndryshme (pse disa njerëz janë të fuqishëm?). Bazë e fuqisë mund të jetë dhe së pari ka qenë, fuqia fizike, mandej dituria, urtësia, përvoja, pasuria, faktorët trashëgues. Sipas sociologut të njëjtë, pushteti është fuqi e institucionalizuar. Në aspekt të shpjegimit të nocionit më të gjerë të pushtetit, do ta përmendim pushtetin e eprorëve fisnor në bashkësinë fillestare, pushtetin e anëtarit më të vjetër në familjen patriarkale, pushtetin e babait në një familje, pushtetin e mësuesve në shkollë, të personave udhëheqës, të enteve, shoqatave, organizatave religjioze, etj.

Pushteti rëndom paraqitet si mjet për detyrim, i cili i qëndron në dispozicion dhënësit të urdhrave. Mirëpo, prapë ekziston dallim

ndërmjet llojeve të ndryshme të pushteteve në shoqëri dhe pushtetit publik (shtetëror). Ky i fundit është esenca e institucionit shtet. Pikërisht pushteti publik e dallon shtetin nga cilido institucion tjetër në shoqëri, miratuar nga institucionet politike të shoqërive para-shtetërore (për shembull, bashkësia fisnore). Pushteti publik është pushteti i vetëm në shoqëri që mban karakteristikën e pushtetit sovran, reflektuar në kompetencën e tij për sjellje dhe zbatim të vendimeve politike në formë të akteve juridike, funksionit të gjykimit dhe, para së gjithash, monopolin mbi detyrimin fizik. Në fakt, autonomi për vendosje për zbatim të fuqisë fizike dhe zbatimin faktik i fuqisë, me qëllim të imponimit të rendit juridik dhe stabilizimit të sistemit.

Sovraniteti i pushtetit shtetëror

Sovraniteti paraqet veçori esenciale të pushtetit publik (shtetëror), që dallohet nga gjitha llojet tjera të pushtetit në shoqëri. Sovraniteti i pushtetit publik në fakt është edhe shprehje juridike e monopolit të detyrimit fizik me të cilin disponon shteti. Termi sovranitet rrjedh nga fjala latine *superanus*, që domethënë më i lartë, suprem.

Koncepti për sovranitetin, edhe pse takohet që në antikë, e më vonë edhe në koncepte përkatëse intelektuale në feudalizëm, prapë tërësisht formësohet në feudalizmin e vonshëm (shek. 16 dhe 17), ndërsa shprehjen e tij faktike e fiton me paraqitjen e shtetit bashkëkohor nga periudha e Bashkëkohores (shek. 16-18). Nacioni klasik i sovranitetit karakterizohet me centralizim të pushtetit në territor të caktuar më të madh, supremitet dhe absolutitet të pushtetit dhe ekskluzivitet të pushtetit shtetëror. Megjithatë, me avancimin e proceseve demokratike, paraqitet i a.q. koncept liberal i sovranitetit (në shek. 20), i cili përveç elementeve klasike të sovranitetit, i përfshin edhe parimin për vetëvendosjen e popujve dhe formimin e shteteve nacionale në territoret tradicionale të jetesës, mandej parimin demokratik të organizimit të pushtetit, sipas

të cilit pushteti buron nga vullneti i popullit (qytetarëve), si dhe sigurimin e sistemit për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore njerëzore.

Parimet të cilat janë pjesë e konceptit liberal, konsiderueshëm e ndryshojnë të kuptuarit klasik të sovranitetit, gjegjësisht të kuptuarit e pushtetit publik dhe në përgjithësi të shtetit. Ato janë shprehje e demokratizimit në rritje të shoqërive dhe nevojës për kufizim të absolutizmit të bartësve të pushtetit shtetëror. Nga gjysma e dytë e shek. 20 dhe nga shek. 21 e jetojmë procesin e globalizimit, gjegjësisht ndryshimit intensiv të rrethanave politike, ekonomike, kulturore dhe rrethanave të përgjithshme shoqërore. Globalizimi i ndryshon edhe shtetet të cilat çdo ditë e më tepër ballafaqohen me krijim të sistemeve mbinacionale të administrimit, por edhe me decentralizim intensiv të pushtetit, brenda vetë shteteve. Për shtetasit e Evropës, sidomos i rëndësishëm është krijimi i Bashkimit Evropian, ku shtetet anëtare i kanë bartur të drejtat e tyre sovrane të udhëheqjes, e të cilat në të kaluarën kanë qenë kompetencë ekskluzive e shteteve nacionale. Globalizimi imponoi proces të integritit i cili kontribuoi për varësi më të madhe të shteteve dhe konsiderueshëm e kufizoi pavarësinë e tyre. Kjo ndikon edhe mbi ndryshimin e përkufizimit të sovranitetit, të cilin tani e lidhim me nocionin pushtet publik (gjegjësisht sistem i administrimit), i cili nuk është i përqendruar vetëm te shtetet nacionale, por është ndarë me organizatat tjera mbinacionale (mbishtetërore), sikur në shembullin me Bashkimin Evropian.

Prapë, për të përfituar njohuri themelore për sovranitetin, do të konstatojmë që sovraniteti i pushtetit publik dallon me tri karakteristika themelore, edhe atë:

- 1) Pavarësi e pushtetit publik
- 2) Supremaci e pushtetit publik dhe
- 3) Pakufizim juridik.

- Pavarësia e pushtetit shtetëror domethënë se shteti sjell vendime në mënyrë të pavarur dhe nuk ka obligim të nënshtrohet dhe të lejon çfarëdo lloj përzjerje në punët e saja të brendshme ose të jashtme. Shteti tërësisht e mban të drejtën e vendosjes së pavarur dhe përcaktimit nëse do të futet në aleancë me shtete tjera ose në organizatë ndërkombëtare.

- Supremacia e pushtetit shtetëror domethënë se askush nuk ka të drejtë (as nga jashtë e as nga brenda) ta mohojë dhe pengon funksionimin e pushtetit në territorin e tij, sepse kjo mundëson funksionimin e rendit juridike dhe në asnjë rast nuk mund të lejojë funksionimin e pushtetit tjetër paralel.

- Pakufizimi juridik nënkupton të drejtën e plotë të pushtetit shtetëror që, në përputhje me dispozitat e rendit juridik, të mund në çdo kohë t'i përshkruajë dhe ndryshojë dispozitat dhe aktet. Këtë të drejtë askush nuk mund t'ia konteston.

Funksionet e shtetit (nocioni)

Nën nocionin funksion të pushtetit shtetëror nënkuptohet grupimi më i përgjithësuar i veprimtarive shtetërore i cili është reciprokisht i ngjashëm për nga përmbajtja, forma dhe përkatëse me lloj të caktuar të marrëdhënieve shoqërore.

Hulumtimi i plotë shkencor për funksionet e shtetit fillon me detyrat dhe qëllimet e tij më të rëndësishme, të cilat shteti si organizatë shoqërore dhe me karakter klasor duhet t'i plotësojë. Janë paraqitur autorë të caktuar, të cilët funksionin e shtetit e krahasojnë me veprimtaritë të cilat i zbaton shteti. Si për shembull, veprimtaria kulturore, ekonomike, edukuese, arsimore, ideologjike, ushtarake, etj.

Sipas mendimit të këtyre autorëve, shteti duhet të ketë funksione aq sa ka edhe veprimtari. Ky qëndrim teorik është i papranu-

eshëm dhe nuk mund të realizohet, sepse shteti realizon qëllime të ndryshme, nga të cilat disa janë prioritare.

Kritere për përcaktimin e funksioneve shtetërore janë qëllimet e përcaktuara të cilat i synojnë veprimtaritë e caktuara shtetërore.

Në lidhje me përcaktimin e funksioneve të shtetit, janë paraqitur shumë pikëpamje të ndryshme, nga të cilat do t'i veçojmë: pikëpamjen teologjike, analitike, analitike-historike dhe pikëpamjen analitike-juridike.

Pikëpamjet e ndryshme për funksionet e shtetit

a. Pikëpamja teologjike

Pikëpamja teologjike llogaritet më e vjetra. Ajo paraqitet që në antikë, gjegjësisht me filozofinë klasike helene. Përfaqësues të kësaj pikëpamjeje janë Platoni dhe Aristoteli. Në përputhje me këtë pikëpamje, shtetit shpjegohet si institucion i cili zbaton drejtësi, gjegjësisht orvatet për realizim të plotë të drejtësisë, lirisë dhe barazisë.

Pikëpamja teologjike për funksionet e shtetit ka ndikim edhe në kuadër të mendimit feudal.

b. Pikëpamja analitike

Pikëpamja analitike në përcaktimin e funksioneve të shtetit nis nga veprimtaritë që i kryen shteti. Formimi i organeve të veçanta shtetërore dhe funksionimi i tyre do të varet nga nevoja për kryerjen e veprimtarisë konkrete shtetërore.

Sipas pikëpamjes klasike analitike, shteti ka dy funksione themelore: të jashtëm dhe të brendshëm. Funkzioni i brendshëm është funksion i organizimit të administratës, gjegjësisht organizimi i tërësishtëm i jetës shoqërore (politike, ekonomike, arsimore, kulturore,

etj.). I jashtmi kuptohet si funksion ushtarak, gjegjësisht funksion i mbrojtjes së shtetit dhe përfaqësim i shtetit në raportet me shtete tjera dhe në organizata ndërkombëtare.

c. Pikëpamja analitike-historike

Kjo pikëpamje nisët nga aspekti historik, gjegjësisht nga zhvillimi historik i shtetit në korrelacion me krijimin dhe strukturën e veprimtarive dhe funksioneve të caktuara të cilat shteti duhet t'i zbatojë.

Përfaqësuesit e kësaj pikëpamjeje nisen nga hulumtimi historik i shteteve ekzistuese, edhe atë nga momenti i krijimit të tyre. Jepet një rekapitullim për zhvillimin e organeve të veçanta detyruese të cilat kanë kryer numër të caktuar të punëve publike, sikur ndërtim të tempujve, piramidave, rrugëve, etj. Në shoqërinë para-borgjeze nuk ekzistojnë rregulla të shkruara, por kemi rregulla zakonore për sjelljen, të cilat prapë kanë qenë të vëna në funksion të rregullimit të funksioneve gjyqësore, ligjvënëse dhe administrative.

Me paraqitjen e centralizimit të pushtetit shtetëror në kohën e monarkive absolutiste, paraqitet domosdoshmëria për përsosjen e aparatit shtetëror, gjegjësisht paraqiten funksione të reja sikur funksioni ekonomik dhe komunikues i shtetit, të cilat do të kontribuojnë për zhvillimin e funksionit arsimor, shëndetësor, social dhe teknik, paraqitjen e komunikacionit rrugor, postës, telefonit, telegrafit dhe shërbimeve tjera. Sipas kësaj pikëpamjeje, tërësisht ofrohet një rekapitullim për realitetin se shteti është një dukuri konkrete historike, i cili krijohet për nevojat e njerëzve në shoqëri.

ç. Pikëpamja analitike-juridike

Kjo pikëpamje nisët nga këndvështrimi formal-juridik, sipas të cilit shteti që të ekzistojë duhet të ketë tre funksione, edhe atë: ligjvënës, administrativ dhe gjyqësor.

Funksioni ligjvënës, sipas kësaj pikëpamjeje, është paraqitur si rezultat i nevojës për krijim të rregullave të shkruara juridike (norma), para së gjithash kushtetutë dhe ligje, të cilat e rregullojnë sjelljen e organeve shtetërore dhe qytetarëve.

Funksioni administrativ është zbatimi i normave të përgjithshme juridike, gjegjësisht i kushtetutës dhe ligjeve, si krijim i normave juridike individuale dhe konkrete, në bazë dhe në pajtueshmëri me normat e përgjithshme juridike. Sipas kësaj, funksioni administrativ është organizim i jetës së plotë shoqërore në pajtim me normat e rendit juridik.

Funksioni gjyqësor është krijuar njëkohësisht me funksionin administrativ. Ai përbëhet nga vendosja në situata konkrete në lidhje me zbatimin e normave juridike, gjegjësisht përmes tij mundësohet mbrojtja e rendit juridik (me këtë edhe e sigurisë juridike të njerëzve) nga cënuesit e normave juridike.




Figura 6

Pyetje:

1. Çfarë nënkuptohet nën nocionin karakteristikë e shtetit?
2. Cilat janë specifikat e pushtetit shtetëror si karakteristikë e shtetit!
3. Çfarë është nënshtetësia?
4. Bëj dallimin ndërmjet të huajit dhe shtetasit?
5. Cilat janë bazat për përfitimin e nënshtetësisë?
6. Si quhen personat të cilët nuk posedojnë nënshtetësi të asnjë shteti?
7. Çfarë është sovraniteti dhe cilat janë karakteristikat e tij?

KAPITULLI VI

Format e shtetit

1. Nocioni shef i shtetit

Forma e sundimit çdoherë përcaktohet sipas pozitës së shefit të shtetit (prijësit shtetëror), gjegjësisht sipas statusit të tij juridik dhe veçanërisht sipas mënyrës sipas së cilës person i caktuar (ose persona të caktuar) emërohet shef i shtetit. Shefi i shtetit është person (i përcaktuar në mënyrë individuale ose kolektive, gjegjësisht individ ose trup kolektiv), që gjenet në krye të organizatës së strukturës së pushtetit shtetëror dhe posedon të drejta dhe obligime juridikisht të përcaktuara.

Rëndom, e përfaqëson shtetin brenda dhe në raportet me shtetet dhe organizatat ndërkombëtare, ai është komandant suprem i forcave të armatosura, kryen promulgim (shpallje) të ligjeve të cilat i sjell organi ligjvënës, mund të jetë propozues i autorizuar i kushtetutës dhe ligjeve, jep mandatin për përbërjen e qeverisë, emëron ose propozon zgjedhjen e personave për funksione të caktuara shtetërore, është pjesëmarrës në krijimin dhe zbatimin e politikës së jashtme, i firmos marrëveshjet shtetërore në emër të shtetit, emëron ambasadorë dhe deputet nga shteti në shtetet tjera, i pranon letrat akreditive nga ambasadorët dhe deputetët e huaj në shtet dhe jep dekorata dhe amnisti.

Shefi i shtetit në shumë rende juridike posedon edhe të drejtën e vetos (veto, lat. – ndalesë), e cila mund të jetë absolute dhe suspenduese. Nëse posedon të drejtën e vetos absolute, kjo do të

thotë se shefi i shtetit ka të drejtën e pengimit të sjelljes së ligjit të caktuar nga ana e organit ligjvënës dhe me këtë e abrogon vullnetin e shumicës së organit përfaqësues dhe ligjvënës (parlamentit). Nëse posedon të drejtën e vetos suspenduese, kjo do të thotë se shefi i shtetit mund ta anulojë sjelljen e ligjit të caktuar nga ana e organit ligjvënës, gjegjësisht e dërgon ligjin në shqyrtim dhe miratim të përsëritur. Në situatë të tillë, organi ligjvënës, gjegjësisht parlamenti, mund ta ndryshojë ligjin në drejtim të harmonizimit të tekstit të ligjit me qëndrimet politike të shefit të shtetit, por mund edhe ta refuzojë veton me votim të sërishëm të tekstit të njëjtë të ligjit, rëndom me shumicë më të madhe nga shumica gjatë votimit të parë. Në këtë rast, shefi i shtetit juridikisht është i obliguar ta firmosë, gjegjësisht ta shpallë ligjin. Krahasueshëm, në pjesën dërmuese të rrethave juridike, gjegjësisht shteteve, ku shefi i shtetit ka të drejtën e vetos, ekziston veto unike suspenduese. Vetoja absolute takohet tepër rrallë, pasi është në kundërshtim me parimet themelore demokratike të organizimit të pushtetit shtetëror.

2. Monarkia (nocioni)

Monarkia paraqet formë të atillë të sundimit, ku në krye të shtetit gjendet monark i cili në atë pozitë vjen në mënyrë trashëguese dhe rëndom është organ individual. Trashëgimia më së shpeshti bëhet sipas parimit të farefisnisë së parë. Në të kaluarën, farefisnia e parë është nënkuptuar vetëm për meshkujt, derisa femrat kanë qenë të përjashtuara nga mundësia për t'u ulur në fron, ose kanë mundur të jenë në atë pozitë vetëm nëse nuk kanë ekzistuar pasardhësit mashkullor sipas vijës së drejtë (vertikale) të gjakut.

Në shtetet bashkëkohore demokratike të cilat janë të organizuara si monarki, ky parim është braktisur dhe ende është i përfaqësuar vetëm te sistemet politike jodemokratike. Gjithashtu, ekzisto-

jnë raste kur monarku vjen në pozitë përmes rrugës zgjedhore ose të dhunshme, por këto raste janë të rralla në botën bashkëkohore, ndërsa në histori kanë qenë më të shpeshta gjatë vendosjes së dinastive të reja mbretërore, pas zhdukjes fizike të një dinastie ose pas ndryshimit dhe dëbimit të dhunshëm.

Përveç ardhjes përmes rrugës trashëguese, monarku ka edhe status të veçantë juridik dhe politik, gjegjësisht rëndom mbi të nuk zbatohen normat nga rendi juridik, të cilat vlejnë për gjithë qytetarët, por ka norma të veçanta (ligje dhe dispozita tjera), të cilat e rregullojnë statusin (pozitën juridike) dhe përgjegjësinë juridike të monarkut dhe të anëtarëve të familjes mbretërore.

3. Llojet e monarkive

Monarkitë mund të ndahen në të kufizuara dhe të pakufizuara.

Në monarkinë e kufizuar, monarku është i kufizuar në pushtetin e tij me Kushtetutën dhe dispozitat tjera juridike, gjegjësisht ekziston obligimi që monarku të sundojë vetëm në pajtim me rendin juridik (monarku nuk është mbi të drejtën).

Në kuadër të monarkive të kufizuara ekzistojnë edhe monarki parlamentare dhe joparlamentare. Më shpesh monarkitë e kufizuara janë monarki parlamentare, gjegjësisht ekziston organ i veçantë përfaqësues dhe ligjvënës, i zgjedhur nga qytetarët, i cili është kompetent për sjelljen e kushtetutës dhe ligjeve.

Në monarkitë e pakufizuara, monarku ka privilegje të mëdha dhe thuhet pushtet të pakufizuar. Në këtë lloj të monarkive bëjnë pjesë monarkitë absolutiste, ku monarku është tërësisht i pakufizueshëm në pushtetin ligjvënës, gjyqësor dhe administrativ. Gjithashtu, monarku posedon të drejtën e vetos ndaj gjitha vendimeve të organeve tjera shtetërore, përfshirë edhe aktgjykimet e gjykatave.

Në botën bashkëkohore ekzistojnë rreth 40 shtete (nga gjithsej rreth 200 shtete në botë) të organizuara si monarki. Historikisht, monarkia ka qenë formë dominuese e organizimit, por siç shihet nga numri, sot ajo është formë pakice dhe në rënie të vazhdueshme. Nga shtetet bashkëkohore, vetëm në një rast është vërejtur vendosje e sërishme e monarkisë (në Spanjë pas vdekjes së diktatorit Franko, në fund të viteve të 70-ta të shek. XX). Rast i fundit i braktisjes së monarkisë është shënuar në Nepal, në dekadën e parë të shek. XXI.

Sot monarkitë takohen thuajse vetëm në Evropë dhe Azi. Monarkitë evropiane, pa përjashtim, janë monarki demokratike, të kufizuara dhe parlamentare, ku monarku ka rol reprezentativ, gjegjësisht nuk posedon pushtet faktik, por më tepër e simbolizon unitetin politik dhe historik të shtetit (vlen maksima: Monarku sundon, por nuk administron). Monarki në Evropë janë: Britania e Madhe, Suedia, Norvegjia, Danimarka, Holanda, Belgjika, Luksemburgu, Spanja, si dhe shtetet miniature sikur Monako, Andora dhe Lihtenshtajni. Për Britaninë e Madhe është karakteristike që monarku është prijës edhe i Komonveltit (organizatë ku janë anëtarë Britania e Madhe dhe shumica e ish-kolonive të saj në Azi, Afrikë, Amerikë dhe Australi). Gjithashtu, monarku britanez është i pranuar si shef nominal (i nderit) i shtetit edhe i shteteve tjera sovraane, sikur Australisë, Zelandës së Re, Kanadasë, Xhamajkës, etj. Në këto shtete, monarku britanez nuk i realizon drejtpërdrejtë autorizimet e tija reprezentative, por përmes të a.q. guvernatorë, të cilët ai i emëron me propozim të parlamenteve të shteteve përkatëse. Kjo situatë e të a.q. union person të këtyre shteteve është rezultat i lidhjeve historike dhe është me karakter simbolik.

Në Azi ekzistojnë edhe monarki të pakufizuara dhe të kufizuara. Monarki e kufizuar dhe parlamentare, e ngjashme me monarkitë në Evropë, është Japonia, ndërsa monarki me autorizime të mëdha faktike të monarkut janë Jordani, Kuvajti dhe Katari, ndërsa me thu-

ajse pushtet të pakufizuar të monarkut janë Arabia Saudite dhe Emiratet e Bashkuara Arabe.

Në kushtet bashkëkohore, monarkitë emërohen sikur mbretëri në krye me mbretin (monarkitë në Evropë dhe pjesërisht në Azi), perandori në krye me perandor (Japonia), emirate në krye me emirin (Arabia Saudite dhe Emiratet). Historikisht janë shënuar edhe emërtimet sulltanate me sulltan, perandori me shah dhe amperi me imperator.

4. Republika

Fjala republikë rrjedh nga fjala latine *res publica*, që domethënë punë publike. Për dallim nga monarkia, republika si formë e sundimit është shtet ku shefi është një person ose grup i personave të cilët gjenden në krye të shtetit dhe vijnë përmes zgjedhjeve. Zgjedhjet mund të jenë drejtpërdrejta ose indirekte (përmes zgjedhjes nga ana e parlamentit ose organi tjetër të përbërë special për këtë qëllim).

Shefi i shtetit në republikë mund të jetë organ individual ose kolektiv. Nëse është organ individual, atëherë funksionin shef i shtetit e kryen një person i cili rëndom quhet kryetar, ndërsa nëse është organ kolektiv, atëherë funksionin e kryen trup kolektiv me më tepër persona si anëtarë dhe rëndom quhet kryesi ose presidium.

Përveç me procesin zgjedhor, shefi i shtetit në republikë karakterizohet edhe me përgjegjësi juridike dhe politike. Përgjegjësia juridike sugjeron se shefi i shtetit në republikë është plotësisht përgjegjës në kryerjen e funksionit të tij në kuadër të autorizimeve dhe në mënyrë të përcaktuar me kushtetutë dhe ligje. Nëse i cenon kushtetutën dhe ligjet, shefi i shtetit përgjigjet në procedurë të parashikuar me kushtetutë dhe ligje. Nëse përcaktohet se i ka cenuar kushtetutën dhe ligjet, atëherë shefi

i shtetit mund të shkarkohet nga funksioni ose të detyrohet të ofrojë dorëheqje.

Përgjegjësia politike reflekton se shefi i shtetit mund të jetë në atë pozitë derisa e ka legjitimitetin politik të atyre që e kanë zgjedhur. Këtë përgjegjësi më së qarti e shikojmë në ekzistimin e institutit juridik mandat, që është kufizim kohor për të cilin një person ose trup kolektiv mund ta ushtrojë funksionin. Pas mbarimit të mandatit, nëse dëshiron të qëndrojë në funksion, personi ose personat në trupin kolektiv duhet përsëri të fitojnë mbështetje politike në zgjedhje të drejtpërdrejta, ose të zgjidhen nga organi (institucioni) kompetent për zgjedhjen e shefit të shtetit.

Në aspekt të autorizimeve, shefi i shtetit mund të ketë lloj dhe volum të ndryshim të autorizimeve. Kjo, para së gjithash, varet nga rendi juridik i çdo shteti konkret. Autorizimet mund të jenë nga të rëndësishme (për shembull, të jetë në krye të pushtetit ekzekutiv), përmes të kufizuara (ta ndan pushtetin ekzekutiv me qeverinë), e deri tek reprezentative (shefi i shtetit ka funksion të përfaqësimit, por gjatë kësaj tërësisht është i lidhur për politikat dhe vendimet e qeverisë).

5. Llojet e republikave

Varësisht nga mënyra e zgjedhjes së shefit të shtetit dhe volumit të autorizimeve, republikat mund të ndahen në: presidenciale, parlamentare dhe kuvendare.

Në republikën presidenciale, shefi i shtetit është organ inokos dhe emërtohet kryetar. Ai, sipas rregullit, zgjidhet në zgjedhje të drejtpërdrejta nga ana e qytetarëve. Kryetari është bartës i pushtetit ekzekutiv (nuk ekziston organ i veçantë shtetëror, gjegjësisht institucioni qeveri). Ai i propozon dhe/ose emëron ministrat, të cilët përgjigjen para tij për punën e tyre. Kryetari posedon të drejtën e nismës ligjvënëse (të drejtën të propozojë ligje) deri te

parlamenti, e udhëheq politikën e jashtme dhe në emër të shtetit firmos marrëveshje ndërkombëtare, emëron ambasadorë dhe deputet jashtë shtetit dhe i pranon letrat akreditive të ambasadorëve dhe deputetëve të huaj në shtet, faktikisht udhëheq me forcat e armatosura, propozon dhe/ose emëron funksionarë tjerë të lartë shtetëror, përfshirë edhe të drejtën e propozimit të gjykatësve në gjykatat më të larta në shtet. Kryetari e posedon edhe të drejtën e vetos suspenduese. Për shkarkimin e tij, për shkak të thyerjes së kushtetutës dhe ligjeve, rëndom parashikohet procedurë e veçantë. Shembuj për republikë presidenciale janë SHBA-të, Brazili, Meksika, etj.

Në republikën parlamentare, shefi i shtetit zgjidhet nga ana e parlamentit ose nga ana e trupit të përbërë veçanërisht për këtë qëllim (për shembull, Kuvendi federal i RF të Gjermanisë). Shefi i shtetit mund të jetë organ inokos dhe quhet kryetar, ose trup kolektiv dhe quhet kryesi ose presidium. Kryetari ose kryesia ka autorizime të caktuara, si përfaqësim i shtetit, firmosje e marrëveshjeve ndërkombëtare, por me pëlqim të qeverisë, emërim i ambasadorëve dhe deputetëve në shtet, por me propozim të qeverisë, pranim i letrave akreditive të ambasadorëve dhe deputetëve të huaj në shtet, me pëlqim të qeverisë, dhënie e mandatit për përbërje të qeverisë, por partisë ose partive të cilat kanë shumicë në parlament, udhëheqje nominale e forcave të armatosura dhe shpallje e ligjeve. Bartës faktik i pushtetit ekzekutiv është qeveria, e zgjedhur nga ana e kuvendit, e cila për punën e saj i përgjigjet pikërisht kuvendit. Shembuj për republika parlamentare janë Gjermania, Italia, Austria, etj.

Republika kuvendare është model jashtëzakonisht i rrallë i organizimit të pushtetit të pushtetit shtetëror, sidomos tek rendet dhe shtetet demokratike juridike. Parim themelor në organizimin e pushtetit është parimi i unitetit të pushtetit, për dallim nga parimi i ndarjes së pushtetit, që është ndër karakteristikat e sistemeve politike demokratike.

Pushtetit i tërësishëm është përqendruar në trupin përfaqësues (i organizuar në formë të kuvendit, por që nuk duhet të përzihet me Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, por ka funksionin e parlamentit tipik për sistemet politike demokratike). Ai trup është bartës i pushtetit ligjvënës dhe ekzekutiv, ndërsa ndonjëherë ka edhe funksion të gjykatës më të lartë. Nëse ekziston organ i pushtetit ekzekutiv, për shembull, qeveri, ajo është tërësisht e lidhur me vendimet e trupit përfaqësues dhe pothuajse nuk ka të drejtën e nismës së pavarur politike. Kryetari i shtetit ka vetëm autorizim për përfaqësim të shtetit, firmosje të marrëveshjeve ndërkombëtare, emërim të ambasadorëve dhe deputetëve jashtë shtetit, pranim i letrave akreditive të ambasadorëve dhe deputetëve të huaj në shtet, por vetëm me pëlqim të trupit përfaqësues ose organit të tij ekzekutiv. Historikisht, ish-shtetet nga i a.q. "Blloku lindor", gjegjësisht ish-shtetet e demokracisë popullore nën patronazhin e Bashkimit Sovjetik, ishin organizuar në formë të republikave kuvendare. Në parimin e njëjtë, edhe pse në formë tepër të ndryshuar, ishte organizuar edhe ish Jugosllavia, si dhe Maqedonia si anëtare e federatës Jugosllave (RF e Maqedonisë). Në kushtet bashkëkohore, shtet i vetëm demokratik që për arsye historike është organizuar si shtet kuvendar, është Zvicra.

Përveç llojeve të lartpërmendura të republikave, ekzistojnë edhe të a.q. sisteme të përziera të republikave. Edhe pse çdo sistem i përzier ka karakteristikat e tij, e përbashkëta e tyre është se pushteti ekzekutiv është ndarë ndërmjet kryetarit dhe qeverisë, të drejtën e nismës ligjvënëse e kanë edhe kryetari edhe qeveria, kryetari ka të drejtën e vetos suspenduese dhe shpesh herë kryetari është përgjegjës për krijimin dhe zbatimin e politikës së jashtme. Sipas rregullit, kryetari i shtetit zgjidhet në zgjedhje të drejtpërdrejta. Shembull karakteristika për sistem të përzier është Franca, ndërsa në Evropë sistem të përzier ka edhe Finlanda.

Republika e Maqedonisë është republikë ku shefi i shtetit është organ inokos (Kryetar i Republikës së Maqedonisë), i cili zgjidhet në

zgjedhje të drejtpërdrejta me mandat pesëvjeçar dhe me të drejtë edhe për një zgjedhje. Kryetari ka autorizime të rëndësishme, sidomos në politikën e jashtme dhe në mbrojtjen dhe sigurinë e Republikës, jep mandatin për përbërjen e qeverisë partisë ose partive të cilat kanë shumicë në Kuvend, emëron funksionarë të lartë shtetëror, propozon persona për zgjedhje në funksione të larta shtetërore (p.sh., Guvernatorin e Bankës Popullore, gjykatës në Gjykatën Kushtetuese, anëtarë të Këshillit gjyqësor të RM), ai është komandant suprem i forcave të armatosura dhe në bashkëpunim me Qeverinë faktikisht udhëheq me forcat e armatosura (emëron shefin e shtabit të ARM, emëron gjeneralë, e përshkruan përbërjen formative të ARM), posedon të drejtën e nismës për ndryshime në Kushtetutën e RM dhe ka të drejtën e vetos suspenduese. Sipas organizimit të pushtetit, Republika e Maqedonisë është republikë parlamentare me elemente të presidencializimit (republikë presidente).

6. Format e rregullimit shtetëror (nacioni rregullimi shtetëror)

Nën formë të rregullimit shtetëror nënkuptohet organizimi i shtetit, në kuptim të marrëdhënieve ndërmjet organeve qendrore dhe lokale të pushtetit në shtet.

Organe qendrore të pushtetit llogariten ato, pushteti i të cilëve shtrihet në tërë territorin e shtetit. Këtu bëjnë pjesë organet më të larta shtetërore, gjegjësisht organet e pushtetit ligjvënës, organet e pushtetit ekzekutiv dhe organet më të larta administrative, si dhe organet gjyqësore.

Organe lokale janë ato, pushteti i të cilëve shtrihet vetëm në pjesë të caktuara të territorit shtetëror. Pushteti i organeve lokale është në nivel të njëjësive territoriale, sikur regjion, krahinë, komunë, etj.

Sipas formës së rregullimit shtetëror, organet shtetërore mund të ndahen në shtet unitar dhe të përbërë.

7. Shteti unitar

Shtet unitar është ai në të cilin dominojnë organet qendrore të pushtetit, ndërsa organet lokale, sipas rregullit, janë të detyruar t'i zbatojnë vendimet e organeve qendrore dhe u nënshtrohen në hierarki.

Shpesh shtetet unitare janë shtete ku në shumicë jetojnë anëtarë të një bashkësie etnike, edhe pse, sikur në rastin e Republikës së Maqedonisë, ekzistojnë edhe shembuj të shteteve unitare të cilat janë multientike, gjegjësisht përveç bashkësisë etnike shumicë, në numër të konsiderueshëm jetojnë edhe anëtarë të bashkësive tjera etnike.

Siç theksuam, karakteristikë kryesore e shteteve unitare është centralizimi i zbatimit të pushtetit sovran tek organet qendrore të pushtetit. Kjo do të thotë se pushteti ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor është organizuar në nivel qendror. Megjithatë, ekzistojnë edhe shumë dallime ndërmjet shteteve unitare në aspekt të shkallës së centralizimit. Dy lloje themelore të shtetit unitar janë shteti unitar i centralizuar dhe i decentralizuar. Në kushtet bashkëkohore, sidomos te shtetet demokratike evropiane, jashtëzakonisht të rrallë janë shembujt e shteteve unitare të centralizuara. Te shtetet unitare në parim takohemi me shtete unitare të decentralizuara në mënyrë mesatare ose të fuqishme.

Shtet unitar i centralizuar do të ishte shteti ku pushteti i tërësishtë është përqendruar tek organet qendrore. Por, ky është vetëm model teorik, sepse në praktikë shtet i tillë nuk ekziston. Ajo që i dallon shtetet e centralizuara unitare nga ato të decentralizuara, është pozita e organeve lokale të pushtetit. Kështu, në shtetet e centralizuara unitare, organet lokale janë vetëm një rajonale të organeve qendrore dhe tërësisht u nënshtrohen të parëve. Organet lokale ekzistojnë për shkak të zbatimit më efikas të pushtetit në nivel lokal dhe për zgjidhjen e çështjeve me karakter lokal. Ato nuk kanë asnjë autonomi në kuptim të pavarësisë gjatë vendosjes

ose disponimit me mjete buxhetore në nivel lokal. Kur vepron organi lokal, ai vepron në emër të organit qendror. Zgjedhjen e bartësve të funksioneve publike tek organet lokale e kryejnë organet qendrore përmes emërimit, pa ndikim demokratik mbi zgjedhjen e drejtpërdrejtë të personave në organet lokale. Në atë rast, ekzistimi i organeve lokale është reflektim i nevojës për dekoncentrim të pushtetit (nga niveli qendror në atë lokal), e jo për parim të decentralizimit, gjegjësisht autonomisë së organeve lokale në realizimin e kompetencave të tyre dhe pjesëmarrjes demokratike të qytetarëve në zgjedhjen e bartësve të funksioneve publike në organet lokale.

Shteti i decentralizuar unitar karakterizohet me ekzistimin e organeve lokale të cilat kanë sferë personale të veprimit të kompetencave, të ardhura personale nga taksat dhe tatimet lokale, si dhe të ardhura nga buxheti i pushtetit qendror, të cilat i fitojnë në bazë të ligjit dhe të cilat i shfrytëzojnë në mënyrë autonome, në kuptimin e përcaktimit të nevojave lokale, ndërsa organet qendrore vetëm e mbikëqyrin kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e aktivitetit të tyre. Organet lokale mund të kenë kompetenca më të mëdha ose më të vogla, por rëndom kompetencat minimale të cilat i kanë në shtetet e decentralizuara unitare janë në sferën e urbanizimit lokal, veprimtarive komunale, shkollimit fillor, mbrojtjes sociale lokale, mbrojtjes themelore shëndetësore, zhvillimit lokal ekonomik, sigurisë lokale, kulturës lokale, etj. Megjithatë, modeli i decentralizimit dhe kompetencave të organeve lokale janë të ndryshme nga njëri në shtetin tjetër. E përbashkëta e tyre është se organet lokale, pavarësisht shkallës së autonomisë, nuk kanë pushtet sovran, gjegjësisht nuk janë bartës të sovranitetit të pushtetit shtetëror i cili çdoherë është tek organet qendrore dhe nuk posedojnë subjektivitet të pranuar ndërkombëtar, gjegjësisht nuk mund të paraqiten në mënyrë të pavarur në komunikacionin ndërkombëtar juridik. Republika e Maqedonisë, sidomos pas amendamenteve kushtetuese të vitit 2001 dhe Ligjit për vetëqeverisje lokale nga viti 2002, është shembull për shtet të

decentralizuar unitar, me autorizime të gjera për organet lokale dhe me zgjedhje të drejtpërdrejtë të organeve lokale (përmes zgjedhjeve lokale).

8. Shteti i përbërë

Për dallim nga shteti unitar i cili në përbërjen e tij nuk ka pjesë përbërëse, shteti i përbërë është i përbërë nga më tepër pjesë të cilat janë bartës të të drejtave sovrane. Në të drejtën ekzistojnë dy lloje themelore të shteteve të përbëra: federata dhe konfederata.

9. Federata

Vetë emri federalizëm rrjedh nga fjala latine foedus – aleancë, lidhje, marrëveshje. Federata përkufizohet si shtet federal, që konsiderohet për aleancë më të fuqishme nga aleanca e shteteve. Në shtetin federal anëtarët e aleancës (federatës), edhe pse janë bartës të së drejtave të caktuara sovrane, nuk kanë subjektivitet juridik ndërkombëtar, gjegjësisht nuk mund të paraqiten në mënyrë të pavarur në marrëdhëniet ndërkombëtare.

Organet federale ose organet e federatës janë organet më të larta, sepse me Kushtetutën dhe ligjet kanë autorizim të plotë të sjellin Kushtetutë, ligje dhe lloje tjera të akteve juridike të cilat vlejnë për tërë territorin e federatës. Anëtarët e federatës mund të paraqiten përmes formave dhe emrave të ndryshëm, si për shembull, republika, krahina, kantone, etj. Ato çdoherë varen nga rregullimi shtetëror i regjimit politik dhe nga marrëveshja e tyre, që fillon në bazë vullnetare, në kuadër të shtetit si njësi federale.

Anëtarët e federatës si njësi të saja përbërëse, kanë organet e tyre, kanë pavarësinë në sjelljen e akteve juridike, mirëpo ato duhet të jenë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjet e federatës. Federatat mund të krijohen me agregim (bashkim i dy ose më tepër shteteve

të pavarura sovrane) ose me devoluim (një shtet unitar sovran kalon në shtet federativ).

Secila federatë ka karakteristikat e saj esenciale, të cilat çdoherë varen nga kushtet historike në të cilat është krijuar federata. Si arsye më të shpeshta për rregullimin federativ të një shteti konsiderohen arsyet etnike, gjuhësore, religjioze, kulturore, ekonomike, etj.

Karakteristika të federatës janë si vijon:

- ekziston një kushtetutë federative që i përkufizon dhe përca-
tkton kompetencat ndërmjet federatës dhe njësive federale:

- njësitë federale mund të kenë kushtetutën e tyre, e cila duhet
të jetë në pajtim me atë federale;

- ekzistojnë organe federative ku njësitë federale janë të për-
faqësuar në mënyrë përkatëse dhe të barabartë;

- përbëhet nga territori dhe popullsia e shteteve anëtare që e
krijnë federatën, ndërsa vetë federata nuk ka territorin e saj i cili një-
kohësisht nuk është pjesë e territorit të ndonjërit prej anëtarëve të saj;

- organizim i dyfishtë i pushtetit shtetëror (në nivel federativ
dhe në nivel të anëtarit);

- legjislacion i dyfishtë;

- nënshtetësi e dyfishtë, të federatës dhe të anëtarit;

- valutë unike;

- kufij ndërkombëtarisht të pranuar;

- mbrojtje unike;

- doganë unike.

Federatat krijohen përmes bashkimit të shteteve deri atëherë të pavarura, përmes federalizmit të shtetit paraprakisht unitar (devoluim) ose përmes bashkimit të popujve të cilët më herët kanë udhëhequr luftëra çlirimtare, gjegjësisht paraprakisht kanë qenë pjesë të një ose më tepër shteteve, ndërsa kanë lidhje të përbashkëta historike ose origjinë historike. Karakteristikë e veçantë për federatën është mose-

kzistimi i procedurë për lëshim të federatës, ose nëse kjo parashihet, bëhet fjalë për procedurë të gjatë dhe të ndërlikuar.

Federatat mund t'i ndajmë në federata etnike dhe federata territoriale ose gjeografike-historike. Federatat etnike përbëhen nga anëtarë që janë bashkësi shtetërore të një bashkësie etnike. Ato janë federata të popujve që janë bartës të të drejtave sovrane, të cilat vullnetarisht i kanë dorëzuar tek organet e përbashkëta shtetërore (organet e federatës). Te ky lloj i federatave, shpesh parashihet procedura për ndarje, edhe atë duke u thirrur tek e drejta e popujve sovrane për vetëvendosje (përcaktuar edhe në Kartën e Kombeve të Bashkuara). Shembull për federata etnike kanë qenë ish-Jugosllavia, ish-Bashkimi Sovjetik, ish-Çekosllovakia, etj.

Federata territoriale ose historike-gjeografike janë ato që janë krijuar si rezultat i arsyeve historike (banim i anëtarëve të një etnikumi në shtete të veçanta) ose si rezultat i ekzistimit të identitetit të fuqishëm rajonal të anëtarëve nga bashkësia e njëjtë etnike. Shembull për federatë territoriale janë SHBA-të, Gjermania, Austria, etj.

10. Konfederata

Konfederata është aleancë e shteteve që krijohet me marrëveshje vullnetare të dy ose më tepër shteteve sovrane, të cilat e ruajnë të drejtën e shteteve ndërkombëtarisht të pranuar sovrane.

Konfederata çdoherë ka paraqitur aleancë të lirshme, sepse në çdo kohë secilës anëtare i lejohet braktisja e aleancës, duke e anashkaluar procedurën e veçantë. Kjo e drejtë quhet e drejta e ndarjes, ose *ius secessionis*.

Si karakteristika themelore të konfederatës dallohen:

- organ më i lartë është kuvendi konfederal me autorizime të caktuara ligjvënëse;

- secili anëtar ka karakteristikat e tij si shtet dhe është ndërkombëtarisht i pranuar;

- nuk përjashtohet mundësia e krijimit të organeve të përbashkëta ekzekutive dhe gjyqësore;

- për miratimin e vendimeve duhet të votojnë të gjithë anëtarët e trupit konfederativ (edhe pse mund të kërkohet edhe shumicë më e vogël për vendime të caktuara);

- secili anëtar deklarohet individualisht për çdo çështje përkatëse;

- nuk përjashtohet mundësia e ekzistimit të nënshtetësisë së dyfishtë;

- nuk ka sistem unik politik;

- mund të ekzistojë mbrojtje e kombinuar e përbashkët.

Në kuadër të shtetit të përbërë mund të paraqiten edhe forma tjera, si për shembull, unioni dhe protektorati. Në zhvillimin historik kanë qenë të krijuara dy lloje të unioneve:

1) unioni personal dhe

2) unioni real.

Unioni personal konsiderohet si lloj i konfederatës që krijohet me marrëveshje vullnetare ndërmjet dy shteteve të pavarura, të cilat janë pajtuar të kenë shef të përbashkët të shtetit, e kjo rëndom përdoret te monarkitë (tanimë e përmendëm shembullin me statusin e Monarkut britanik në Australi, Zelandë të Re, Kanada, Xhamajkë).

Për dallim nga unioni personal, unioni real krijohet ndërmjet numrit të caktuar të shteteve të pavarura, të cilat reciprokisht pajtohen për realizim të interesave dhe qëllimeve përkatëse të përbashkëta, si për shembull, politikë e përbashkët e jashtme, mbrojtje e përbashkët, doganë, financa, etj.

11. Protektorati

Protektorati paraqet formë të llojit specifik të shtetit të përbërë, si një lloj i aleancës ndërkombëtare. Rëndom, me kërkesë të ndonjë shteti të vogël dhe të dobët, i cili nuk është në gjendje vetvetiu t'i

realizojë funksionet e brendshme dhe të jashtme, kërkohet mbrojtje e përkohshme nga shtet tjetër më i zhvilluar dhe më i madh. Protektorati shpesh paraqitet pas konflikteve më të mëdha ose çrregullimeve të vështira të sistemit ekonomik, pas të cilëve shteti përkatës nuk është në gjendje (nuk ka kapacitet të mjaftueshëm) vetvetiu t'i realizojë funksionet e tij. Në kushtet bashkëkohore, rëndom protektoratin e zbaton OKB-ja, si organizatë më e fuqishme e bashkësisë ndërkombëtare të shteteve.




Figura 7




Figura 8

Pyetje:

1. Përkufizo nocionin shef i shtetit?
2. Në cilin moment historik është paraqitur monarkia dhe cilat lloje të monarkive ekzistojnë?
3. Shpjegoni origjinën e fjalës republikë dhe cilat lloje të republikave janë të njohura?
4. Çfarë është karakteristike për formën republikane të sundimit?
5. Shpjegoni nocionin rregullim shtetëror!
6. Çfarë është shteti unitar?
7. Bëni dallimin ndërmjet federatës dhe konfederatës!
8. Cilat janë karakteristikat themelore të konfederatës?
9. Çfarë është unioni?
10. Çfarë është protektorati?
11. Trego një shtet që është shembull për federatë!

KAPITULLI VII

Organizimi shtetëror

1. Nocioni dhe parimet e organizimit shtetëror

Për përcaktimin e vetë nocionit të organizimit shtetëror, fillimisht duhet të shqyrtohet nocioni i shtetit në kuptimin më të gjerë dhe më të ngushtë.

Në kuptimin më të gjerë, me organizimin shtetëror përcaktohet shoqëria, organizimi i saj në territor përkatës që është rregulluar me organe shtetërore.

Në kuptimin më të ngushtë, organizimi shtetëror mund të shpjegohet si pushtet politik, që juridikisht është organizuar në shoqëri dhe ku çdoherë ekziston monopoli i detyrimit fizik.

Nëse shteti shpjegohet në kuptimin më të gjerë, si bartës i pushtetit politik, atëherë të gjithë anëtarët e shoqërisë, gjegjësisht shtetasit, i përkasin shtetit.

Kur flitet për shtet në kuptimin më të ngushtë, si anëtarë të tij llogariten vetëm numër i caktuar i personave që marrin pjesë në realizimin e pushtetit shtetëror.

Që të mund të funksionojë, shteti duhet të përbëhet nga:

1. aparati shtetëror,
2. entet shtetërore dhe
3. ndërmarrjet publike shtetërore.

2. Parimet e organizatës shtetërore

Si parime të organizatës shtetërore janë të njohura këto:

- Parimi i përfaqësimit dhe mbrojtjes së interesave të qytetarëve. Në këtë parim përpunohet sistemi zgjedhor, si dhe të drejtat dhe liritë e qytetarëve.
- Parimi i ndarjes së pushtetit. Sipas këtij parimi, pushteti është i ndarë në ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor.
- Parimi i opinionit, transparencës dhe llogaridhënies. Përmes këtij parimi, aparati shtetëror tërësisht e mundëson vullnetin e qytetarëve për t'u shprehur përmes referendumit për zgjidhje të miratuara nga organi shtetëror.
- Parimi i shkallës së lartë të profesionalizmit dhe kompetencës. Për funksionim më efikas të aparatit shtetëror, veçanërisht duhet të emërohen persona të cilët në mënyrë profesionale do të mundësojnë funksionimin e aparatit shtetëror.
- Parimi i ligjshmërisë. Kjo nënkupton respektimin e plotë dhe ekzekutimin e ligjeve në shtet.

3. Organin shtetëror (nocioni dhe karakteristika)

Organi shtetëror paraqitet si element themelor në përbërjen e organizatës shtetërore.

Organi është element themelor i aparatit shtetëror, konsiderohet si qelizë themelore, që vepron në bazë të ligjit dhe i cili ka autorizime të caktuara.

Fjala organ vjen nga biologjia dhe përcaktohet si pjesë e një tërësie nga organizmi njerëzor, që vetvetiu kryen funksion të caktuar. Çdo organi shtetëror i mundësohet që në mënyrë të pavarur të disponon dhe zbaton pushtetin shtetëror dhe të veprojë në emër të shtetit.

Urdhrat që i jep organi shtetëror mund të jenë obliguese dhe mund t'u referohen të gjithë qytetarëve ose numrit të caktuar të qyte-

tarëve të një rajoni përkatës. Gjitha organet shtetërore reciprokisht dallohen sipas strukturës dhe kompetencave të tyre në sfera të caktuara.

4. Llojet e organeve shtetërore

Pa marrë parasysh sa organe ka një shtet, ato ndërmarrin vend të veçantë në shkallën e hierarkisë së aparatit shtetëror. Ato mund të shpjegohen në një kuptim më të gjerë, si organe të cilat janë përcaktuar të veprojnë në pjesë të caktuara të shtetit dhe të kenë kompetencat e tyre. Për këtë arsye, këto organe ndahen në më tepër lloje:

- lokale;
- komunale;
- ndërkomunale;
- qarkore;
- republike;
- federative;
- organe me kompetencë të përgjithshme dhe të specializuar;
- kolektive dhe individuale;
- ligjvënëse, ekzekutive, etj.

Organet shtetërore ndahen sipas dy klasifikimeve:

1. klasifikim struktural, funksional, horizontal;
2. sipas llojit dhe mënyrës së zbatimit të veprimtarisë.

Në kuadër të klasifikimit të parë (horizontal), dallohen këto organe shtetërore:

- 1) organe të pushtetit ligjvënës;
- 2) organe të pushtetit politik;
- 3) pushtet gjyqësor;
- 4) vendore dhe lokale.

5. Organet e pushtetit ligjvënës

Ky lloj i organeve realizohet nga organi më i lartë politik ligjvënës. Ky organ i pushtetit shtetëror konstituohet në bazë të zgjedhjeve dhe vepron në emër të qytetarëve. Gjitha organet tjera themelohen nga organi ligjvënës, pasi ai organ i sjell aktet më të larta juridike në shtet (kushtetutën dhe ligjeve), e të cilat pushteti ekzekutiv është i obliguar t'i zbatojë.

6. Parlamenti (Kuvendi)

Në çdo shtet demokratik, parlamenti paraqet organin më të lartë përfaqësues dhe ligjvënës. Ai e realizon sovranitetin e qytetarëve përmes sjelljes së Kushtetutës dhe ligjeve. Sipas strukturës së tij, parlamenti mund të jetë: njëdhomësh, dydhomësh dhe shumëdhomësh.

Në shtetet federative ekzistojnë dy dhoma: i epërm dhe i poshtëm, sikur në SHBA, të pasqyruara në dhomën përfaqësuese dhe senat.

Sistemi parlamentar dydhomësh mund të takohet edhe në shtete të caktuara unitare, si për shembull, në Francë, Poloni, Çeki, Finlandë, etj.

Në Republikën e Maqedonisë, parlamenti njihet me emrin Kuvend i Republikës së Maqedonisë dhe është trup njëdhomësh, konstitutiv, ligjvënës dhe përfaqësues, i përbërë nga 120-140 deputet të zgjedhur në zgjedhje të drejtpërdrejta dhe të përgjithshme me votë të fshehtë.

7. Organet e pushtetit ekzekutiv-politik

Si organe të pushtetit ekzekutiv politik në përbërje të organizatës shtetërore janë organet të cilat i zbatojnë ligjet dhe aktet tjera të miratuara nga parlamenti dhe të cilat e organizojnë administratën

shtetërore. Organe ekzekutive-politike janë shefi i shtetit (prijësi shtetëror) dhe qeveria (këshilli i ministrave).

8. Shefi i shtetit (prijësi shtetëror)

Shefi i shtetit, varësisht nga forma e sundimit (monarki ose republikë), është monark ose kryetar, gjegjësisht kryesi. Mund të organizohet si organ individual ose kolektiv. Për pozitën, mënyrën e zgjedhjes dhe autorizimet e shefit të shtetit gjërisht folëm në kapitullin dedikuar për format e sundimit.

9. Këshilli i ministrave (Qeveria)

Qeveria paraqet organin më të lartë, ekzekutiv dhe administruues të pushtetit shtetëror. Si organ mund të takohet nën emra të ndryshëm, si për shembull, kabinet i ministrave, këshill, etj.

Qeverinë e përfaqëson kryetari i saj, i cili mund të emërtohet edhe si kryeministër, kancelar, etj. Ajo është e përbërë nga numër i caktuar i anëtarëve, respektivisht ministrave. Në kuadër të kompetencave të saj, ajo është e obliguar të sjellë vendime dhe akte nënligjore, si për shembull, dekrete, aktvendime, rregullore, etj.

Në çdo shtet unitar pranohet vetëm një qeveri, ndërsa në shtetin federativ ekziston qeveri federale dhe qeveri të shteteve anëtare të federatës. Qeveria mund të funksionojë si njëpartiake dhe koalicionuese. Qeverinë njëpartiake e përfaqëson një parti, ndërsa ajo koalicionuese është e përbërë nga dy ose më tepër parti.

Numrin e përgjithshëm të ministrive dhe organeve tjera shtetërore e përcakton çdo shtet individualisht.

Ministritë janë organet më të larta të cilat kanë pavarësi të plotë për udhëheqje në sferë konkrete. Në krye të çdo ministrie emërohet ministër, si organ individual që ka të drejtën diskrete për sjellje të vendimeve për sferë të caktuar. Qeveria si organ kolektiv, e përbërë nga ministra, nënkryetarë, ka edhe ministra pa resor.

Secili ministër për realizimin e punës së tij përgjigjet drejtpërdrejtë para ministrit, i cili e ka të drejtën ta shkarkojë atë. Organ i vetëm që posedon të drejtën për votëbesim të qeverisë është parlamenti, i cili mund të parashtrojë edhe interpelancë, gjegjësisht të shpreh mosbesim për ndonjë ministër ose zëvendës të tij dhe të kërkon nga kryeministri shkarkimin e tij.

10. Organet e pushtetit gjyqësor

Gjykata si institucion i mbron interesat dhe vlerat themelore të një shoqërie përkatëse. Ajo paraqet njërën nga krijesat më të vjetra politike. Fillet e gjykatës njihen që me këshillat e qytetarëve të respektuar dhe të mençur, të cilat kanë pasur për qëllim zgjidhjen e mosmarrëveshjeve reciproke personale dhe grupe të qytetarëve.

Në gjitha shtetet bashkëkohore, gjykatat krijohen për mbrojtjen e sigurisë personale dhe sigurimin e funksionimit efikas të rendit juridik, gjegjësisht të kushtetutës, ligjeve dhe akteve tjera juridike të miratuar në pajtim me kushtetutën dhe ligjet, si dhe për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarëve.

Pushteti gjyqësor ndërtohet në kuadër të sistemit gjyqësor, i cili përfshin ente të ndryshme gjyqësore, sikur gjykata civile, administrative, ushtarake, arbitrare, etj.

Në hierarkinë e organizimit të pushtetit gjyqësor rëndom gjendet gjykata supreme, e cila në disa shtete njëkohësisht i kryen edhe funksionet e gjykatës kushtetuese.

Në Republikën e Maqedonisë, pushteti dhe funksioni gjyqësor realizohet përmes gjykatave vijuese:

- Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë – është e vetme dhe obligohet të kujdeset për pushtetin e tërësishëm gjyqësor në shtet. Ajo jep mendime juridike, zgjedh lëndë të shkallës së tretë, gjegjësisht vendos për zbatimin e mjeteve të çrregullta juridike, vendos për përplasje të kompetencave ndërmjet Gjykatave të Ape-

lit, si dhe jep mendime parimore juridike për zbatimin e ligjeve nga ana e gjykatave.

- Gjykata të Apelit ka në Shkup, Manastir, Shtip dhe Gostivar. Këto gjykata vendosin sipas ankesave kundër vendimeve të Gjykatave Themelore, si dhe për përplasjen e kompetencave ndërmjet Gjykatave Themelore nga një rajon apeli.

- Gjykata Themelore – janë gjykata të shkallës së parë, gjithsej 27. Ato vendosin sipas lëndëve me kompetencë gjyqësore dhe vendosin për çështje jashtëprocesore dhe delikte kundërvajtëse.

- Gjykata Administrative – e formuar për të vendosur në konteste administrative, sipas padive kundër akteve administrative të organeve shtetërore, përmes të cilave do të mundësohet efikasiteti më i madh i procedurës.

- Përveç këtyre, ekzistojnë edhe institucione tjera gjyqësore:

- Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë – vendos për kushtetutshmërinë e ligjeve, si dhe për kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e akteve tjera juridike të përgjithshme, vendos për përgjegjësinë e Kryetarit të Republikës së Maqedonisë në rast të cenimit të Kushtetutës dhe ligjeve, vendos për përplasjen e kompetencave ndërmjet organeve të pushtetit ligjvënës dhe ekzekutiv, vendos për cenimin e të drejtave dhe lirive njerëzore. Gjykata Kushtetuese përbëhet nga 9 gjykatës me mandat prej 9 viteve, pa të drejtë për zgjedhje të përsëritur, të zgjedhur nga ana e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, me propozim të Kuvendit, Kryetarit të RM dhe Këshillit gjyqësor të RM.

- Këshilli gjyqësor – organ shtetëror i përbërë nga anëtarë të zgjedhur nga Kuvendi i RM, anëtarë sipas detyrës zyrtare dhe anëtarë të zgjedhur nga radhët e gjykatësve në zgjedhje të drejtpërdrejta. Këshilli gjyqësor vendos për zgjedhjen dhe shkarkimin e gjykatësve në gjitha gjykatat në RM, përveç në Gjykatën Kushtetuese, si dhe vendos për përgjegjësinë e gjykatësve për shkak të zbatimit të pa-përgjegjshëm dhe kundërligjor të funksionit gjyqësor.

11. Organet vetëqeverisëse lokale

Në përbërjen e njësive territoriale, pushteti zbatohet me përcaktimin e personave zyrtar në organet lokale nga pushteti lokal.

Me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, me nenin 114 paragrafi 1, qytetarëve u garantohet e drejta e vetëqeverisjes lokale. Qytetarët këtë të drejtë mund ta realizojnë vetëm drejtpërdrejtë, përmes përfaqësuesve të tyre të zgjedhur në njësitë e vetëqeverisjes lokale.

Si njësi të vetëqeverisjes lokale janë komunat dhe qyteti i Shkupit.

Njësitë e vetëqeverisjes lokale kanë kompetenca që në mënyrë të pavarur të sjellin programe, buxhet, llogari përfundimtare, program për urbanizim të tokës ndërtimore. Gjitha këto kompetenca duhet të jenë në pajtim me ligjin dhe në pajtim me organ përkatës të administratës shtetërore.

12. Klasifikimi sipas llojit dhe mënyrës së zbatimit të veprimtarisë së organeve shtetërore

Në kuadër të këtij klasifikimi bien grupet vijuese të organeve shtetërore: të armatosura dhe civile; demokratike dhe burokratike; politike, burokratike dhe ideologjike; vendimmarrëse dhe ekzekutive; dhe kolektive e individuale.

13. Organet e armatosura dhe civile

Krahasimi i organeve të armatosura dhe civile llogaritet ndër ndarjet më të rëndësishme, pasi çdo shtet i krijuar nuk mund të paramendohet pa ekzistimin e këtyre dy llojeve të organeve.

Organet e armatosura çdoherë kanë në dispozicion mjete për detyrim fizik (armatim), të cilat sipas nevojës mund t'i përdorin. Për

përdorimin e tyre çdoherë vendosin organet civile. Asnjë shtet me siguri nuk mund të vërtetojë që me Kushtetutën se nuk do të ketë ndryshim të pushtetit civil me atë ushtarak. Pa marrë parasysh nëse në një shtet zbatohet pushtet civil ose ushtarak, funksionimi i plotë i organeve shtetërore ndërlidhet dhe në masë të caktuar varet nga organet e armatosura – ushtri dhe polici. Organet e armatosura, për dallim nga ato civile, funksionojnë dhe disponojnë me mjete për detyrim fizik dhe numër të saktë të personave të armatosur. Dallimet ndërmjet organeve të armatosura dhe civile janë se tek të parat funksionon administrimi civil, kryetari i shtetit është person civil, ekzistojnë edhe gjykata civile. Në administratën ushtarake, kryetari i shtetit emërohet nga radha e armatës – epror i shkallës më të lartë.

14. Llojet e organeve të armatosura

Këto organe ndahen në ushtarake dhe policore dhe shtetërore.

Ushtria dhe organizimi ushtarak ndërmerr vend të veçantë si organ i armatosur, sepse disponon organizim më të madh, me mjete më efikase për detyrim fizik, krahasuar me policinë.

Ushtria shërben si fuqi mobile për mbrojtjen e shtetit nga armiqte e jashtëm në rast të agresionit, ndërsa sipas nevojës mund të përdoret edhe brenda në shtet, nëse organet policore nuk janë në mundësi të sigurojnë siguri dhe funksionim të rendit dhe paqes publike në shtet. Këto lloje të organeve funksionojnë në bazë të hierarkisë së vendosur. Ndërmjet këtyre dy llojeve të organeve çdoherë duhet të sigurohet bashkëpunim dhe koordinim reciprok të gjitha aktiviteteve për zbatimin e vendimeve të pushtetit civil.

Përveç kujdesit për sigurimin e plotë të rendit dhe paqes publike, policia njëkohësisht ka autorizim për ndjekjen dhe privimin nga liria të autorëve të veprave penale. Kjo nënkupton mbrojtje të plotë të rendit juridik të shtetit. Për dallim nga ushtria, policia është në kontakt të drejtpërdrejtë me qytetarët dhe organet civile.

Sot në botë mund të takohet edhe shtet policor, i cili krahasohet edhe me monarkitë absolutiste, ku kontrolli i tërë i administrimit i takon policisë, gjegjësisht shtetit policor.

15. Organet zgjedhore dhe jozgjedhore

Si organe zgjedhore konsiderohen organet shtetërore të cilat përmes rrugës demokratike vijnë në pushtet. Mënyra e zgjedhjes së personave zyrtar të këto organe mund të zbatohet përmes qytetarëve me të drejtë vote, përmes trupit votues, përmes trupit përfaqësues ose zgjedhjes së kryetarit në zgjedhje të drejtpërdrejta dhe të përgjithshme. Për zgjedhjen e personave në ndonjërin nga këto organe kërkohet profesionalizëm i veçantë, si për shembull, për zgjedhjen e personave për gjykatës ose prokuror publik. Në shumë shtete të botës, me qëllim të sigurimit të pavarësisë dhe përgjegjësisë së funksionit gjyqësor, disa gjykatës zgjidhen me kufizim (mandat), sikur tek ne gjykatësit në Gjykatën Kushtetuese, ndërsa gjykatësit në gjyqësorin e rregullt zgjidhen pa kufizim të mandatit, përveç në rast të dorëheqjes, vdekjes, shkarkimit në pajtim me ligjin ose plotësimin e kushteve për pension moshe.

Organet jozgjedhore rëndom emërohen nga ana e bartësve të caktuar të pushtetit publik dhe të njëjtat nuk kanë legjitimitet të drejtpërdrejtë demokratik. Në monarkitë kjo ndodh edhe me monarkun, i cili në atë pozitë vjen në mënyrë të trashëguar.

16. Organet politike, burokratike dhe ideologjike

Organe politike shtetërore llogariten ato të cilat e përcaktojnë dhe zbatojnë politikën e veprimtarisë shtetërore dhe ato çdoherë sundojnë me shtetin.

Trupi ligjvënës i sjell ligjet, e përcakton politikën shtetërore dhe e përcakton rendin ekonomik dhe politik me ndihmën e ligjit.

Në këto organe, kryetari i shtetit dhe qeverisë janë të kufizuar me Kushtetutë dhe ligj. Në Republikën e Maqedonisë, këtyre organeve u mundësohet njëkohësisht të sjellin vendime diskrete.

Organi politik çdoherë është kolektiv dhe profesional, në çdo shtet bashkëkohor organet politike i zgjedhin qytetarët, por ekzistojnë edhe organe politike, të cilat nuk janë të zgjedhura nga qytetarët, si për shembull, në monarkitë absolutiste, në regjimet ushtarake politike, etj.

Aparati shtetëror i çdo shteti përbëhet nga:

- 1) trupi përfaqësues (organ ligjvënës) dhe
- 2) organi ekzekutiv politik.

Aparatin burokratik të shtetit e përfaqësojnë organet gjyqësore dhe administrative. Këto organe duhet të përbëhen nga personal profesional. Gjyqësori konsiderohet pjesë e aparatit burokratik të shtetit. Në çdo shtet bashkëkohor, gjyqësori duhet t'i garantojë të drejtat themelore të njeriut dhe qytetarit dhe njëkohësisht të jetë bartës i zbatimit të sanksionimit të veprave penale.

Aparati ideologjik përbëhet nga organizata, ente dhe shërbime të ndryshme, pavarësisht nëse janë në përbërje të shtetit ose gjenden nën kontroll të veçantë financiar. Këtu bëjnë pjesë veprimtari të ndryshme arsimore, kulturore dhe informative, të cilat janë me rëndësi të veçantë, siç janë radio televizioni shtetëror, shtëpitë botuese informative, etj.

17. Organet vendimmarrëse dhe ekzekutive

Kjo ndarje është pasojë e zbatimit të parimit të ndarjes së punës në kuadër të aparatit shtetëror. Që të funksionoi ky parim, nevojitet ekzistimi i specializimit të organeve shtetërore dhe kryerje profesionale e veprimtarive përkatëse. Në këtë drejtim, nevojitet që disa organe të vendosin, ndërsa disa tjera të specializohen për zba-

timin e vendimeve të tilla. Duke u nisur nga vendosja hierarkike e organizimit shtetëror, organet shtetërore përcaktohen si më të larta dhe më të ulëta. Organi më i ulët çdoherë duhet ta zbatojë vendimin e miratuar nga organi më i lartë. Organi më i ulët mund të sjellë vendime vetëm nëse fiton pëlqim nga organi më i lartë.

18. Organet shtetërore kolektive dhe individuale

Ndarja e organeve shtetërore në kolektive dhe individuale çdoherë përcaktohet nga ajo nëse në emër të organit vendos një ose më tepër persona.

Organi kolektiv formohet kur për zbatimin e veprimtarisë së caktuar shtetërore dhe për sjelljen e vendimeve nevojitet përgatitje e veçantë, luftë e mendimeve dhe shprehje e qëndrimeve të ndryshme. Shembull për organe kolektive janë: parlamenti, qeveria, këshillat gjyqësor, porotat, etj.

Organ shtetëror individual është ai që përfaqësohet nga një person. Në përbërjen e këtij organi ekzistojnë edhe persona dhe shërbime tjera, por të gjithë këta punojnë nën kontrollin e një personi. Pa marrë parasysh numrin e personave që i ndihmojnë individit i cili e përfaqëson organin shtetëror, ai ka të drejtë të sjellë vendime në mënyrë të pavarur, në emër të organit. Shembull për organ individual është shefi i shtetit (kryetari i republikës ose monarku). Organet individuale formohen kur ka nevojë për sjellje dhe zbatim të shpejtë të çështjeve përkatëse.



Për dallim nga organi individual ku vendos një person, tek organi kolektiv sidomos është e theksuar çështja e kuorumit. Në kuorum nënkuptohet numri minimal i anëtarëve të trupit kolektiv që duhet të merr pjesë në punën e tij, i cili duhet të deklarohet “për” në mënyrë që vendimi të konsiderohet i miratuar.

Në hyrjen në të drejtën shpjegohen dy lloje të kuorumit (shumicës): i rëndomtë – i thjeshtë dhe i kualifikuar.

1. Për shumicë të rëndomtë (të thjeshtë) kërkohet prezenca e më së paku gjysmës plus njërit nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të trupit kolektiv. Ekzistojnë dy lloje të shumicë së rëndomtë: relative dhe absolute. Për shumicë relative duhet të votojnë më së paku gjysma plus njëri nga anëtarët e *pranishëm* të trupit kolektiv. Për shumicë absolute duhet të votojnë më së paku gjysma plus njëri nga *gjithë* anëtarët e trupit kolektiv.

2. Shumicë e kualifikuar kërkohet kur për funksionimin e trupit kolektiv, gjegjësisht për sjellje të një vendimi, duhet të votojnë më së paku dy të tretat, ose tre të katërtat nga numri i përgjithshëm i gjithë anëtarëve të trupit kolektiv.

Cila shumicë do të zbatohet, çdoherë do të varet nga rëndësia e sjelljes së vendimeve të caktuara për akte juridike. Votimi kryhet në tri mënyra: "për", "kundër" dhe "përmbajtur".

**Figura 9****Figura 10**

Pyetje:

1. Shpjegoni nocionin organizim shtetëror në kuptimin më të gjerë dhe më të ngushtë të fjalës!
2. Prej kujt duhet të përbëhet shtetit, që të mund të funksionojë?
3. Mbi cilat parime bazohet organizimi shtetëror?
4. Përkufizo nocionin organ shtetëror?
5. Si ndahen organet shtetërore?
6. Dallimi ndërmjet organeve shtetërore të armatosura dhe civile?
7. Cilat janë organe shtetërore zgjedhore, e cilat jozgjedhore?
8. Çfarë nënkuptohet nën nocionin aparat burokratik i shtetit?
9. Çfarë është kuorumi?

KAPITULLI VIII

Sundim i të drejtës

1. Sundim i të drejtës (nacioni)

Pyetja kush duhet të sundojë, njerëzit ose ligjet, është parashtruar që në Greqinë antike. Në lidhje me këtë problem, në mendimin juridik-politik zhvillohen dy koncepte: sundim i të drejtës dhe shtetit juridik, të cilat në teorinë juridike-politike rëndom barazohen.

Në Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, si vlerë themelore është miratuar koncepti i sundimit të së drejtës, të cilin këtu shkurtimisht do ta arsyetojmë.

Koncepti sundim i të drejtës zhvillohet në traditën anglo-saksone, si rezultat i luftës për kufizim të autorizimeve mbretërore dhe pushtetit të administratës. Esenca e konceptit është kufizimi i arbitrarizmit të bartësve të pushtetit, gjegjësisht edhe ata që sundojnë duhet të respektojnë rregulla dhe pushteti i tyre duhet të vendoset në korniza juridike. Sundimi i të drejtës paraqet kundërshtim i absolutizmit, gjegjësisht sundimit absolutist. Sundimi i të drejtës pengon çdo lloj të arbitrarizmit dhe sipas konceptit të gjithë cenesit pësojnë përgjegjësi njësoj, përfshirë edhe bartësit e pushtetit.

Secila kushtetutë demokratike e garanton sundimin e të drejtës si parim të demokracisë.

Këtë koncept mund ta interpretojmë në kuptimin më të ngushtë dhe më të gjerë të fjalës. Në kuptimin më të ngushtë domethënë parim i qeverisë së kufizuar, ndërsa në kuptimin më të gjerë është

korpus i vlerave dhe barazohet me korpusin e të drejtave dhe lirive njerëzore.

Realiteti normativ (norma shoqërore dhe ligje natyrore)

Natyra e cila na rrethon dhe shoqëria të cilën e përbëjmë ne njerëzit, bazohet në norma të caktuara. Ligjet natyrore, për dallim nga normat shoqërore, paraqesin rregulla sipas të cilave ndodhin dukuritë natyrore. Ato veprojnë pavarësisht vullnetit dhe vetëdijes së njeriut. Njeriu rëndom është i pafuqishëm të ndikojë mbi ligjet natyrore, por vetëm e adapton jetën e tij ndaj tyre, për shembull, ligji për gravitacionin.

Shoqëria është bashkësi e organizuar e njerëzve, në të cilën ato futen në marrëdhënie reciproke të rregulluar me norma. Mbijetesa dhe funksionimi i shoqërisë nuk mund të paramendohet pa norma.

Normat të cilat i krijon shoqëria (të organizuara ose të paorganizuara) i dedikohen vetëdijes së njeriut dhe e përcaktojnë sjelljen e tij. Sa dhe çfarë norma shoqërore do të krijohen në shoqëri, çdoherë varet nga shkalla e zhvillimit të saj. Çdoherë kur cenohet norma shoqërore, zbatohet sanksion. Normat në përgjithësi kanë dy kuptime: *imperativ* ose *normativ*, kur përshkruajnë si duhet të jetë diçka dhe *indikativ*, kur vetëm e vërtetojnë atë që ndodh.

Lloje të normave shoqërore. Në shoqëri takohen më tepër norma shoqërore dhe klasifikimi i tyre mund të përcaktohet në mënyra të ndryshme. Normat shoqërore në shkencën juridike mund të ndahen sipas përmbajtjes dhe formës. Sipas përmbajtjes, ato ndahen në morale, ekonomike, religjioze, etj. Sipas formës, normat shoqërore sërish mund të klasifikohen, edhe atë: sipas miratuesit, sipas procedurës, sipas mjeteve dhe sipas formës së jashtme. Sipas kriterit miratues i normës, dallojmë norma që i miraton shoqëria e organizuar ose e paorganizuar (difuze).

Në teorinë juridike, normat juridike ndahen në norma teknike dhe norma shoqërore në kuptim më të ngushtë. Nën norma tekni-

ke nënkuptohen rregulla të caktuara të cilat e përcaktojnë sjelljen e njeriut ndaj njeriut, gjegjësisht adaptimin e saj ndaj jetesës së njerëzve. Ato kanë për qëllim ta lehtësojnë jetën e njerëzve. Këto norma nuk kanë sanksion dhe formohen sipas të dhënave përkatëse teknike, si për shembull, në sferën e ndërtimtarisë, aviacionit, industrisë ushqimore, etj.

Normat shoqërore në kuptimin më të ngushtë janë norma të cilat krijohen spontanisht, si për shembull, moral, norma zakonore të cilat krijohen me vetëdije, në mënyrë të planifikuar, nga ana e njerëzve për arritje të qëllimeve përkatëse. Sipas sanksioneve, ato mund të jenë sikur norma prapa të cilave qëndron detyrim fizik, ndërsa sipas kriterit mund të zbatohet sanksion nga shoqëria difuze dhe nga shoqëria e organizuar.

Zakoni është normë tepër e rëndësishme e pashkruar shoqërore, të cilën e krijon dhe zbaton shoqëria e paorganizuar. Zakonet paraqiten me përsëritje afatgjate dhe të vazhdueshme të një sjelljeje në një mjedis të njëjtë shoqëror. Ato krijohen në bazë të përsëritjes spontane së sjelljes përkatëse, rëndom në lidhje me ngjarje të rëndësishme në jetën e njerëzve, sikur: hyrje në martesë, lindje e fëmijës, vdekjes, etj. Për shembull, gjatë futjes në martesë, zakoni është organizimi i ahengut, dasmës. Zakonet i takojmë në gjitha shoqëritë dhe ato dallohen nga shteti në shtet. Nëse vjen deri në cenim të zakonit, pason sanksion nga ana e anëtarëve të bashkësisë përkatëse. Sanksioni mund të jetë tepër i butë (për shembull, përqeshje, përbuzje, kritikë), por mund të jetë edhe shumë i rëndë (për shembull, mundim, marrje e jetës). Është e njohur se në disa mjedise konservative, gjakmarrja paraqet zakoni. Zakonet si norma shoqërore kanë karakter konservativ.

Morali paraqet një lloj të normës së pashkruar shoqërore që paraqitet në mënyrë të paorganizuar. Morali, bashkë me religjionin, është forma më e vjetër e vetëdijes shoqërore. Jeta e përbashkët e njerëzve prodhon edhe përvoja dhe kriteret të përbashkëta për të

mirën dhe të keqen. Kështu, njerëzit nga bashkësia e njëjtë rëndom kanë edhe pikëpamje të njëjta ndaj jetës, çfarë është e dëmshme dhe e keqe për bashkësinë dhe nga ana tjetër çfarë është e mirë dhe e dobishme. Njerëzit nuk i krijojnë normat morale në mënyrë arbitrare, por ato formohen në bazë të kushteve dhe rrethanave përkatëse. Njeriu në procesin e socializimit të tij i miraton edhe normat e vlefshme morale në bashkësinë e tij.

Sanksioni moral ka dy dimensione, edhe atë: të brendshëm ose autosanksion (ndërgjegje) dhe të jashtëm (përbuzje morale, neveritje morale ndaj cenesit të moralit).

2. Origjina dhe kuptimi i termit drejtësi

Nocioni drejtësi përdoret tepër dhe ka më tepër kuptime. Kur përmendim "drejtësi", të gjithë përafërsisht e dimë për çka bëhet fjalë, por shumë vështirë mund ta shpjegojmë të drejtën në një përkufizim. Në drejtësi na asocojnë shumë nocione tjera nga përditshmëria, sikur: gjykim, padi, dënim, gjykata, rregulla dhe normal, dokumente, ligj, kushtetutë, shtet, politikë, noter, marrëveshje, verifikim, vulë, firmë, dëshmi, delikt, cenim, moral, zakon, procedurë, aktvendim, lutje, ankesë, avokat, jurist, fakultet juridik, polici, burg, etj. Gjitha këto nocione hyjnë në sferën e nocionit drejtësi.

Ekzistojnë shumë përkufizime të së drejtës, të cilat e përkufizojnë në mënyra të ndryshme këtë fenomen, varësisht cilit sistem teorik i takojnë.

Origjina e fjalëve me të cilat shënohen disa nocione na flet shumë për esencën e atyre nocioneve, andaj me qëllim të kuptuarit më të lehtë të nocionit drejtësi, së pari do ta arsyetojmë origjinën e fjalës "e drejtë".

Në gjuhën greke për termin e drejtë ndërlidhen fjalët greke *themis* dhe *dike*. Themis është fjalë tepër e vjetër që ka domethënie bazë, esencë. Andaj edhe kuptimi i saj është vendosje, inkorporim

dhe themelim. Dike i shënon ligjet, gjegjësisht rregullat e miratuara nga shteti.

Në gjuhën euro-perëndimore (franceze, italiane, spanjolle, angleze, gjermane), termi e drejtë nxirret nga shprehje latine *directum* (*droit, diritto, derecho, right, resht*) dhe në kuptimin fizik reflekton rrugë të drejtë, vijë të drejtë, kënd të drejtë, ndërsa në kuptimin zakonor-moral reflekton drejtësi, pajtueshmëri. Në gjuhën latine rrënjë të njëjtë kanë edhe fjalët *regere* (sundim), *rex* (mbret), *regnum* (mbretëri) dhe *regula* (regullë). Në gjuhën latine ekziston edhe një fjalë që shënon të drejtën, ajo është fjala *ius*. Rreth kuptimit të kësaj fjale ekziston mospajtim. Sipas njërit interpretim, kjo fjalë është nxjerrë nga folja *iubeo* (urdhër). Sipas Gaj-it, një nga juristët më të njohur në Romën e vjetër, “*Lex est quod populus iubet atque constituit* (Ligj është gjithçka që populli do ta urdhërojë)”. Sipas një interpretimi tjetër, *ius* shënon ndonjë lidhje (iungere) ose është derivat i fjalës *iurare* (i shenjtë, i pastër).

3. Nocioni dhe karakteri i të drejtës

Përcaktimi më dominues i të drejtës është sistem i normave të cilat e rregullojnë jetën shoqërore të njerëzve, të cilat norma përshkruhen dhe sigurohen nga shteti. Ky përkufizim nuk e zbulon deri në fund esencën e të drejtës. Në drejtim të shpjegimit më të saktë të nocionit dhe karakterit të së drejtës, do të paraqesim disa nga tiparet e tij themelore.

E drejta është dukuri shoqërore dhe pjesë nga sistemi më i gjerë shoqëror. Kjo do të thotë se të drejtën e gjejmë në mesin e njerëzve, gjegjësisht ajo i rregullon marrëdhëniet e ndryshme shoqërore ose ndërnjerëzore (pronë, trashëgimi, martesë, regjistrim në fakultet, blerje, shitje, vrasje, sundim dhe relacione tjera ndërmjet njerëzve). E drejta varet nga shoqëria, domethënë nga mentaliteti i njerëzve, nga mënyra e jetesës historike, nga zhvillimi ekonomik, nga sistemi politik i një shteti. Gjitha shtetet nuk kanë të drejtë të njëjtë. Kështu

për shembull, e drejta e Republikës së Maqedonisë nuk është e njëjtë me të drejtën e Suedisë ose Iranit. Në Iran, për shembull, ekziston poligamia, një burrë mund të ketë disa gra dhe kjo juridikisht është e lejuar, legale. Mandej, në botë ekzistojnë sisteme të ndryshme juridike, por dominuese janë sistemi juridik Anglosakson (Britani e Madhe, SHBA, Australi) dhe sistemi juridik Kontinental ose Romak (Francë, Itali, Maqedoni, etj.). Në këto sisteme juridike, e drejta krijohet dhe zbatohet në mënyra të ndryshme. Madje edhe nëse shikoni një film amerikan i cili përpunon temë ku ka gjykim ose hetim, menjëherë vërehet se rrjedha e procedurave gjyqësore, sistemi gjyqësor, fuqia dhe pozita e gjykatësve dhe avokatëve është e ndryshme krahasuar me ne.

E drejta romake (Ius Romanum). Konsiderohet që esencë e të drejtës bashkëkohore në masë të madhe është e drejta e zbatuar në shtetin antik romak (Roma e vjetër). Kjo e drejtë quhet e drejtë romake, e cila është zbatuar më tepër se 1300 vite. Romakët jo vetëm që krijojnë ndërtesa, rrugë, ujësjellës dhe buste, por e kanë krijuar edhe sistemin më të mirë juridik në histori. Fuqia e shtetit romak ka qenë rezultat i ligjeve të shkëlqyeshme dhe zbatimit të tyre dhe i taktikës së mirë ushtarake. Në përbërjen e Romës së vjetër për periudhë të caktuar ka qenë edhe territori i Maqedonisë.

E drejta romake është trashëgimi e përbashkët, sepse në kohën kur është zbatuar, shteti romak është shtrirë në territorin e thuhet tërë Evropës së sotme, por edhe më gjerë, në pjesë të Afrikës dhe Azisë.

E drejta romake studiohet në vitin e parë në gjitha fakultetet juridike tek ne dhe në botë, sepse u ndihmon studentëve më lehtë ta kuptojnë të drejtën e sotme. Ajo është hyrje në të drejtën civile dhe disiplinat tjera juridike. Studentët të cilët do ta mësojnë mirë të drejtën romake në fakultet, më lehtë do ta kenë në lëndët: e drejtë reale, e drejtë obligative, e drejtë trashëguese, e drejtë civile-procesore dhe në lëndët tjera.

Siç thuhet se “gjitha rrugët shpien në Romë”, ashtu edhe rruga e studimit të së drejtës bashkëkohore shpie ndaj së drejtës romake. Juristë më të spikatur romak ishin Ulpijani, Gai, Pauli, Papinijani, etj. Ashtu siç filozofët grek janë të pakalueshëm në trajtimin filozofik të çështjeve për njeriun, natyrën dhe shoqërinë, këta teorik juridik romak janë të paarritshëm në përpunimin teorik të fenomeneve juridike dhe janë pishtarë të shkencës juridike (jurisprudencës).

Në kuadër të së drejtës romake paraqiten edhe kodifikimet e para të së drejtës, gjegjësisht përmbledhje tematike të rregullave juridike të cilat kanë pasur rëndësi të madhe praktike, sepse e kanë sistematizuar dhe klasifikuar të drejtën (Ligji i XII tabelave, codex Gregorianus, codex Hermogenianus, codex Theodosianus, Novellae leges, Lex Romana Visigothorum, Edictum Theodorici, Lex Romana Burgundionum dhe kodifikimi i Justinijanit).

E drejta romake është veçanërisht e rëndësishme edhe për Maqedoninë. Sunduesi më i madh, në kohën e të cilit kanë qenë të rregulluara gjitha ligjet e deriatëhershme, ka qenë Justinijani i Parë, i lindur në vendin Taor, në afërsi të Shkupi. Për nder të tij, edhe Fakulteti juridik në Shkup mban emrin e tij. Vepra e krijuar nga ai quhet Kodifikimi i Justinijanit.

Në të drejtën romake për herë të parë kryhet ndarje e qartë e të drejtës në të drejtë publike dhe private. E drejta publike i dedikohet rregullave për pozitën e shtetit, ndërsa ajo private për pozitën e individëve. Sipas Romakëve, e drejta është krijuar për shkak të njerëzve dhe duhet të shërbej për rregullimin e marrëdhënieve të tyre. Juristët romak i kanë krijuar parimet themelore juridike: të jetohet ndershëm, të mos dëmtohet tjetri dhe çdokujt t’i takojë ajo që e meriton.

Rregullat themelore të cilat sot i zbatojmë për martesën dhe familjen, për pronësinë, për marrëveshjet, për trashëgiminë, për procedurat gjyqësore, janë pothuajse të ngjashme me rregullat e të drejtës romake.

Për shkak të rëndësisë së madhe, e drejta romake është zbatuar edhe në Mesjetë. Ajo është pranuar në Bizanti, por edhe në territorin e Evropës perëndimore. E drejta romake ka qenë burim edhe për krijimin e të a.q. kode civile, të cilat zbatohet edhe sot e kësaj dite në Francë, Gjermani, Itali, Holandë, Austri, etj. Konsiderohet që edhe gjatë përpjekjeve për rregullim të përbashkët të së drejtës së sotme private evropiane, sërish rol dominues do të ketë e drejta romake, për shkak të zbatueshmërisë, praktikës dhe saktësisë.

Gjuha latine është gjuha e të drejtës romake. Për çdo ditë dëgjojmë dhe përdorim fjalë latine të cilat tërësisht janë ndërmarrë nga e drejta romake, sikur: avokat, argument, testament, legal, legjitim, depozitë, garanci, konsensus, ekstradim, status, sanksion, petition, azil, ministër, dekret, suprimim, apel, delegacion, interpelancë, konstituim, senat, lustrim, mandat, administratë, noter, konsull, dorëzani, delikt, dividendë, etj.

Juristë nga shtete të ndryshme në komunikimin reciprok përdorin mijëra shprehje nga e drejta romake, përmes të cilave kuptohen më lehtë. Në gjitha librat e të drejtës do të takojmë shumë nocione latine. Nocione të tilla janë: *erga omnes* (ndaj të gjithëve); *de jure* (sipas së drejtës); *persona non grata* (person i padëshiruar në ndonjë shtet). Shpesh përdoren edhe fjalë të urta nga e drejta romake, me qëllim të shprehjes së qëndrimit ose pohimit përkatës, si për shembull: *Da mihi facta, dabo tibi ius* (Më jep faktet, unë do ta zbatojë drejtësinë); *Proprietas est plena in re potestas* (Prona është pushtet i plotë mbi gjësendet); *Nemo iudex in causa sua* (Askush nuk mund të gjykojë në rast ku edhe ai është i tanguar), etj.

Në të drejtën romake është zhvilluar edhe aftësia e shkrimit të ligjeve, por edhe të dispozitave tjera. Fillimet e avokaturës dhe në përgjithësi të profesionit juridik, gjithashtu janë në të drejtën romake. Në fakt, në Romën e vjetër me të drejtën së pari janë marrë priftërinjtë (*pontifices*), mirëpo me zmadhimin e komunikacionit juridik kemi veçim të çështjeve religjioze nga ato juridike dhe me të drejtën kanë

filluar të merren juristë joreligjioz. Puna e juristëve është përbërë nga dhënia e mendimit dhe përgjigjeve për probleme të caktuara juridike (respondere), përpilim i formularëve për probleme përkatëse juridike (cavere) dhe përfaqësim në konteste (agere). Është interesant të përmendet se përfaqësimin e kanë përgatitur juristët, ndërsa para gjykatës e kanë prezantuar oratorë të veçantë (oratores, advocati).

Juristë i mirë ka qenë vetëm oratori i mirë. Oratori më i njohur ka qenë Ciceroni, që thoshte se çdo folës duhet ta animojë dhe mëson publikun. Oratoria bashkëkohore është krijuar në themelet e oratorisë juridike romake.

Në Republikën e Maqedonisë tradicionalisht çdo vit organizohet mbrëmja oratorike “Ivo Puhan”, në Fakultetin juridike “Justinijani I” në Shkup. Në kuadër të përgatitjeve për këtë manifestim, studentët-garues i mësojnë edhe rregullat për fjalim të mirë të krijuara nga oratorët romak, ndërsa studentët më të mirë fitojnë edhe shpërblime.

E drejta është pjesë e realitetit normativ. Themi kështu, sepse përshkruan “atë që duhet të jetë”, e që shpesh dallon “nga ajo që është” (realitet faktik). Përveç të drejtës ekzistojnë edhe sisteme tjera normative, siç janë morali, zakoni, normat religjioze, të cilat i rregullojnë sjelljet njerëzore. Sigurisht që këto sisteme normative ndikojnë mbi të drejtën pozitive në një shtet, sidomos kur ajo krijohet por edhe zbatohet.

E drejta është strukturë autonome, e bazuar në vlerat themelore sociale. Thënë thjeshtë, ajo mbron vlera të caktuara, siç janë drejtësia, rendi, paqja dhe liria.

E drejta përbëhet nga norma. E drejta krijohet me paramendim, përmes krijimit të normave. Norma juridike është elementi esencial i të drejtës, është atom i saj, elementi më i thjeshtë që më tutje nuk mund të thjeshtësohet. Shembull për normë juridike është: çdo qytetar i cili realizon të ardhura, obligohet të paguaj tatim, nëse nuk e bën këtë, obligohet të paguaj dënim ose të vuaj dënim me burg. Në

jetën e përditshme, shpesh ndodh që norma juridike të barazohet me nen ose element tjetër teknik nga ligji ose akt tjetër të përgjithshëm juridik. Rrallë ndodhë që një nen nga ligji të përputhet me një normë juridike. Sipas rregullit, një normë juridike rëndom është e shprehur përmes më tepër neneve nga një ligj i njëjtë ose akt tjetër juridik. Në çdo shoqëri ose shtet ekzistojnë procedura të veçanta sipas të cilave krijohen, zbatohen, ndryshohen dhe ndërpriten normat juridike.

Normat juridike të cilat rregullojnë një marrëdhënie shoqërore, më tutje grupohen në institute juridike. Ekzistojnë institute normative juridike (marrëveshje, testament, martesë, huazim, pronësi, shtetësi) dhe organizime juridike (gjykatës, prokurori). Gjatë zhvillimit historik të së drejtës formohen më tepër degë juridike (e drejtë kushtetuese, familjare, administrative, tregtare, obligative, penale, e punës). Degët juridike janë krijuar si rezultat i veprimtarisë legjislative, të kodifikimeve ose nevojës së juristëve për grupim të normave dhe instituteve të afërta. Për konstituimin e degëve juridike kontribuojnë klasifikimet e ndryshme që i bëjnë shkencat juridike, të cilat krijojnë edhe grupe më të gjera të së drejtës në bazë të kriterëve të ndryshme. Sipas kriterit territorial të çdo shteti, dallojmë të drejtë të brendshme (nacionale) dhe ndërkombëtare. Sipas formës dhe përmbajtjes së normave juridike, dallojmë të drejtë materiale dhe formale. E drejta materiale e rregullon sjelljen e subjekteve (për shembull, në të drejtën penale përshkruhet cilat sjellje llogariten të kundërligjshme dhe përshkruhet dënimi për llojet e tilla të sjelljes), ndërsa në të drejtën formale përcaktohet procedura për zbatimin e normës së caktuar juridike (për shembull, në të drejtën penale procesore, ekziston procedurë për të përcaktuar nëse i akuzuari me të vërtetë është autor i sjelljes së kundërligjshme, nëse ka faj dhe procedura për shqiptimin e dënimit).

E drejta është sistem hierarkik i normave. Sistematizimi hierarkik i të drejtës është ndër karakteristikat e veçanta të saja. Secila normë ka vendin e saj në hierarki. Thënë juridikisht, secila normë e bazon vlefshmërinë e saj mbi ndonjë normë tjetër më të lartë, deri tek norma më e lartë (Kushtetuta). Në të drejtën nuk lejohet përplasje e

normave. Nëse në jetën e përditshme ndodh përplasje e normave, më kohë parashikohen procedura dhe rregulla për zgjidhjen e asaj përplasjeje. Këtu duhet të përmendet se në praktikën dhe shkencën juridike janë krijuar disa parime për zgjedhjen e antinomive në sistem, edhe atë: *lex superior derogate inferior* (ligji më i lartë e abrogon më të ulët); *lex posterior derogate priori* (ligji i fundit e abrogon të mëparshmin); *lex specialis derogate gjenerali* (ligji i veçantë e abrogon të përgjithshmin). Gjithashtu, secili sistem juridik ndërton norma të veçanta juridike për mjetet juridike dhe për procedurat me të cilat përcaktohen antinomitë e sistemit.

E drejta ka karakter të detyrueshëm, e kjo do të thotë se sanksionin e siguron dhe zbaton shteti. Indikator kyç për njohjen nga normave juridike nga llojet tjera të normave është pikërisht sigurimi i sanksionit nga ana e shtetit. Sipas Hans Kelzen, jurist i njohur, e drejta është sistem i detyrueshëm. Sipas tij, ajo që është e përbashkët për të drejtat e ndryshme, për shembull, për të drejtën e Babilonisë, Zvicrës dhe SHBA-ve, është teknikë shoqërore që sjellja e dëshirueshme të realizohet përmes kërcënimit të përdorimit të masës së detyrueshme. Detyrimi tek e drejta është i parashikuar, i qartë, i përcaktuar dhe i institucionalizuar. E drejta bashkëkohore karakterizohet me ndryshim të funksionit tradicional mbrojtës – represiv me funksionin promociional, gjegjësisht e drejta ka tendencë që sa më pak të ndëshkojë, ndërsa më shumë përmes teknikave të ndryshme të promovon sjellje të dëshirueshme shoqërore.

E drejta ka sërë funksione sociale, nga të cilat i veçojmë: funksionin e rregullimit, funksionin e kontrollit social dhe funksionin integrues.

Funksion i parë dhe themelor i të drejtës është rregullimi i raporteve ndërnjerëzore dhe jetës së përbashkët. E drejta është rregullim më specifik dhe më kompleks shoqëror (për dallim nga rregullimet tjera: moral, zakon, religjion). Në rregullimin juridik ekziston plan, paramendim si duhet diçka të rregullohet. E drejta i parashikon sjelljet e

ardhme. Rregullimi juridik ka gjenezën e tij, së pari ka qenë i vobektë, i ka zëvendësuar normat religjioze dhe zakonore, ndërsa sot theksohet problemi me mbinormimin (normim i tepruar) juridik. Karakteristika themelore të rregullimit juridik janë: përcaktimi i parakohshëm, veprimtaria sistematike, ai është rregullim i detyrueshëm dhe në këtë rregullim kemi prezencë të interesave (rregullatorë dhe të rregulluar).

Funksion i radhës i të drejtës është ai i kontrollit social, domethënë e drejta kontrollin në ç'mënyrë ne i përshtatim sjelljet tona ndaj normave dhe vlerave ekzistuese. Kontrolli social mund të jetë: joformal, kur normat spontanisht ndikojnë mbi vetëdijen e njerëzve dhe formal, kur normat veprojnë në mënyrën e përkohshme dhe sigurohen me forcë.

Funksion tepër i rëndësishëm i të drejtës është ai integrues, domethënë e drejta e integron shoqërinë. Njerëzit kanë vlera dhe interesa të ndryshme, ata nuk janë të njëjtë (të arsimuar dhe të paarsimuar, të rinj dhe të vjetër, të sëmure dhe të shëndoshë, burra dhe gra, krishterë, mysliman dhe budistë, me pikëpamje të ndryshme politike, të pasur dhe të varfër dhe ndarje tjera). Përmes së drejtës kryhet harmonizim i vlerave dhe interesave të përbashkëta. E drejta është mekanizëm arbitrar.

Pyetje:

1. Çfarë nënkuptohet nën konceptin sundim i të drejtës?
2. Shpjegoni dallimin ndërmjet moralit dhe zakonit?
3. Cilat lloje të normave shoqërore ekzistojnë?
4. Cili është dallimi ndërmjet normave juridike dhe normave morale?
5. Çfarë është sanksioni moral dhe si ndikon mbi vetëdijen e njerëzve?
6. Si krijohen zakonet (adetet)?

KAPITULLI IX

Rendi juridik

1. Rendi juridik (nocioni dhe elementet)

Në shkencën juridike, rendi juridik si nocion përcaktohet si unitet i normave juridike dhe sjelljes njerëzore në shoqëri konkrete ose, sipas përcaktimit tjetër, si rend i organizuar i marrëdhënieve shoqërore të rregulluara me norma juridike.

Nëse nuk mund të vendoset një lidhje e qëndrueshme ndërmjet normës juridike dhe sjelljes njerëzore, atëherë norma juridike do të jetë e pavlerë.

Disa teoricien konsiderojnë se duhet të dallohet nocioni rend shoqëror nga rendi juridik, sepse rendi shoqëror që paraqitet si përmbledhje e gjitha marrëdhënieve shoqërore ndërmjet njerëzve, përveç atij juridik i përfshin edhe rendin moral, politik, shoqëror, ekonomik, etj. Duke u nisur nga përcaktimi i rendit juridik se është i përbërë nga norma juridike dhe sjellje njerëzore, mund të përcaktohet se ai është i përbërë nga dy elemente: normativ dhe faktik.

Elementin normativ e përbëjnë: normat juridike, aktet juridike dhe marrëdhëniet juridike.

Elementi faktik është i përbërë nga: subjektet e të drejtës dhe veprimet materiale (trupore), gjegjësisht sjelljet njerëzore.

Në mënyrë analoge, rendi juridik është i përbërë nga normat juridike, aktet juridike, subjektet e të drejtës, sjelljet juridike dhe

marrëdhëniet juridike. Kur bëhet analizë ndërmjet pjesës normative dhe faktike, obligueshëm duhet të theksohet se ndërmjet tyre ekziston një ndërlidhje dhe varshmëri reciproke.

Elementi normativ dhe faktik nuk mund të ekzistojnë njëri pa tjetrin, sepse ato paraqesin mjet dhe instrument të thjeshtë, me ndihmën e të cilëve rregullohen marrëdhëniet në bashkësi konkrete shoqërore me rend rreptësisht të caktuar. Krahasuar me sistemin juridik i cili studiohet më vonë, që është më statik dhe që paraqet përmbledhje të normave të përgjithshme juridike, rendi juridik është kategori e ndryshueshme, varësisht nga ndryshimet në marrëdhëniet shoqërore.

2. Nocioni dhe elementet e normës juridike

Norma juridike si normë shoqërore paraqet pjesë përbërëse të elementit normativ të rendit juridik. Si rregulla për sjelljen e njerëzve, ato sigurohen dhe mbrohen me aparatit shtetëror të detyrimit.

Norma juridike, si element më i rëndësishëm i të drejtës, nuk mund të ndahet në elemente të thjeshta të cilat mund të përfaqësojnë drejtësi. Nga analiza e normës juridike mund të përcajtohen tre elementet e saj: hipoteza (supozimi), dispozicioni dhe sanksioni.

3. Hipoteza (supozimi)

Hipoteza si element i normës juridike i përmban kushtet përmes të cilave realizohet elementi kryesor i normës juridike, gjegjësisht dispozicioni ose sanksioni.

Hipoteza (supozimi) vetvetiu nuk është normë, që domethënë se nuk ka karakter juridik. Ajo ofron përshkrim të kushteve për zbatim të elementit të dytë ose të tretë të normës juridike. Hipotezë

rëndom kanë normat e përgjithshme juridike, ndërsa tek normat individuale juridike zbatimi i saj është sipas nevojës. Hipoteza mund të jetë e dispozitës (për shembull, secili që ka pronë obligohet të paguaj tatim) dhe e sanksionit (për shembull, secili që vjedh, do të dënohet).

Nga kjo mund të konkludohet se në rastin e parë, ai që nuk ka pronë nuk do të paguajë tatim dhe në rastin e dytë, ai që nuk do të vjedhë rrjedhimisht nuk do të dënohet.

Sipas përcaktimit, hipotezat mund të jenë: plotësisht të përcaktuara, pamjaftueshëm të përcaktuara dhe plotësisht të pacaktuara.

4. Dispozicioni (llojet e dispozicioneve)

Fjala dispozicion rrjedh nga fjala latine disposition, që domethënë "disponim". Llogaritet pjesë qendrore e çdo norme juridike dhe e përcakton sjelljen e subjekteve të së drejtës.

Me dispozicionin përcaktohet sjellja e njerëzve në situata të caktuara jetësore. Dispozicioni paraqet urdhër për sjelljen e njerëzve. Për dallim nga hipoteza, dispozicioni ka karakter normativ dhe asnjë normë juridike si rregull për sjelljen e njerëzve nuk mund të paramendohet pa këtë pjesë.

Sipas formës së jashtme, gjegjësisht çfarë sjellje rregullojnë, dispozicionet mund të jenë: urdhëruese, ndaluese dhe autorizuese.

Me dispozicionet urdhëruese, subjekteve u urdhërohet si të sillen dhe çfarë të bëjnë. Për shembull, prindërit janë të obliguar të kujdesen dhe t'i edukojnë fëmijët e tyre.

Me dispozicionet ndaluese, subjekteve u ndalohen sjellje të caktuara. Për shembull, vrasje, mashtrim, shkaktim i dëmit, etj.

Me dispozicionet autorizuese, subjekteve të caktuara u jepen autorizime përkatëse të cilat mund t'i shfrytëzojnë nëse dëshirojnë. Si për shembull, e drejta e lutjes, ankesës, etj.

Ekzistojnë edhe dispozicione përshkruese (indikative), përmes të cilave përshkruhet sjellja, si për shembull, neni 5 paragrafi 1 nga Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë: simbolet shtetërore të Republikës së Maqedonisë janë stema, flamuri dhe himni, ose neni 62 paragrafi 1 nga Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë: Kuvendin e përbëjnë nga 120 deri 140 deputet.

Sipas shkallës së përcaktimit, dispozicionet ndahen në dy lloje: absolutisht të përcaktuara dhe relativisht të përcaktuara.

Dispozicionet absolutisht të përcaktuara njihen si norma kategorike, ku kërkesa është saktësisht e përcaktuar, nuk lejohet ndryshim dhe afatet janë të përcaktuara.

Dispozicionet relative, nga ana tjetër, u mundësojnë subjekteve të zgjedhin sjelljen për zgjidhjen e marrëdhënieve juridike. Dispozicionet relativisht të përcaktuara mund të ndahen në katër lloje: a) dispozicione alternative, b) dispozicione të cilat përmbajnë standard juridik, c) dispozicione të cilat japin të drejtë diskrete dhe ç) dispozicione dispozitive.

Dispozicionet alternative janë ato që kanë dy ose më tepër sjellje dhe subjektit referues i mundësojnë vetë të përcaktohet për njërin prej tyre. Subjekti ka të drejtën e zgjedhjes vetëm të njëjës sjellje nga vetë dispozicioni. Subjekti nuk ka të drejtë të pranohet alternativa tjera, e as të ndryshojë asgjë. E drejta e zgjedhjes tek dispozicionet alternative i takon subjektit që është bartës i obligimit, e jo subjektit që është bartës i autorizimit.

Këtë lloj të dispozicioneve mund ta takojmë tek e drejta pronësore, tregtare, trashëguuese, obligative, etj.

Përmes së drejtës diskrete ose dispozicioneve që ofrojnë pushtet (autorizim) diskret të organeve shtetërore (të cilat realizojnë autorizime publike përmes akteve juridike individuale konkrete), ofrohen dispozicione të tilla ku ekziston e drejta e zgjedhjes së njëjës nga më tepër alternativa përkatëse. Është

karakteristike se gjitha alternativat janë të ngjashme. Ndaj këtyre dispozicioneve (të cilat përcaktojnë dy ose më tepër rregulla të cilave organi shtetëror duhet t'iu përmbahet), organi shtetëror ka të drejtë të zgjedh një të sjellje sipas vlerësimit të tij. Organi shtetëror rreptësisht i ndalohej gjatë ushtrimit të pushtetit të manifestojë arbitrarizëm. Organi nuk guxon t'i keqpërdorë të drejtat e tij kundër interesave të shtetit. Nëse vjen deri në keqpërdorim nga akti që e sjell organi shtetëror, ai mund të procedohet për kundërligjshmëri.

Ky lloj i dispozicioneve takohet në të drejtën administrative, në organet e administratës të cilat kanë në dispozicion të drejtë diskrete, për shembull, dhënie të lejeve dhe akteve tjera administrative.

Dispozita dispozitive janë ato që subjekteve u mundësojnë (gjegjësisht i autorizojnë) të krijojnë dispozicion për rregullimin e sjelljes së tyre ose të subjekteve tjera. Kjo do të thotë se vetë subjekteve u lihet përcaktimi i dispozicionit. Sipas këtyre dispozitave, normat juridike mund të zëvendësohen me dispozita të cilat i sjellin vetë subjektet në raportin juridik. Nëse subjekti i autorizuar nuk i ka shfrytëzuar autorizimet nga norma dispozitive për të krijuar vetë normë juridik, atëherë marrëdhënia shoqërore zgjidhet me akt normativ juridik të cilin e sjell organ kompetent.

Këto dispozita mund të realizohen me marrëveshje ndërmjet subjekteve të autorizuar, si për shembull, gjësendin duhet të kthehet në afat prej tre muajve. Dispozitat dispozitive takohen në të drejtën pronësore, civile, ku ekziston autonomi e vullnetit të palëve, që domethënë se ato si subjekte vetë i përcaktojnë raportet e tyre.

5. Cenim i të drejtës (delikti)

Nocioni delikt rrjedh nga fjala latine deliktum – kundërvajtje. Delikti paraqet sjellje përkatëse të njeriut me të cilën cenohet dispozita e normës juridike. Ai paraqitet si supozim për zbatimin e elementit të tretë të normës juridike. Deliktet në të drejtën i konsiderojnë si veprime të vetëdijshme njerëzore dhe veprime kundërvajtëse. Kundërvajtja mund të manifestohet përmes veprimit, lëshimit ose mosveprimit. Realizimi i kundërvajtjes mund të jetë me veprim aktiv ose pasiv. Shembull për veprim aktiv është përvetësimi i gjësendit të huaj lëvizës, shkaktim i lëndimit të rëndë trupor ndaj personit tjetër. Gjatë mosveprimit, gjegjësisht veprimit pasiv, norma kërkon nga ne të veprojmë diçka, e në atë e lëshojmë, si për shembull, marrim informatë se përgatitet vrasje e personit të caktuar, në këtë rast edhe pse kemi mundësi ta pengojmë këtë vepër, ne nuk ndërmarrim asgjë, në esencë kryejmë vepër të rëndë penale.

Çdo delikt të kryer, e drejta e llogarit si të kundërligjshëm nga momenti i paraqitjes së tij dhe pala e cenuar të cilës i është shkaktuar dëm, obligueshëm dëmshpërblehet.

Sipas cenimeve që krijohen në vetë shoqërinë, deliktet ndahen në bazë të llojit të vlerave juridike: penale-juridike, civile-juridike, administrative-juridike dhe disiplinore. Në të drejtën mund të takojmë edhe ndarje në delikte publike-juridike dhe delikte private-juridike.

Deliktet penale-juridike në të drejtën llogariten delikte më të rënda, pasi e kanë kuptimin e sulmit dhe rrezikimit të rendit shoqëror të çdo shteti.

Deliktet administrative-juridike krijohen në dispozicionin e normës administrative, me të cilën mbrohen vlerat shoqërore.

Çdo subjekt që e cenon dispozicionin e normës juridike, ai kryen kundërvajtje dhe juridikisht përgjigjet për të njëjtën.

6. Sanksioni

Sanksioni paraqitet si element i tretë i normës juridike, pas hipotezës dhe dispozicionit. Te sanksioni janë përshkruar pasojat juridike të cilat paraqiten me cenimin e dispozitës së normës juridike. Aktivizimi i sanksionit e supozon ekzistimin e deliktit dhe autorit.

Përveç që përmban rregulla për sjelljen e subjektit që e cenon normën juridike, sanksioni paraqet edhe dispozicion sekondar të normës juridike. Sanksioni njëkohësisht paraqet edhe masë detyruese e cila drejtpërdrejtë zbatohet mbi cënuesin.

Cilësia dhe kuantiteti i sanksioneve përcaktohet në bazë të peshës së cenimit të normës juridike. Nëse cenimi është më i madh, atëherë edhe sanksioni është më i rëndë.

Karakteristikë e sanksioneve është karakteri imperativ (zbatim i obligueshëm), ndërsa me përjashtim mund të kenë edhe karakter diapozitiv, si për shembull, dënim i caktuar me marrëveshje në të drejtën pronësore.

Sanksionet mund të përcaktohen kundër personave fizik dhe kundër akteve juridike. Në të drejtën ekzistojnë më tepër lloje të sanksioneve, edhe atë:

1) Sanksione ndaj personave fizik, të cilat mund të ndahen sipas kritereve të ndryshme:

Sipas llojit të deliktit: penale juridike, civile juridike, administrative juridike dhe disiplinore. Sanksione sipas së mirës e cila merret: trupore, materiale dhe morale. Sipas qëllimit të sanksionit, veçojmë sanksione retributive dhe restatutive. Sipas shkallës së përcaktimit të sanksionit, dallojmë sanksione absolutisht të përcaktuara, relativisht të përcaktuara dhe të papërcaktuara.

Sanksione penale-juridike janë ato që për qëllim kanë hakmarrjen ndaj çdo kundërvajtësi të normës juridike dhe pa-

mundësimin për vazhdim të kryerjes së veprave penale. Këto sanksione janë të klasifikuara në ligjin penal, si për shembull, marrje e jetës, burgim, burgim i rëndë, dënim me para, konfiskim i pronës, etj.

Sanksione civile-juridike janë ato përmes të cilave subjektit të dëmtuar i mundësohet kompensimi i dëmit me kryerjen e cenimit të normës civile-juridike.

Sanksione administrative-juridike ose të a.q. dënime administrative parashihen për cenim të normave administrative-juridike. Të tilla janë: privim më i shkurtër nga liria, pagesë e dënimit material, etj. Gjatë kundërvajtjes disiplinore zbatohen dënime disiplinore, si për shembull, dënim për keqpërdorim të detyrës zyrtare.

7. Interpretim i të drejtës (nacioni)

Fjala interpretim në fjalorin e gjuhës maqedonase domethënë "qartësim" i kuptimit. Në zbatimin e të drejtës, ky aktivitet ndërmerr vend dhe kuptim të veçantë.

Rëndom me interpretim shpjegohet ajo që për ne ose për të tjerët nuk është mjaftueshëm e qartë. Shpesh normat juridike janë të paqarta për subjektet e të drejtës. Gjendja e këtillë e paqartësisë dhe pakuptueshmërisë së normave juridike ndikon drejtpërdrejtë mbi zbatimin dhe efikasitetin e të drejtës. Shumë herë në jetë dëgjojmë konstatime për paqartësi në ligj ose akt të caktuar. Në raste të tilla nevojitet interpretim.

Interpretimi i normës juridike mund të jetë i shumanshëm, gjegjësisht norma juridike i nënshtrohet numrit të caktuar të interpretimeve për të cilat rendi juridik ka nevojë.

8. Llojet e interpretimeve të normave juridike

Në kuadër të shkencës juridike (hyrja në të drejtën dhe teoria e shtetit), takohen dhe diskutohet për më tepër lloje të interpretimeve. Rëndom interpretimet dallojnë në bazë të mjeteve të shfrytëzuara metodologjike. Në historinë e të drejtës takojmë më tepër lloje të ndryshme të mjeteve metodologjike për interpretim. Gjithashtu edhe mjetet ndihmëse, si për shembull, gramatika, logjika, historia, etj. Pranohen si lloje të veçanta të interpretimeve dhe në këtë drejtim mund të flasim për interpretim gramatik, logjik ose historik.

Në shkencën më të vjetër, interpretimi kuptohet në aspekt më të ngushtë, gjegjësisht interpretim kanë mundur të kryejnë vetëm organet shtetërore dhe shkenca juridike. Në kohën më të re ekzistojnë dy klasifikime për interpretimin e normave juridike. Sipas të parit, interpretimi mund të klasifikohet: zyrtar, autentik, privat dhe shkencor.

Sipas klasifikimit tjetër, interpretimi mund të jetë: interpretim në proces të zbatimit dhe jashtë zbatimit të së drejtës dhe interpretim i kryer nga subjektet.

Në të drejtën pranohet klasifikimi i parë, sepse shumë qartë dhe konkretisht na mundëson t'i dallojmë tri llojet kryesore të interpretimeve, e ato janë:

- a) interpretim i organeve shtetërore,
- b) interpretim i subjekteve joshtetërore dhe
- c) interpretim shkencor.

9. Interpretimi i organeve shtetërore

Nga vetë nëntitulli rezulton se këtë interpretim mund të bëjnë vetëm organet shtetërore. Duke u nisur nga ndarja klasike e funksioneve që i kryejnë organet shtetërore, dallohen tri llojeve të interpre-

timeve, edhe atë: ligjvënës (autentik), nga organet e administratës dhe gjyqësor.



Interpretim ligjvënës. Organi ligjvënës është ai që parimisht ka rol të miraton norma të përgjithshme juridike (në formë të kushtetutës dhe ligjeve). Nëse ai shpesh paraqitet edhe në rol të interpretuesit, duke e marrë parasysh vendin e kushtetutës dhe ligjit në hierarkinë e rendit juridik, atëherë do të çrregullohej siguria juridike dhe do të ndodhte veprim i shpeshtë retroaktiv i normave juridike. Gjithashtu, duke e marrë parasysh faktin se organi ligjvënës sjell ligje, atëherë me qëllim të shmangies së veprimit retroaktiv organi ligjvënës do duhej të sjellë ligje për interpretimin e ligjeve, që nga ana tjetër sërish mund të sjellë çrregullim të sigurisë juridike, sepse ligjet e tilla iniciojnë mbingarkim të panevojshëm të rendit juridik dhe krijojnë kaos.

Nën interpretim autentik, të cilin e jep krijuesi i normës juridike, ndërsa veprimi i atij interpretimi vlen nga vetë miratimi i normës juridike, gjegjësisht llogaritet sikur çdoherë të ketë ekzistuar. Interpretimi autentik, edhe pse është më i saktë sepse jepet nga krijuesi i normës juridike, prapë është i padëshirueshëm, sepse krijon veprim retroaktiv dhe e çrregullon sigurinë juridike. Shpesh herë nocionet interpretim ligjvënës dhe autentik përzihen për shkak të faktit se organi ligjvënës i sjell normat ligjore të cilat kanë shkallë më të lartë të përgjithësisë pas normës kushtetuese dhe më së shpeshti paraqitet

nevoja për interpretimin e tyre. Megjithatë, interpretim autentik ekziston kur interpretimin e jep krijuesi i normës juridike, pavarësisht se kush është. Autentik llogaritet edhe interpretimi i normave personale që e japin edhe llojet tjera të organeve shtetërore (qeveri dhe gjyqësor).

Në Republikën e Maqedonisë, në kuadër të Kuvendit ekziston komision i veçantë, Komisioni ligjvënës-juridik, që është trup amë punues i cili e vlerëson nevojën për interpretim të normës ligjore, me ç'rast Kuvendi i propozon të sjellë interpretim të normës ligjore.

Interpretim i organeve të administratës. Administrata për çdo ditë vepron, me ç'rast sjell numër të madh aktesh individuale administrative-juridike (leje, aktvendime) dhe drejtpërdrejtë i zbaton aktet e përgjithshme juridike ligjore dhe nënligjore. Në këtë rast tepër me rëndësi është profesionaliteti i kuadrove për zbatim efikas të së drejtës dhe qëndrueshmërisë së rendit juridik. Administrata duhet të jetë profesionale dhe teknikisht mirë e pajisur, me qëllim të kryerjes së shërbimit të saj. Aktiviteti i saj në zbatimin dhe interpretimin e të drejtës duhet të bazohet në parimin e pavarësisë, përgjegjësisë dhe transparencës.

Interpretimi gjyqësor ka rëndësi të veçantë. Gjykata është organ i cili në rast të kontestit çdoherë është instanca e fundit dhe vendos kush është në të drejtë. Pa marrë parasysh çfarë rasti zgjidhin, gjykatat janë të obliguara t'i zbatojnë normat juridike dhe të kryejnë kontroll të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së gjitha akteve të përgjithshme dhe konkrete juridike, në përjashtim të Kushtetutës. Kështu për shembull, gjatë inicimit të kontestit administrativ, gjykata e vlerëson ligjshmërinë e akteve administrative, ndërsa Gjykata Kushtetuese (institucion që është jashtë kornizave të gjyqësorit të rregullt) e vlerëson kushtetutshmërinë e ligjeve.

Ekzistojnë teoricien të caktuar që nuk bëjnë dallimin ndërmjet interpretimit administrativ dhe gjyqësor. Në rast të tillë flitet për të a.q. interpretim zyrtar, përkundër interpretimit autentik. Ndërmjet

këtyre dy llojeve të interpretimit ekzistojnë ngjashmëri, por edhe dallime. Interpretimi zyrtar, krahasuar me atë autentik, ka fuqi më të vogël juridike dhe kryhet nga organe zyrtare në zgjidhjen e rasteve konkrete. Për dallim nga kjo, interpretimin autentik e kryejnë organe më të larta shtetërore (organi shtetëror ligjvënës). Me të nuk zgjidhet asnjë rast konkret.



10. Interpretimi i subjekteve joshtetërore

Këtë lloj të interpretimeve e kryejnë lloje të ndryshme të organizatave shoqërore, shoqatave të qytetarëve. Çdo person të cilit i është pranuar statusi i subjektit në të drejtën, ka të drejtë të paraqitet si person privat dhe interpretues i normës juridike.

Interpretimi privat nuk ndërmerr vend të veçantë në të drejtën, sepse nuk është i obligueshëm. Çdo person mund individualisht të interpreton një normë juridike të përgjithshme ose individuale të cilën ai individualisht e krijon.

Për shembull, kur një person privat me subjekt tjetër do të firmosë marrëveshje për shitblerje ose qira, atëherë personi privat paraqitet si interpretues i interpretimit autentik, mirëpo kjo nuk mund të pranohet si interpretim i tillë pasi bëhet fjalë për vullnet të lirshëm ndërmjet dy palëve kontraktuese dhe çdoherë e drejta e tyre është e kufizuar.

Interpretimi privat dallon nga gjitha llojet tjera të interpretimeve, sepse e kryejnë persona të rëndomtë dhe llogaritet si më pak profesional dhe josistematik. Kjo nuk domethënë se atyre persona-ve u shkurtohet e drejta të kërkojnë ndihmë nga persona profesional (avokatë, këshilltarë juridik) dhe organe tjera të autorizuara shkencore.

11. Interpretimi shkencor i normave juridike

Në kuptimin më të gjerë të fjalës, interpretimin shkencor e kryen shkenca juridike. Edhe pse ky interpretim nuk ka rëndësi të drejtpërdrejtë praktike, gjegjësisht nuk është në përdorim të përditshëm në praktikën juridike, i njëjti në masë të madhe kontribuon për kuptimin dhe interpretimin e drejtë të së drejtës. Qëndrimet teorike kanë rëndësi të madhe për cilësinë e të drejtës objektive. Nga momenti kur e drejta fillon teorikisht të studiohet, paraqitet edhe nevoja për interpretim shkencor të normës juridike.

Interpretimi shkencor ka rëndësi të veçantë kur sillen akte të reja juridike, sepse vetë përfaqësuesit e organeve ligjvënëse duhet të disponojnë dhe të përfitojnë dituri teorike përkatëse. Prapë ky interpretim ngel të klasifikohet si interpretim i subjekteve joshtetërore.




Figura 11




Figura 12

12. Sistemi i të drejtës (nacioni)

Shqyrtimi dhe studimi i të drejtës është i mundur nga tre aspekte, edhe atë:

I pari, studimi i të drejtës si dukuri shoqërore. Këtu e drejta shqyrtohet dhe studiohet si dukuri e cila kryen sërë funksione në jetën shoqërore (rregullim, kontroll social, integrim, funksion represiv). Kur e drejta shqyrtohet si dukuri shoqërore, shqyrtohet ndikimi i dukurive tjera shoqërore mbi të drejtën, siç janë kultura, politika, ekonomia, historia, etj. Nga ky aspekt, të drejtën e studiojnë jo vetëm juridiku, por edhe shumë shkencë tjera shoqërore: sociologjia, ekonomia, psikologjia sociale, antropologjia, shkencat politike, etj.

I dyti, studimi i të drejtës si përmbledhje e normave juridike dhe sjelljes njerëzore. Nga ky aspekt analizohen gjitha aktet juridike, marrëdhëniet juridike dhe normat juridike nga njëra anë dhe plotësimi dhe efektuimi i këtyre normave nga ana e njerëzve.

I treti, studimi i të drejtës si sistem i normave të përgjithshme juridike të përmbledhura në një tërësi, ku nuk guxon të ketë kundërtënie. Sipas kësaj mënyre të studimit, e drejta përkufizohet si përmbledhje e normave të përgjithshme juridike, të përmbledhura sipas kriterëve paraprakisht të përcaktuara në grupe më të vogla ose më të mëdha, gjegjësisht tërësi që përfaqësojnë tërësi ose sistem juridik të vetëm.

Nëse normat juridike nuk janë rregulluar dhe sistematizuar sipas kriterëve paraprakisht të përcaktuar, do të paraqitej antinomia ose kundërtënia e normave.

Sistematizimi i të drejtës e gjen esencën e tij në shkencën juridike, ku vendosen kriteret sipas të cilave e drejta sistematizohet. Sistemi i të drejtës në fakt është elementi normativ në të drejtën.

Me vetë studimin e normave dhe akteve të përgjithshme juridike, shkencë i interpreton dhe sistematizon të njëjtat. Kriter për

sistematizim mund të jetë: lënda, përmbajtja dhe lloji i marrëdhënieve shoqërore. Për shembull, kodi penal i rregullon marrëdhëniet shoqërore të cilat kanë karakter penal në sferën penale juridike. Ligji për obligacione rregullon materie të karakterit civil juridik në sferën civile juridike.

Sistematizimi në të drejtën, përveç që kontribuon për zhvillimin e saj të mëtutjeshëm, njëkohësisht mundëson edhe zbatimin efikas të saj.

E drejta, gjegjësisht sistematizimi i saj, gjithashtu mbështetet edhe mbi aktet individuale juridike në krijimin e çdo rendi juridik. Sot në botë mund të takohen edhe rende juridike të cilat nuk krijohen vetëm mbi burime të shkruara juridike. I tillë është shembulli i të drejtës anglosaksone (Angli, SHBA), ku rendi juridik bazohet edhe mbi të drejtën zakonore në aktet individuale juridike, të cilat i sjellin organet më të larta juridike.

13. Elementet e sistemit juridik

Element themelor në sistemin e të drejtës paraqet norma e përgjithshme juridike.

Normat juridike krijohen me aktet e përgjithshme juridike, të cilat shkenca juridike i rregullon në tërësi më të mëdha, sipas përmbajtjes dhe afërsisë së tyre. Rrjedhimisht, mund të konkludojmë se përveç që bëhet përcaktim sipas shkallës së afërsisë së normave të caktuara juridike, gjithashtu shkenca zbaton sistematizim sipas shkallës së përgjithësisë së llojeve të veçanta të normave.

Grupimi i normave të përgjithshme juridike në tërësi më të mëdha sipas përmbajtjes dhe afërsisë njëkohësisht paraqet grupim i normave në tërësi të veçanta, pasi një lëndë ose marrëdhënie juridike mund të krijojnë parime të njëjta themelore. Nëse një lëndë ose marrëdhënie shoqërore rregullohet sipas parimeve të ndryshme, atëherë mundësohet krijimi i më tepër

grupeve të ndryshme të normave dhe krijim i më tepër tërësive të ndryshme të sistematizuara. Kështu për shembull, marrëdhëniet pronësore juridike mund të jenë të rregulluara me parime të ndryshme vetëm nëse bëhet fjalë për lloj të njëjtë të marrëdhënieve shoqërore.

Në vetë shkencën juridike deri më sot nuk është krijuar unitet i plotë për përcaktimin e elementeve të sistemit të së drejtës. Tek ne pranohet kriteri që niset nga përmbajtja e raporteve shoqërore me të cilat rregullohet përmbajtja e normave juridike. Sipas kriterit, sistemi i të drejtës është i përbërë nga tre elemente (pjesë): institut juridik, degë juridike dhe sferë juridike.

14. Instituti juridik

Nën institut juridik nënkuptohet përmbledhja e më tepër normave juridike të ngjashme, të cilat rregullojnë një raport të njëjtë shoqëror ose pjesë më të vogël nga ai raport mbi parime të njëjta. Instituti juridik është grupimi i parë dhe themelor i normave juridike. Instituti është i përbërë nga më tepër norma juridike të cilat rregullojnë një raport të përbërë shoqëror. Për shembull, përmbledhja e normave të cilat përcaktohen me marrëdhëniet martesore e krijojnë institutin juridik martesë. Në këtë institucion bëjnë pjesë normat të cilat e përcaktojnë martesën, nga cilat kushte ajo krijohet, gjegjësisht kush mund dhe kush nuk mund të futet në martesë, të drejtat dhe obligimet reciproke të partnerëve martesor dhe si martesë mund të ndërpritet. Shembuj për institute juridike janë: marrëveshja, shitblerja, pronësia, vjetërsia, mirëmbajtja, kujdestaria, familja, adoptimi, etj. Nga shembujt e lartpërmendur të instituteve juridike mund të konstatojmë se mes tyre çdoherë ekzistojnë dallime. Për shembull, nëse krahasohen institutet martesë dhe marrëveshje, me siguri vërtetohet ekzistimi i ngjashmërive dhe dallimeve. Edhe pse ato janë krijuar nga degë të ndryshme juridike, ngjashmëria reflektohet në faktin se bëhet fjalë për raporte

të lira shoqërore, të cilat vendosen me marrëveshje, ku nuk mund të ketë detyrim nga shteti. Krahasuar me martesën, marrëveshja është institut më i përgjithësuar juridik, ndërsa martesë paraqet lloj specifik të marrëveshjes.

15. Dega juridike

Nën degë juridike nënkuptohet përmbledhja e më tepër instituteve të ngjashme juridike të cilat rregullojnë lloj të njëjtë të raporteve shoqërore.

Dega juridike në sistemin e të drejtës paraqitet si element i dytë, që bashkon më tepër institute të ngjashme juridike. Shembull për degë juridike është e drejta familjare, e përbërë nga institutet juridike në lidhje me familjen, martesën, trashëgimin. Në ish sistemet juridike kanë ekzistuar shumë pak degë juridike. Me ndryshimin e marrëdhënieve shoqërore dhe rolin e zmadhuar e shtetit, janë krijuar kushte dhe nevojë për rritjen e degëve juridike. Në sistemet më të vjetra juridike (shoqëritë para-borgjeze) kanë ekzistuar vetëm dy degë juridike: e drejta penale dhe civile.

Me krijimin e shoqërisë borgjeze krijohen sisteme më të zhvilluara juridike, ku etablohen më tepër degë juridike. Degë të sistemit të së drejtës janë: e drejta kushtetuese, e drejta administrative, e drejta gjyqësore, e drejta penale, e drejta civile, e drejta personale dhe familjare, e drejta tregtare, e drejta e punës, e drejta ndërkombëtare.

16. E drejta kushtetuese

E drejta kushtetuese paraqet degë themelore të veçantë të sistemit juridik. Vendi i të drejtës kushtetuese në sistemin juridik të një shteti ndërmerret nga Kushtetuta si akti më i lartë juridik me fuqi më të lartë juridike në rendin juridik. Disa teoricien e llogaritin të drejtën kushtetuese si themelin e sistemit juridik, sepse nga ajo krijohen

edhe degët tjera juridike. E drejta kushtetuese përmban norma të cilat i rregullojnë raportet juridike të çdo shteti. Ato janë raporte të cilat i dedikohen krijimit të së drejtës dhe realizimit të interesave të shoqërisë.

Më konkretisht, kushtetuta (e drejta kushtetuese) i rregullon edhe çështjet në lidhje të drejtpërdrejtë me të drejtat dhe liritë e njeriut dhe qytetarit dhe me organizimin e plotë të pushtetit shtetëror.

Nocioni e drejtë kushtetuese si degë më e rëndësishme juridike nuk është pranuar njëjloj nga vetë teoricienët. Në numër të madh shtetesh të Evropës së Mesme përdoret termi e drejtë shtetërore. Në Evropën Perëndimore përdoret termi e drejtë konstitutive.

Duke folur për të drejtën kushtetuese si degë të sistemit juridik të një shteti, nuk duhet të anashkalohej nocioni e drejtë kushtetuese, sepse ai përdoret edhe në kuptim tjetër si shkencë e veçantë. E drejta kushtetuese si shkencë është nocion më i gjerë dhe më i ndërlikuar nga e drejta kushtetuese si degë juridike. Atë si shkencë të veçantë e studiojnë e drejta kushtetuese si degë e sistemit juridik.

17. E drejta administrative

E drejta administrative paraqet disiplinë publike juridike që merret me studimin e administratës publike shtetërore.

E drejta administrative, në përputhje me materien e studiuar, ndahet në dy pjesë, edhe atë: e drejtë administrative materiale dhe e drejtë administrative procesore. Lënda e të drejtës administrative materiale përcaktohet në pajtim me dy koncepte, edhe atë: e drejta administrative si degë e sistemit juridik dhe e drejta administrative si degë e shkencë juridike. Në të drejtën administrative juridike studiohen çështjet në lidhje me përcaktimin

e pozitës dhe rolit të administratës në sistemin politik të Republikës së Maqedonisë, organizimin e administratës, funksionin administrativ dhe veprimtarisë administrative, si dhe çështjet që u dedikohen akteve të administratës, kuadrove të punësuar në administratën publike, monitorimin administrativ dhe shërbimeve publike.

Për punën e organeve të administratës, rëndësi të veçantë ka respektimi i parimit të ligjshmërisë, sipas të cilit gjitha aktet dhe veprimet e ndërmarra nga organet e administratës duhet të jenë në pajtim me dispozitat e vlefshme juridike.

Në Republikën e Maqedonisë ekzistojnë dispozita të shumta dhe të llojllojshme që u dedikohen organeve të administratës, ndër të cilat i përmendim Ligjin për organizim dhe punë të organeve të administratës shtetërore, Ligjin për procedurën e përgjithshme administrative, Ligjin për konteste administrative, Ligjin për nëpunës shtetëror, etj.

18. E drejta gjyqësore

E drejta gjyqësore është degë e sistemit juridik që përmban norma të përgjithshme juridike, me të cilën rregullohet organizimi dhe veprimtaria e gjykatave. Veprimtaria e gjykatave përfshin më tepër lloje të akteve, miratimi i të cilave është rregulluar me procedura të ndryshme. Ekzistojnë llojet vijuese të procedurave gjyqësore: procedurë kontestimore, e cila e rregullon sjelljen e vendimeve gjyqësore në kontestet civile; procedura penale gjyqësore, që e rregullon materien gjatë sjelljes së akteve gjyqësore në kontestet penale; procedura jashtëkontestimore, që e rregullon sjelljen e vendimeve gjyqësore në procedurë kur nuk ka kontest; dhe procedurë ekzekutive, që e rregullon veprimtarinë e gjykatave dhe organeve tjera në zbatimin e vendimeve gjyqësore.

Në punën e tyre, gjykatat i zbatojnë normat e përgjithshme juridike gjatë sjelljes së aktgjykimeve dhe aktvendimeve konkrete gjyqësore dhe në këtë aspekt janë të ngjashme me organet administrative, por gjithashtu ekzistojnë edhe dallime të rëndësishme, si për shembull, gjykatat gëzojnë pavarësi të veçantë, nuk i nënshtrohen hierarkisë para instancave më të larta gjyqësore ose organeve tjera shtetërore, zgjedhja e gjykatësve kryhet në mënyrë të veçantë, etj.

Sot në shumë shtete, përveç gjykatave të rregullta, themelohen edhe lloje tjera të gjykatave, si arbitrare, këshilla paqësore, etj.

Në Republikën e Maqedonisë, pushtetin gjyqësor e kryejnë gjykatat themelore, të apelit dhe Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë. Në vend të gjykatave me kompetenca të përgjithshme (gjykata komunale, të qarkut dhe Gjykatë Supreme e Republikës së Maqedonisë) dhe gjykatave të specializuara (ushtarake dhe ekonomike), u zbatua bashkim i funksioneve të gjitha këtyre gjykatave në gjykata të vetme. Për herë të parë tek ne u themelua këshilli gjyqësor, i cili është i ndërlidhur me organizimin e veprimtarisë së gjyqësorit, por si organ i shtetit ai nuk është gjykatë, pa marrë parasysh që vepron në kuadër të gjyqësorit. Në këtë mënyrë, ai nuk është as organ i pushtetit ligjvënës, e as i atij ekzekutiv.

Në sistemet kushtetuese dhe politike të shteteve të caktuara, si organe të veçanta ekzistojnë edhe gjykatat kushtetuese. Detyrë e gjykatave kushtetuese është mbrojtja e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë. Gjykata e parë kushtetuese është krijuar në Austri në v. 1920, si organ i pavarur. Në Republikën e Maqedonisë, me kushtetutën e saj, Gjykata Kushtetuese në nenin 108 është parashikuar dhe përcaktuar si organ i veçantë që e mbron kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë.

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë vendos për pajtueshmërinë e ligjeve me kushtetutën, pajtueshmërinë e dispozitave tjera dhe të marrëveshjeve kolektive me kushtetutën dhe ligjet, i mbron liritë dhe të drejtat e njeriut dhe qytetarit, vendos për për-

plasjen e kompetencave ndërmjet bartësve të pushtetit ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor, vendos për përgjegjësinë e kryetarit të Republikës, etj.

E drejta gjyqësore si disiplinë shkencore fokusohet në anën institucionale të drejtësisë, saktësisht në jurisprudencën. Në kuadër të kësaj lënde studiohet struktura vendore jurisprudence, por janë prezantuar edhe modelet dhe standardet komparative për jurisprudencën. Kështu, studiohet organizimi i gjyqësorit, statusi, zgjedhja dhe kompetencat e gjykatësve, trajnimi i tyre, avancimi, specializimi, mandej roli i prokurorisë publike në sistemin e drejtësisë, zgjedhja dhe emërimi, kompetencat, etj. Edhe pse pikë qendrore dhe subjekt themelor i studimit është gjyqësori, kjo lëndë i studion edhe të a.q. organe, shërbime dhe funksione të jurisprudencës në kuptimin më të gjerë, andaj studiohen edhe aspekte të caktuara të administratës së jurisprudencës, avokaturës, noterisë, avokatisë shtetërore dhe publike, etj.

19. E drejta penale

Lënda e të drejtës penale, si degë e të drejtës pozitive, paraqet sistem të normave me të cilat janë sjellje të caktuara njerëzore shpallen vepra penale, për këto vepra përshkruhen dënime dhe sanksione tjera detyruese nga ana e shtetit dhe përcaktohen kushtet dhe mënyrat për zbatimin e tyre. Detyra themelore e saj është mbrojtja e interesave dhe të mirave themelore të njerëzve nga sjelljet njerëzore që janë shpallur vepra penale. E drejta penale është edhe disiplinë shkencore, e cila e studion të drejtën pozitive penale dhe parimet e saja themelore, mbi të cilat e ndërton sistemin e saj kategorik.

Rrjedhimisht, tërësia e pjesës së përgjithshme e drejtës penale ndahet në tri pjesë. Në *pjesën e parë* janë sistematizuar temat në lidhje me të drejtën penale dhe ligjin penal; *pjesa e dytë* i dedikohet veprës penale dhe përgjegjësisë penale të autorit; ndërsa *pjesa e*

tretë është ajo ku përpunohen temat nga dënimi dhe pasojat tjera juridike të veprës penale.

20. E drejta civile

E drejta civile (*ius civile*) është emërtim i përbashkët për më tepër degë juridike, me të cilat rregullohen raporte të ndryshme dhe të shumta të ekzistimit njerëzor, nga lindja e tij e deri tek vdekja, pa marrë parasysh nëse shqyrtohet si individ, anëtar i familjes, trashëgues, tutor, etj. E drejta civile paraqet pjesë e sistemit juridik (konkretisht i të drejtës private) që i studion raportet shoqërore të cilat paraqiten ndërmjet qytetarëve si bartës të të drejtave subjektive qytetare. Në esencë, e drejta civile ka tre kuptime: *e drejtë civile si e drejtë objektive, e drejtë civile si e drejtë subjektive, e drejtë civile si shkencë*.

E drejta civile si e drejtë objektive (*de lege lata*) paraqet sistem të normave me të cilat rregullohen raportet shoqërore, të cilat krijohen ndërmjet personave fizik nga njëra anë dhe ndërmjet personave fizik dhe juridik nga ana tjetër. Sistemi i normave që e përbëjnë të drejtën objektive civile është ndërlidhur në nën-institute, institute, grupe të instituteve, pjesë, degë juridike dhe në fund në familje të degëve juridike-e drejta civile.

E drejta civile si e drejtë subjektive paraqet përmbledhje të autorizimeve të cilat e drejta civile objektive (reale, obligative dhe trashëguese) ua pranon subjekteve (personave fizik dhe juridik) të ndërmarrin aktet e nevojshme për plotësimin e interesave materiale (pronësore) ose jomateriale (jopronësore).

E drejta civile si shkencë paraqet sinonim për disiplinat shkencore të cilat subjekt të hulumtimit e kanë sistemin e normave civile-juridike, gjegjësisht të drejtën reale, obligative dhe trashëguese, si të drejta objektive. Prej këtu rrjedh edhe detyra themelore e shkencës civile-juridike, studimi i të drejtës civile objektive jo vetëm

ashtu siç është – de lege lata, por edhe si duhet të jetë në të ardhmen – de lege ferenda.

Përcaktimi esencial i nocionit të së drejtës civile duhet të kryhet në bazë të dy kriterëve: 1. Përcaktim i lëndës së studimit të së drejtës civile dhe 2. përcaktim i metodës së rregullimit të marrëdhënieve shoqërore të cilat e përbëjnë të drejtën civile, si të drejtë objektive.

Lëndë e të drejtës civile para së gjithash janë raportet shoqërore të cilat kanë karakter pronësor, e ku bartësit (personat fizik nga njëra anë dhe personat fizik e juridik nga ana tjetër), në bazë të subjektivitetit të tyre civil-juridik, përfitojnë pushtet të pranuar të drejtpërdrejtë mbi gjësendet si dhe pushtet të pranuar nga e drejta të kërkojnë diçka nga pala tjetër. Këto raporte shoqërore paraqesin lëvizje të vlerave në dy drejtime, gjegjësisht janë raporte që shkaktojnë efekte pronësore, ose në mënyrë më decime, janë raporte të cilat shprehen në para. Subjekt të së drejtës civile janë edhe raportet tjera shoqërore të ndërlidhura me raportet reale juridike, obligative juridike dhe trashëguese juridike, të cilat sjellin efekte pronësore, por nuk paraqesin lëvizje reciproke të vlerave në qarkullim. E drejta civile ndahet në tri pjesë, edhe atë: e drejtë reale, trashëguese dhe obligative.

E drejta reale është pjesë e të drejtës civile që i përfshin gjësendet si subjekte të raportit civil juridik. Kështu, ajo i klasifikon subjektet sipas kriterëve të veçanta nga të cilat burojnë ndarje të ndryshme të gjësendeve, edhe atë: të tundshme dhe të patundshme, shpenzuese dhe joshpenzuese, kryesore dhe sekondare, të thjeshta dhe të ndërlikuara, të zëvendësueshme dhe të pazëvendësueshme, etj.

E drejta reale e studion përfitimin dhe humbjen e të drejtave të pronësisë mbi lloje të ndryshme gjësendesh, të drejtën e sundimit dhe raportit pronësor mbi gjësendet, gjegjësisht dallimin e tyre, mënyrën derivate të përfitimit të së drejtës së pronësisë mbi gjësendet (kur ajo e drejtë bartet nga subjekt tjetër që paraprakisht ka qenë pronar i gjësendit) dhe mënyrën origjinare të përfitimit të pronësisë (kur për herë të parë paraqitet në dobi të subjektit aktual).

21. E drejta personale dhe familjare

Dega juridike e drejtë personale i përfshin normat juridike të cilat e përcaktojnë statusin personal të njeriut si individ. E drejta personale si disiplinë shkencore i përfshin sferat vijuese tematike: statusin personal, klasifikimet e të drejtave personale në të drejtën komparative, bartësit e të drejtave personale, përmbajtjen e drejtës personale, përkufizimin e përmbajtjes së drejtës personale, format e mbrojtjes së të drejtës personale.

E drejta familjare i rregullon raportet familjare-juridike. Familja është institucion i rëndësishëm shoqëror. Bazohet në dy institucione tjera: martesë dhe farefisni. Raportet familjare rregullohen me numër të madh normash shoqërore (morale, zakonore, religjioze, juridike).

E drejta juridike si disiplinë shkencore i përfshin: të drejtën martesore, që i rregullon raportet ndërmjet bashkëshortëve të cilat paraqiten me firmosjen e martesës, përmbajtjen e raporteve reciproke dhe ndërprerjen e martesës; të drejtën prindërore, me të cilën rregullohen raportet ndërmjet prindërve dhe fëmijëve (nacion, përmbajtje, të drejta dhe obligime); adoptimin (nacioni, kushtet e paraqitjes, të drejtat dhe obligimet e adoptuesit dhe të adoptuarit dhe ndërprerjen e adoptimit); kujdestarinë si institut, qëllimi i së cilës është sigurimi i mbrojtjes së personave të mitur pa kujdes prindëror, si dhe të personave të moshuar që nuk janë të aftë të kujdesen për veten, nacion dhe procedurë për vënie nën kujdestari; mirëmbajtje e familjes, si reflektim i solidaritetit ndërmjet anëtarëve të saj, si dhe aspektet e raporteve pronësore në martesë dhe në bashkësinë jash-tëmartesore.

22. E drejta tregtare

Rregullat juridike për rregullimin e tregtisë ekzistojnë që në Greqinë e Vjetër, ndërsa fillet e të drejtës tregtare si degë juridike i

gjejmë në Romën e Vjetër. Megjithatë, për të drejtë tregtare si tërësi juridike me institute të veçanta juridike mund të flasim nga mesjeta, kur tregtia ka marrë rëndësi të madhe dhe kur shtresë e veçantë është marrë vetëm me tregti. Në kuadër të a.q. e drejtë klasore në shek. XVIII dhe XIX, në kodifikime individuale grumbullohen gjitha rregullat në lidhje me veprimtarinë tregtare dhe pozitën e atyre që merren me tregti. Në teori veçanërisht theksohet rëndësia e kodit të veçantë tregtar “Code de commerce”, i miratuar në vitin 1807 në Francë. Definicionet për atë çfarë paraqet e drejta tregtare dhe cila problematikë rregullohet me rregullat juridike që ajo i përmban, në përgjithësi hasim edhe në teorinë juridike, por edhe rregullat ligjore të vendeve konkrete.

Sipas teorisë juridike dhe dispozitave ligjore në Republikën e Maqedonisë, subjekt i të drejtës tregtare është pozita juridike e tregtarëve, llojet e tregtarëve, shoqatat tregtare (lloje, themelim, shpërbërje), transaksionet tregtare dhe letrat me vlerë.

Prandaj, në kuadër të së drejtës tregtare dallojmë:

- Të drejtën statusore për pozitën juridike të shoqatave tregtare (për shembull, shoqata tregtare janë T-Mobile, Alkalloid, Biraria, etj.); cilat janë rregullat sipas cilave janë formuar shoqatat përkatëse, mënyra e organizimit, nën cilat kushte mund të ndërprehen së ekzistuari, cilat akte duhet obligueshëm t’i posedojnë dhe çështje tjera, të cilat e rregullojnë të drejtën statusore në kuadër të së drejtës tregtare.
- Të drejtën materiale për punët tregtare (marrëveshje tregtare) dhe
- Çështje në qarkullimin me para (letra me vlerë).
- E drejta tregtare si pjesë përbërëse e sistemit juridik të RM ka pika të përbashkëta me disiplina tjera shkencore: *të drejtën civile, të drejtën tregtare ndërkombëtare; të drejtën e komunikacionit; të drejtën administrative.*

Patjetër duhet të theksojmë se ekziston dualizëm në emërtimin e kësaj dege juridike, gjegjësisht përveç e drejtë tregtare quhet edhe e drejtë ekonomike. Sipas ithtarëve të emërtimit të dytë, kjo degë i përfshin çështjet ekonomike të cilat i kryejnë jo vetëm subjektet ekonomike, po edhe personat të cilët nuk merren me veprimtari ekonomike (për shembull, çështjet juridike që i firmosin personat fizik në veprimtarinë bankare, letrat me vlerë, etj.). Në të drejtën komparative nocioni e drejtë ekonomike (Gjermani, Angli, Francë) përdoret për rregullimin e raporteve ndërmjet shoqatave tregtare dhe shtetit, gjegjësisht e drejta tregtare llogaritet pjesë e të drejtës private, ndërsa e drejta ekonomike llogaritet pjesë e të drejtës publike. Teoricienët që e mohojnë nocionin e drejtë ekonomike theksojnë se ky emërtim simbolizon intervencionizmin shtetëror në përcaktimin e pozitës juridike të subjekteve ekonomike.

Termi e drejtë tregtare në fakt etablohet në kuadër të së drejtës klasore dhe insiston në pozitën juridike dhe aktivitetin e tregtarit. Megjithatë, emërtimi i një dege juridike është çështje e konventës. Në teorinë tonë juridike, legjislacioni dhe praktika afariste, përdoret termi e drejtë tregtare, sepse llogaritet që më tepër i përshtatet raporteve të liberalizuara ekonomike në të cilat futen subjektet tregtare të Republikës së Maqedonisë. Rregulla juridike për rregullim të tregtisë ende ekzistojnë në Greqinë e vjetër, ndërsa zanafilla e të drejtës tregtare si degë juridike e gjejmë në Romën e vjetër. Megjithatë për të drejtën tregtare si tërësi juridike me institucione të veçanta juridike mund të flasim nga shekulli i mesëm atëherë kur tregtia ka patur rëndësi të madhe dhe kur klasa e veçantë është marr vetëm me tregti. Në kuadër të a.q e drejta klasore në shek. XVIII dhe XIX në një vend d.m.th në kodifikime të veçara grumbullohen të gjitha rregullat të cilat i referohen punës tregtare dhe ata që merrem me tregti. Në teorinë, posaçërisht theksohet rëndësia e kodit të veçantë tregtar. "Code de commerce" i miratuar në vitin 1807 në Francë. Definicionet për atë çka paraqet e drejta tregtare dhe problematika e së cilës rregullohet me rregullat juridike që ajo i përmban, gjejmë

në përgjithësi edhe në teorinë juridike, por edhe rregullat ligjore të vendeve konkrete.

Sipas teorisë juridike dhe rregullave juridike në Republikën e Maqedonisë, subjekt i të drejtës tregtare është pozicioni juridik i tregtarëve, llojet e tregtarëve, shoqëritë tregtare (llojet, themelimet, zanafilla etj.) më tej transaksione tregtare dhe letra me vlerë.

Prandaj në kuadër të drejtës tregtare dallojmë:

1. E drejta e statusit për pozicionimin juridik të shoqërive tregtare (për shembull, shoqëria tregtare e T-Mobile, Alkaloid, Pivara etj); Cilat janë të rregullat sipas së cilës janë formuar këto shoqëri, si duhet të organizohen, pa cilat kushte nuk mund të ekzistojnë, cilat akte duhet patjetër t'i kenë dhe pyetje të tjera, atë e rregullon e drejta e statusit në kuadër të drejtës tregtare.

2. E drejta materiale për gjërat tregtare (kontrata tregtare) dhe

3. Gjërat në fitimin me para (letra me vlerë).

E drejta tregtare si pjesë përbërëse e sistemit juridik të RM-së ka pika kyçe me disiplina të tjera shkencore: *e drejta e qytetarëve*; *e drejta ndërkombëtare e tregtisë*; *e drejta e trafikut*; *e drejta e menaxhimit*.

Duhet të theksojmë se ekziston dualizëm në titullin e kësaj dege juridike, respektivisht, përveç të drejtës tregtare quhet edhe e drejtë ekonomike. Sipas obliguesve të titullit e drejta ekonomike, kjo degë juridike i përfshinë gjërat ekonomike që i kryejnë me veprimtari ekonomike (për shembull gjërat juridike që i mbyllin individët në punën e bankës, letra me vlerë etj.). Në të drejtën krahasuese, termi e drejta ekonomike (Gjermania, Anglia, Franca) përdoret për rregullim të raporteve mes shoqërive tregtare dhe shtetit d.m.th e drejta tregtare konsiderohet si pjesë e të drejtës publike. Ata teoricienë që e sulmojnë titullin e drejta ekonomike thonë se ky titull insiston shumë në intravencionizmin shtetëror në verifikimin e pozicioneve juridike të subjekteve ekonomike.

Termi e drejtë tregtare në fakt etablohet në kuadër të së drejtës klasore dhe insiston në pozitën juridike dhe aktivitetin e tregtarit. Megjithatë, emërtimi i një dege juridike është çështje e konventës. Në teorinë tonë juridike, legjislacioni dhe praktika afariste, përdoret termi e drejtë tregtare, sepse llogaritet që më tepër i përshtatet raporteve të liberalizuara ekonomike në të cilat futen subjektet tregtare të Republikës së Maqedonisë.

23. E drejta e punës

E drejta e punës paraqitet si disiplinë relativisht e re juridike, që karakterizohet me zhvillim dinamik dhe ekspansion të vazhdueshëm të lëndës dhe përmbajtjes së saj. Përpyekja për pozicionim të së drejtës së punës në kuadër të sistemit ekzistues të disiplinave juridike paraqet sfidë serioze për numër të madh teoricienësh nga kjo sferë. Në mënyrë kronologjike, paraqitja e të drejtës së punës ndër lidhet me paraqitjen e revolucionit industrial dhe kapitalizmit liberal. Nga perspektiva historike-evolutive e shkencave juridike, e drejta e punës buron nga e drejta civile dhe veçohet si disiplinë e pavarur juridike në periudhën kur shteti me masat e tij mbrojtës intervenon në sferën e marrëdhënieve të punës. Me paraqitjen e intervencionizmit shtetëror në sferën e marrëdhënieve të punës, në të drejtën e punës që deri atëherë përbëhej nga të drejtat dhe obligimet që kanë buruar nga marrëveshjet për punë ndërmjet punëtorëve dhe punëdhënësve, inkorporohen dispozita me karakter imperativ dhe jashtëkontraktues. Kështu, ndërlidhja e elementeve kontraktuese (marrëveshja për punë) dhe elementeve imperative, gjegjësisht jashtëkontraktuese (intervencionizmi shtetëror në sferën e punës), sjellin diferencimin e të drejtës së punës si disiplinë e veçantë juridike, e ndryshme nga e drejta civile. Rrjedhimisht, mund të konkludohet se e drejta e punës, si disiplinë e veçantë juridike paraqitet gjatë shek. XIX dhe ekziston më tepër se një shekull.

Lënda e të drejtës së punës mund të analizohet nga aspekti i traditave juridike të shteteve të ndryshme. Në teorinë, shpesh theksohen

qasja anglosaksonike dhe kontinentale në përcaktimin e lëndës së drejtës së punës. Sistematikisht më i afërt dhe më i pranueshëm veçohet modeli kontinental. Teoria franceze juridike e punës, si lëndë të së drejtës së punës i numëron komponentët vijues: 1) marrëveshjen për punë dhe marrëdhënien e punës; 2) marrëdhëniet kolektive të punës dhe 3) marrëdhënien ndërmjet punëdhënësve, punëtorëve dhe shtetit. Sipas teorisë gjermane juridike të punës, lëndë e të drejtës së punës paraqesin marrëdhëniet individuale dhe kolektive të punës. Këtu nuk bëjnë pjesë marrëdhëniet e punës të nëpunësve shtetëror dhe sigurimi social, për shkak të natyrës së tyre publike juridike.

Spektri i çështjeve të cilat e përbëjnë lëndën dhe përmbajtjen e të drejtës së punës, përfshin më tepër probleme:

Së pari, këtu bëjnë pjesë marrëdhëniet e punës si subjekt themelor të së drejtës së punës, të cilat si të tilla i përfshijnë të drejtat dhe obligimet që paraqiten gjatë firmosjes së marrëdhënies së punës, gjatë punës dhe gjatë ndërprerjes së marrëdhënies së punës. Më tutje, në lëndën e përgjithshme të së drejtës së punës, vend të veçantë zë edhe mbrojtja e punëtorëve, edhe atë mbrojtja e përgjithshme e shëndetit dhe sigurisë gjatë punës, si dhe kujdesi i veçantë ndaj kategorive të caktuara të personave në marrëdhënie pune, sikur: femra, punëtorë nën moshën 18-vjeçare, invalidë të punës dhe punëtorë më të moshuar.

Lënda e të drejtës së punës disperzohet edhe mbi sërë çështje tjera që u dedikohen hulumtimit të organeve, organizatave dhe institucioneve përkatëse nga sfera e punës (sindikate, inspektime të punës), si dhe mbi parime, institucione dhe kategori të ndryshme me rëndësi esenciale për organizimin dhe realizimin e punës dhe në përgjithësi të marrëdhënieve të punës.

Përfundimisht, e drejta e punës mund të përkufizohet si degë e veçantë juridike, lëndë studimi themelor i së cilës është totali i marrëdhënieve të punës si marrëdhënie të veçanta shoqërore.

24. E drejta ndërkombëtare

Varësisht nga burimi i normave juridike, lëndës së rregullimit dhe primatit në aspekt të zbatimit të dispozitave, bëhet dallim ndërmjet së drejtës së brendshme (nacionale) dhe asaj ndërkombëtare. Degët juridike deri tani të përpunuara janë pjesë përbërëse e të drejtës së brendshme.

E drejta ndërkombëtare mund të kuptohet në aspekt më të gjerë dhe më të ngushtë. Në kuptimin më të gjerë, e njëjta i përfshin të drejtën ndërkombëtare publike dhe private, ndërsa në kuptimin më të ngushtë vetëm të drejtën ndërkombëtare publike. Dallimi esencial ndërmjet së drejtës publike dhe private ndërkombëtare është lënda e rregullimit.

E drejta publike ndërkombëtare paraqet përmbledhje të rregullave juridike me ndihmën e të cilave rregullohen raportet ndërmjet subjekteve të së drejtës ndërkombëtare. Si subjekte të së drejtës ndërkombëtare paraqiten: shtetet, organizatat qeveritare ndërkombëtare dhe, në raste të caktuara, individit. Qëllimi themelor i të drejtës ndërkombëtare publike është vendosja e kornizave për zhvillim të bashkësisë ndërkombëtare, që është i mundur vetëm në kushte të koegzistimit të gjitha shteteve në një sistem. Edhe pse çdo shtet ka qëllimin e saj – mbijetesë dhe zhvillim, prapë në kushte të varshmërisë ndërkombëtare dhe globalizimit, nuk është në gjendje vetë t'u përgjigjet sfidave bashkëkohore.

E drejta ndërkombëtare publike ka sferat e saja që kanë lëndë të ndryshme të rregullimit. Kështu, ekzistojnë sferat vijuese të së drejtës ndërkombëtare publike: *E drejta ndërkombëtare kontraktuese* (i përfshin rregullat për firmosje dhe ndërprerje të marrëveshjeve ndërkombëtare), *E drejta diplomatike dhe konsullore* (i përfshin rregullat për llojet, statusin, imunitetin dhe funksionet e përfaqësuesve diplomatik dhe konsullor); *E drejta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut* (i përfshin mekanizmat për mbrojtje të të drejtave njerëzore në planin ndërkombëtar) dhe *E drejta ndërkombëtare ushtarake dhe humanita-*

re (i përfshin rregullat për udhëheqje të luftës, zgjidhjes paqësore të kontesteve, mbrojtjes së të drejtave njerëzore në kushte të luftës).

Burime të së drejtës ndërkombëtare publike janë: marrëveshjet ndërkombëtare, zakonet ndërkombëtare, praktika e përgjithshme e pranuar si e drejtë dhe parimet e përgjithshme të pranuar nga popujt e civilizuar. Këto burime janë paraqitur në nenin 38 nga Statusi i Gjykatës ndërkombëtare të drejtësisë. Çdo shtet është i obliguar t'i përmbahet rregullave në këto burime. Kundërshtimi i rregullave përcillet me përgjegjësi të shtetit në planin ndërkombëtar.

E drejta ndërkombëtare private, për dallim nga ajo publike që është degë e të drejtës ndërkombëtare, paraqet degë të së drejtës së brendshme. Me normat e të drejtës ndërkombëtare private rregullohen marrëdhëniet private-juridike ku kemi element të huaj. Kur në një raport privat-juridik do të paraqitet element i jashtëm (për shembull, martesë ndërmjet shtetasit të R. së Maqedonisë dhe R. së Shqipërisë), do të zbatohet norma e të drejtës ndërkombëtare private. E drejta ndërkombëtare private thirret të përgjigjet në pyetjen, vallë duhet ta zbatojmë të drejtën vendore ose të huaj për rregullimin e raportit dhe cila gjykatë është kompetente për dhënie të mbrojtjes juridike.

E drejta ndërkombëtare private përbëhet nga dy sfera të mëdha – përplasje e ligjeve (cila e drejtë duhet të zbatohet për rregullimin e raportit) dhe përplasje e juridiksioneve (vallë gjykata vendore është kompetente të veprojnë në konteste private-juridike ku ka element të huaj). Përveç këtyre sferave, në të drejtën ndërkombëtare private studiohet edhe nënshtetësia dhe pozita juridike e të huajve. Te kjo degë juridike karakteristike janë normat kolizive, të cilat nuk takohen tek degët tjera juridike. Ato zbatohen për zgjidhjen e përplasjes së ligjeve. Nëse e zbatojmë normën kolizive në një rast konkret, ne nuk mundemi menjëherë ta rregullojmë raportin. Përkundrazi, norma kolizive vetëm do të na dërgojë tek e drejta ku duhet ta gjejmë përgjigjen për rregullimin e raportit. E ajo e drejtë mund të jetë e drejta vendore ose e drejta e ndonjë shteti të huaj.

Burimet e të drejtës ndërkombëtare private, nga ana tjetër, mund të jenë të brendshme (Kushtetutë, ligj, akte nënligjore, praktikë gjyqësore) dhe ndërkombëtare (marrëveshje ndërkombëtare). E drejta ndërkombëtare private nuk i rregullon raportet ndërmjet shteteve, por raportet ndërmjet bartësve të të drejtave dhe obligimeve civile – personave fizik dhe juridik. Për këtë shkak, disa mendojnë se emërtimi E drejtë ndërkombëtare private nuk është i përshtatshëm, sepse në esencë nuk është e drejtë mbinacionale, por e drejtë e brendshme. Shfrytëzohet termi Ndërkombëtare, me qëllim të shënimit të karakteristikës së ekzistimit të elementit të huaj që e veçon të drejtën ndërkombëtare private nga degët tjera juridike të brendshme. Kështu, nëse e analizojmë normën kolizive nga neni 38 paragrafi 1 nga Ligji për të drejtën ndërkombëtare private: *Në aspekt të kushteve për martesë, për çdo person kompetente është e drejta e shtetit shtetas i të cilit është personi në kohën e martesës*, ne nuk mundemi menjëherë t'i kuptojmë kushtet për lidhje të martesës. Kjo normë kolizive vetëm na sugjeron në cilën të drejtë duhet t'i kërkojmë kushtet për lidhje të martesës.

Në praktikë mund të paraqitet situatë kur një çështje është rregulluar edhe nga e drejta e brendshme, edhe nga ajo ndërkombëtare. Në raste të atilla, shtete të ndryshme e zgjidhin në mënyra të ndryshme raportin ndërmjet së drejtës së brendshme dhe asaj ndërkombëtare. Zgjidhjet lëvizin nga supremaci të së drejtës ndërkombëtare, deri në supremaci të së drejtës së brendshme. Tek ne, përgjigje në këtë pyetje ofron neni 118 nga Kushtetuta e R. së Maqedonisë, i cili parashikon se marrëveshjet ndërkombëtare që janë ratifikuar në pajtim me Kushtetutën janë pjesë të rendit të brendshëm juridik dhe nuk mund të ndryshohen me ligj. Kjo do të thotë se përmes aktit të ratifikimit, përparësi u japim rregullave nga marrëveshjet ndërkombëtare. Kjo paraqet trend edhe ndër shtetet e botës.

Si lloj i veçantë i të drejtës sot imponohet e drejta e Bashkimit Evropian. Përmes kësaj së drejte arrihet unifikim i rregullave të shteteve – anëtare të kësaj bashkësie sui generis. Për R. e Maqedonisë

rëndësi të veçantë ka harmonizimi i të drejtës nacionale me të drejtën e Bashkimit Evropian. Kjo buron nga obligimet që R. e Maqedonisë i ka ndërmarrë në rrugën drejt anëtarësimit të plotë në Bashkimin Evropian. Tek e drejta e Bashkimit Evropian kemi burime të ndryshme, të cilat në mënyra të ndryshme ndikojnë mbi të drejtën e shteteve – anëtare. Si më të rëndësishme i veçojmë Rregulloret të cilat janë të obligueshme për shtetet anëtare dhe të njëjtat drejtpërdrejtë zbatohen. Për zbatim efektiv të së drejtës së Bashkimit Evropian kujdeset Gjykata Evropiane e Drejtësisë.




Figura 13




Figura 14

Pyetje:

1. Çfarë nënkuptohet nën nocionin rend juridik?
2. Nga cilat elemente përbëhet rendi juridik?
3. Cili është elementi esencial i normës juridike?
4. Çfarë është standardi juridik?
5. Përkufizoni nocionin delikt?
6. Cilat lloje të sanksioneve ekzistojnë?
7. Shpjegoni interpretimin e të drejtës!
8. Çfarë nënkuptojmë nën nocionin sistem i të drejtës?
9. Kur paraqitet gjendja e antinomisë?
10. Cili është dallimi ndërmjet institutit juridik dhe degës juridike?

KAPITULLI X

Aktet juridike

1. Akti juridik (nacioni)

Nën nocionin akt juridik nënkuptohet mjete për krijimin dhe zbatimin e të drejtës. Normat juridike dhe e drejta në përgjithësi, krijohen me aktin juridik. Për shembull, me Kushtetutën dhe ligjet krijohen sërë norma juridike. Në rendin juridik të një shteti konkret takohen akte juridike nga më të ndryshmet.

Aktet juridike janë në formë të ligjit, të rregullores, aktgjykimit, etj. Duke e hulumtuar rendin juridik, menjëherë konstatohet se çdo akt miratohet nga organ i autorizuar shtetëror dhe në procedurë përkatëse. Kështu për shembull, tërësisht është e ndryshme procedura kur sillen kushtetuta, kur sillen ligji, kur sillen rregullorja, aktgjykimi, vendimi, etj. Procedurat në të cilat sillen aktet juridike janë juridikisht të rregulluara në mënyrë precize. Aktet më të larta juridike i sjellin organet më të larta shtetërore, në bazë të kompetencës dhe procedurës paraprakisht të përcaktuar me Kushtetutë.

2. Llojet e akteve juridike

Aktet e ndryshme juridike, si pjesë të rendit juridik, kanë një qëllim të përbashkët, edhe atë funksionimin e rendit juridik dhe sistemit të përgjithshëm shoqëror.

Në shkencën juridike janë krijuar kritere të caktuara të cilat kanë mundësuar edhe ndarjen e akteve juridike.

Ekzistojnë më tepër klasifikime të akteve juridike, edhe atë: sipas subjektit që e sjell aktin juridik; llojit të marrëdhënies shoqërore që rregullohet dhe sipas asaj si mund të jetë norma juridike.

Sipas asaj cili subjekt i sjell aktet juridike, ato ndahen në: akte që i sjellin organet shtetërore, akte të organizatave shoqërore dhe akte të personave privat.

Sipas llojit të marrëdhënies shoqërore, ajo janë akte juridike që i rregullojnë marrëdhëniet penale-juridike, pronësore-juridike dhe familjare-juridike.

Sipas normës juridike nëse akti përmban dispozicion ose sanksion, ato ndahen në të plota, si për shembull, në ligj kemi norma juridike të cilat i përmbajnë dyja elementet dhe të paplota, që përmbajnë vetëm një element, si për shembull, akte administrative, vendim, leje, etj.

Një nga ndarjet më të rëndësishme të akteve juridike është ajo e cila i ndan aktet në të përgjithshme (akte juridike abstrakte) dhe individuale (konkrete).

Aktet e përgjithshme juridike janë akte që përmbajnë normë të përgjithshme juridike, ndërsa individuale janë ato që përmbajnë normë individuale juridike.

Në të drejtën, aktet e përgjithshme juridike janë baza nga e cila burojnë aktet individuale juridike. Në aktet e përgjithshme juridike përshkruhet ajo që është e përbashkët për shumë raste individuale. Me aktet individuale juridike konkretizohet dhe përcaktohet një rast. Nga kjo mund të konkludojmë se ndërmjet këtyre llojeve të akteve ekziston ndërlidhje reciproke.

Pyetje për burimet e të drejtës llogaritet një nga pyetjet më të zgjeruara që e hulumton teorinë e përgjithshme për të drejtën. Shumë teoricien që janë marrë me çështjen për burimet e të drejtës, kanë krijuar mendime të ndryshme për vetë nocionin për burim të

së drejtës dhe përcaktimin e tij. Fjala burim i të drejtës përdoret për përcaktimin e krijuesit dhe sfiduesit të së drejtës.

Në shkencën juridike, mbi këtë termin janë paraqitur dy kuptime. Njëri i dedikohet të a.q. burime materiale të së drejtës, ndërsa i dytë burimeve formale të së drejtës.

Nën burime materiale të së drejtës nënkuptohen marrëdhëniet shoqërore, gjendjet faktike ndërmjet njerëzve, ku reflektohen marrëdhëniet ekonomike, kultura, sidomos kultura juridike dhe politike, përvoja historike dhe vetëdija shoqërore.

Në teorinë e të drejtës, nën burime formale të së drejtës i nënkuptojmë aktet e përgjithshme dhe individuale juridike, të miratuara nga organ përkatës dhe në procedurë të përshtuar.

3. Burimet formale të së drejtës (llojet e akteve të përgjithshme juridike)

Burime formale të së drejtës janë aktet e përgjithshme juridike. Ekzistojnë më tepër lloje të akteve të përgjithshme juridike dhe çdo rend i krijuar juridik ka aktet e tija juridike specifike.

Shteti vetë vendos çfarë lloje të akteve të përgjithshme juridike do të ketë.

4. Kushtetuta

Kushtetuta paraqet aktin më të lartë të përgjithshëm juridik, me fuqi më të lartë juridike në një shtet. Ajo është akt themelor për konstituimin e shtetit dhe bazament mbi të cilin krijohen shteti dhe drejta.

Në kuptimin formal, kushtetutën e sjell organi më i lartë në shtet, në procedurë të veçantë dhe në formë të shkruar. Organi më i lartë ligjvënës emërtohet ndryshe në sisteme të ndryshme politike, si për shembull, kuvend, parlament, kongres, senat, etj. Në kuptimin

formal, kushtetutë mund të sjellë edhe organ i veçantë konstitucional (kuvendi konstitucional), që formohet dhe thirret për miratimin e kushtetutës.

Organi ligjvënës e sjell kushtetutën në procedurë të veçantë, e cila dallon nga sjellja e ligjeve. Në raste të veçanta, kushtetutën mund ta sjellë person i caktuar, monark, kryetar, diktator ose grup i personave. Kushtetuta e tillë në të drejtën quhet kushtetutë e dhuruar ose e oktrouar, që e imponon shefi i shtetit të trupit përfaqësues dhe partive politike, nën pretekstin se kështu shpëtohet shteti dhe me qëllim të mbulimit të karakterit jodemokratik dhe vazhdimit të sundimit të regjimit politik.

Si akt më i rëndësishëm juridik, Kushtetuta sillet në dokument të shkruar dhe ajo duhet të jetë vetëm në një akt. Në praktikën kushtetuese juridike mund të takohen edhe kushtetuta me më tepër akte.

Në botë ekzistojnë shtete të cilat nuk njohin kushtetuta në kuptimin formal të fjalës. Anglia, në kuptimin formal-juridik, nuk ka kushtetutë, sepse nuk është e kodifikuar. Anglia ka kushtetutë vetëm në kuptimin material të fjalës. Në Angli janë krijuar disa akte ligjore të cilat kanë edhe rëndësi të veçantë, si për shembull, Bill of rights nga viti 1689, Habeas corpus act nga viti 1679, Magna carta libertatum nga viti 1215. Kushtetuta angleze është e pakodifikuar, sepse parimet e saj janë shpërndarë në më tepër dokumente të veçanta.

Si kushtetuta të para të shkruara në kuptimin formal juridik llogariten Kushtetuta e Virgjinisë nga viti 1776, Kushtetuta e SHBA-ve nga viti 1787, Kushtetuta e Francës nga viti 1791.

Në teorinë, kushtetutat janë ndarë në më tepër lloje, si për shembull: të shkruara dhe të pashkruara. Kushtetutat e shkruara shprehen në dokument të shkruar, gjegjësisht formë të shkruar, ndërsa kushtetutat e pashkruara, edhe pse janë në formë të shkruar, përmbajnë zakone dhe praktika.

Sipas fuqisë juridike, kushtetutat ndahen në të ngurta dhe të buta. Kushtetutat e ngurta ndryshohen shumë vështirë, ndërsa kushtetutat e buta janë lehtë të ndryshueshme. Me ndihmën e Kushtetutës përcaktohet rregullimi shoqëror-ekonomik i shtetit, organizimi i pushtetit shtetëror, funksionimi i tij, marrëdhëniet ndërmjet organeve më të larta dhe më të ulëta, të drejtat dhe liritë e qytetarëve, etj.

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë përmban: liri dhe të drejta themelore të njeriut dhe qytetarit (civile, politike, ekonomike, sociale, kulturore, etj.); organizimin e pushtetit shtetëror: kuvendi i RM, kryetar, qeveri e RM, vetëqeverisje lokale, marrëdhënie ndërkombëtare, mbrojtje e republikës, gjendje ushtarake dhe e jashtëzakonshme.

A) Marrëveshja e Ohrit

Marrëveshja kornizë e Ohrit paraqet pajtimin politik të liderëve (kryetarëve) të katër partive politike të përfaqësuara me më tepër deputet në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë në periudhën zgjedhore 1998 – 2002. Ato ishin VMRO-DPMNE dhe kryetari i saj Lupço Georgievski, i cili njëkohësisht ishte edhe kryetar i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, LSDM e përfaqësuar nga kryetari i partisë Branko Cërvenkovski, PDSH si partner koalicioni i VMRO-DPMNE në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë, e përfaqësuar nga kryetari i partisë Arbën Xhaferi dhe PPD, e përfaqësuar nga kryetari i partisë Imer Imeri. Përkrahës i Marrëveshjes së Ohrit ishte kryetari i Republikës së Maqedonisë, Boris Trajkovski, ndërsa garant të jashtëm për zbatimin e marrëveshjes ishin SHBA-të dhe BE përmes përfaqësuesve të tyre të autorizuar. Marrëveshja u firmos në rezidencën presidenciale në Shkup më 13 gusht të vitit 2001. Edhe pse marrëveshja u firmos në Shkup, prapë quhet marrëveshje e Ohrit sepse i pa-

raprinit biseda intensive politike që u zhvilluar nga qershori deri në gusht në Ohër.

B) Arsyet socio-politike për krizën politike dhe të sigurisë në Republikën e Maqedonisë

Pas shkatërrimit të RSFJ, Republika e Maqedonisë u bë shtet i pavarur dhe sovran, anëtarë e barabartë e bashkësisë ndërkombëtare. Deri në pavarësinë e saj Republika e Maqedonisë arriti përmes rrugës së qetë dhe demokratike. Në janar të vitit 1991 u soll Deklarata për sovranitetin e Republikës së Maqedonisë, ndërsa më 8 shtator të vitit 1991 qytetarët e Republikës së Maqedonisë me shumicë të madhe u përcaktua për shtet të pavarur, me të drejtë për t'u futur në aleancë të shteteve sovrane të Jugosllavisë. Pasi kriza jugosllave u intensifikua dhe u shndërrua në konflikt të hapur ushtarak, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë e rrumbullakoi pavarësinë me sjelljen e Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë më 17 nëntor të vitit 1991. Për kushtetutën votuan të gjithë deputetët, përveç atyre të kombësisë shqiptare, të cilët konsideronin se kushtetuta nuk i plotëson kërkesat e tyre shoqërore dhe politike. Kushtetuta e përkufizoi Republikën e Maqedonisë si shtet të qytetarëve të barabartë, ku sigurohet bashkëjetesa e popullit maqedonas me anëtarët e kombësive. Teksti normativ i kushtetutës përshkruante dhe garantonte korpus të të drejtave dhe lirive njerëzore sipas standardeve më të larta evropiane dhe botërore asokohe. Kjo nënkuptonte edhe garanci dhe mbrojtje të të drejtave të pakicave, përfshirë edhe shprehjen e lirë të përkatësisë etnike, të drejtën e shkollimit në gjuhën amtare, lirinë e praktikimit të përkatësisë fetare, zhvillimin e lirë të kulturës dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, përdorimin zyrtar të gjuhës së pakicës në nivel të vetëqeverisjes lokale ku pakicat janë shumicë ose në numër të konsiderueshëm.

Preambula e Kushtetutës e cila nuk është pjesë e tekstit normativ dhe nuk ka veprim të drejtpërdrejtë juridik, gjegjësisht ka karakter deklarativ dhe solemn, prapë konstaton se historikisht shteti maqedonas është formuar si shtet nacional i popullit maqedonas. Ky tekst ishte një nga arsyet themelore pse deputetët e përkatësisë shqiptare refuzuan të votojnë për kushtetutën e re. Përveç këtij mospajtimi, kishte edhe kërkesa tjera, para së gjithash në lidhje me përdorimin zyrtar të gjuhës shqipe, shkallën e shkollimit në gjuhën shqipe dhe shkallën e decentralizimit. Gjatë viteve të 90-ta ndodhën më tepër incidente të cilat, për fat të keq, përfshin edhe përplasje të armatosura ndërmjet policisë dhe qytetarëve të armatosur shqiptar, të nxitur nga shtypja intensive për realizimin e këtyre kërkesave. Edhe përkundër realizimit gradual të këtyre kërkesave politike, prapë marrëdhëniet ndëretnike u përkeqësuan në dimrin e viteve 2000-2001 dhe rezultuan me konflikt të armatosur i cili e futi shtetin në krizë të vështirë politike dhe të sigurisë. Pakënaqësia te shqiptarët ishte rezultat edhe i luftës në Kosovë, ku luftuan guerilja e UÇK-së me policinë dhe ushtrinë e RFJ.

Kriza nga viti 2001 u intensifikua në muajt mars, prill dhe maj dhe rezultoi me përplasje të armatosura, dhjetëra të vrarë dhe dëme të konsiderueshme materiale. Numër i madh i analistëve politik konsideronin që nëse kriza nuk ndërpritet me mjete politike, e njëjta mund të tejkalon në luftë afatgjate të përgjaksme.

Me presion intensiv nga opinioni dhe bashkësia ndërkombëtare, në fillim të korrikut u firmos deklarata për armëpushim nga ana e liderëve të gueriljes së UÇK-së, njëkohësisht edhe forcat e sigurisë së RM deklaruan ndërprerje të aksioneve të armatosura deri në zgjidhjen përfundimtare politike të krizës. Pas ndërprerjes së veprimeve të armatosura, nën patronazhin e kryetarit Boris Trajkovski dhe në prezencë të përfaqësuesve

të SHBA dhe NATO, filluan bisedimet politike. Qëllimet themelore të bisedave politike ishin: arritja e paqes së përhershme dhe të qëndrueshme, ruajtja e sovranitetit dhe karakterit unitar të RM, fillim i decentralizimit esencial të pushtetit dhe përforcim i rolit dhe kapaciteteve të njësive të vetëqeverisjes lokale, sigurim i sistemit për përfaqësim të drejtë të gjitha bashkësive etnike në institucionet publike, sigurim i mekanizmit për konsensus gjatë vendosjes për çështje në lidhje me statusin e bashkësive etnike jo-shumicë (parimi i shumicës së dyfishtë, e a.q. shumicë e Badinterit) dhe përforcimi i përdorimit të gjuhëve të bashkësive jo-shumicë në nivel qendror dhe lokal (kjo veçanërisht për bashkësitë me më së paku 20% nga popullata e përgjithshme e RM, e ajo është bashkësia etnike shqiptare dhe gjuha shqipe).

C) Amendamentet kushtetuese nga viti 2001

Parimet e deklaruara nga Marrëveshja kornizë e Ohrit u shndërruan në amendamente kushtetuese (gjithsej 18 amendamente), të cilat me propozim të kryetarit të republikës i miratoi Kuvendi i RM. Me këto amendamente konsiderueshëm i ndryshua përmbajtja e Kushtetutës së deriatëhershme, duke filluar nga preambula, e deri tek dispozitat për ndryshim dhe plotësim të Kushtetutës. Përveç ndryshimeve të tekstit kushtetues, i sollën edhe numër i madh i ligjeve të reja. Më të rëndësishmit janë korpusi i ligjeve në lidhje me vetëqeverisjen lokale, edhe atë: Ligji për vetëqeverisje lokale, Ligji për financimin e njësive të vetëqeverisjes lokale, Ligji për ndarje territoriale. Grup tjetër i rëndësishëm i ligjeve janë ligjet në lidhje me të drejtat gjuhësore, arsimore dhe kulturore të bashkësive etnike, nga të cilat më i rëndësishëm është Ligji për përdorimin e gjuhës, si dhe Ligji për themelimin e Universitetit shtetëror në Tetovë me mësim në gjuhën shqipe. Grupi i tretë i ligjeve u dedikohen organeve shtetërore dhe enteve pu-

blike dhe përmes tyre u implementua edhe parimi për përfaqësim të drejtë dhe përkatës të gjitha bashkësive etnike në organet e pushtetit shtetëror.

Marrëveshja kornizë e Ohrit nuk është akt juridik, por gjest i harmonizimit politik, edhe pse shfrytëzohet termi marrëveshje ajo nuk sugjeron formën juridike, por është shprehje e harmonizimit politik të përfaqësuesve të partive më të rëndësishme politike të cilat politikisht i përfaqësonin dy komunitetet më të mëdha në RM.

5. Ligji

Ligji si akt i përgjithshëm juridik në shkallën hierarkike të akteve juridike e ndërmerr vendin e dytë, pas kushtetutës. Ligje sjell organi ligjvënës në shtet (kuvendi) në procedurë përkatëse.

Me ligjin krijohet e drejta dhe rregullohen marrëdhëniet më të rëndësishme shoqërore. Në lidhje me përcaktimin e nocionit ligj si burim formal i të drejtës, janë krijuar terme të ndryshme jo vetëm në shkencën juridike, por edhe më gjerë. Ligji mund të perceptohet ndryshe. Në të drejtën janë dhënë tre kuptime: sipas të parit, nën nocionin ligj bien gjitha dispozitat juridike në një shtet. Si për shembull, të gjithë qytetarët duhet t'i nënshtrohen ligjeve. Sipas kuptimit të dytë, nën nocionin ligj nënkuptohet një normë juridike në formë të shkruar. Sipas kuptimit të tretë, nën nocionin ligj nënkuptohet burim i shkruar i të drejtës që ka fuqi më të madhe juridike, gjegjësisht ai është akt që e sjell organi më i lartë shtetëror.

Gjithashtu në teorinë juridike janë krijuar edhe dy nocione për ligjin, edhe atë: ligj në kuptimin material dhe ligj në kuptimin formal.

Nën ligj në kuptimin material nënkuptohet çdo akt juridik që përmban normë të përgjithshme juridike, gjegjësisht i cili në mënyrë përmbajtësore rregullon materie ligjore.

Nën ligj në kuptimin formal nënkuptohet çdo akt që sillet nga organ kompetente ligjvënës në procedurë të përshtuar dhe formë përkatëse. Në kuptimin formal, në shtete të ndryshme, ligjin e sjellin organet ligjvënëse nën emra të ndryshëm, si për shembull, kongres, parlament, kuvend, etj. Organi ligjvënës mund të përbëhet nga një, dy ose dhoma. Për shembull, parlamenti në Angli përbëhet nga dhoma e epërme dhe e poshtme. Kongresi në Amerikë përbëhet nga dhoma përfaqësuese dhe senati. Në Angli, dhoma e epërme çdoherë është konservative dhe pengon sjelljen e ligjeve përkatëse progresive të propozuara nga dhoma e poshtme.

Kur flitet për shtetet e përbëra dhe për rregullimin e tyre shtetëror, për shembull, në federatë, ligje mund të sjellin shtetit federal dhe njësitë federale. Gjitha ligjet që i sjellin njësitë federale patjetër duhet të jenë në pajtim me kushtetutën federale. Si një nga çështjet më të ndërlikuara për sjelljen e ligjit është procedura. Procedura ligjvënëse për sjelljen e ligjit është e njëjtë për gjitha ligjet, rreptësisht e përcaktuar dhe përbëhet nga disa faza.

Procedura në përgjithësi përbëhet nga fazat vijuese: nismë për sjelljen e ligjit, dorëzim i propozimit ligjit, shqyrtim i propozimit, votim dhe shpallje dhe hyrje në fuqi.

Në teorinë juridike, ligjet klasifikohen në bazë të më tepër kriterëve të ndryshme. Sipas llojit të marrëdhënieve shoqërore, gjegjësisht përmbajtjes, ndahen në ligje të së drejtës penale, civile, tregtare, etj. Ekziston ndarje në ligje kushtetuese, sistematike (organike) dhe të rëndomta. Ligjet kushtetuese rregullojnë materie e cila në aspektin përmbajtësor është materie kushtetuese ose përmbajnë norma në lidhje me zbatimin e normave kushtetuese. Ligjet kushtetuese sipas rregullit sillen me shumicë të njëjtë sikur gjatë sjelljes së Kushtetutës dhe në procedurë të ndërlikuar, e cila rëndom është identike me procedurën për sjelljen e Kushtetutës. Ligje sistematike ose organike janë ato të cilat rregullojnë degë

të tërë të sistemit juridik ose sferë të tërë juridike dhe rëndom sillen me shumicë më të lartë nga ligjet e rëndomta. Ligje të rëndomta janë të gjitha ligjet që i sjell trupi ligjvënës në procedurë përkatëse me shumicë të parashikuar, e të cilat nuk bëjnë pjesë tek ligjet organike. Në praktikën juridike mund të takohen edhe ligje latente. Ato janë ligje që nuk janë në përdorim të përditshëm, gjegjësisht hyjnë në fuqi në situata të caktuara, sikur vërshime, tërmet, luftë (për shembull, ligji për fatkeqësi elementare, ligji për mobilizim, etj.).

Në teorinë juridike, përveç ligjeve, takohen edhe kodet dhe kodekset. Sjellja e atyre akteve njihet si kodifikim. Kodi paraqet akt të përgjithshëm juridik që rregullon një sferë konkrete të së drejtës. Për dallim nga ai, ligji rregullon një sferë më të vogël. Në zhvillimin historik të së drejtës janë krijuar më tepër kodifikime, ndër të cilat i veçojmë: Kodi i Justinijanit, i Napoleonit, i Hamurabit, etj. Krahasuar me kodifikimin që përfshin një sferë të tërë të së drejtës, ekziston edhe nocioni inkorporim që paraqet bashkim dhe grupit të thjeshtë të ligjeve të vogla ekzistuese dhe burimeve tjera të së drejtës në një kod më të vogël.

Kuvendi i RM, si organ ligjvënës, përveç që sjell ligje në kuadër të kompetencës së tij, mund të sjellë edhe rezoluta, rekomandime, vendime, deklarata, konkludime, etj.

6. Aktet juridike nënligjore

Aktet nënligjore juridike i sjellin organet shtetërore më të ulëta nga organi ligjvënës, për dallim nga ligji të cilin si akt të përgjithshëm juridik e sjell organi ligjvënës.

Ato organe janë trupat përfaqësues ekzekutiv, administrativ, gjyqësor, lokal, si për shembull, kuvendi komunal, organet e tija ekzekutive, si dhe organe tjera të parashikuara me të drejtën pozitive të shtetit. Këto akte, nëse përmbajnë norma individuale juridike,

janë akte individuale juridike, siç janë aktgjykim, aktvendim, ndërsa në rast të përmbajtjes së normave të përgjithshme juridike, atëherë paraqesin burim të së drejtës. Këto akte duhet të jenë në pajtim me ligjin, që domethënë se nuk mund ta kundërshtojnë atë. Të njëjtat sillen nga ana e organeve që janë në strukturë hierarkike të organeve shtetërore më të ulëta nga organi ligjvënës.

Atëherë kur aktet juridike nënligjore e kundërshtojnë ligjin, të njëjtat bëhen të pavlefshme, të kundërligjshme dhe abrogohen.

Aktet juridike nënligjore manifestojnë fuqi të ndryshme juridike. Disa kanë fuqi më të madhe nga të tjerat, varësisht nga vendi i organit në rendin hierarkik të organeve shtetërore. Por gjithashtu ka edhe raste kur organ i njëjtë shtetëror mund të sjellë akt juridik nënligjor që ka fuqi të ndryshme juridike. Kjo ndodh me qeveritë të cilat sjellin rregullore dhe vendime, me ç'rast rregulloret çdoherë janë me fuqi më të madhe juridike nga vendimet.

Si akte juridike nënligjore figurojnë: rregullorja, urdhëresa, rregullorja, udhëzimi, vendimi, etj.

Dispozita

Dispozita është akti më i rëndësishëm juridik nënligjor. Dispozitën e sjellin organet ekzekutive ose administrative në shtet (qeveri, këshill ministror), për dallim nga ligji që sillet nga organi ligjvënës. E njëjta miratohet në procedurë përkatëse e cila nuk ka faza qartë të ndara sikur procedura ligjvënëse. Ajo sipas rregullit sillet në seanca qeveritare dhe, sipas nevojës, mund menjëherë të zbatohet. Me rregulloren përpunohen normat e ligjit.

Në teorinë juridike ekzistojnë kritere të ndryshme për ndarjen e rregulloreve. Një nga ndarjet më të rëndësishme është ajo që i ndan rregulloret për zbatim të ligjit dhe rregulloret me fuqi ligjore.

Qëllimi i dispozitave për zbatim të ligjit është realizimi i ligjit. Klauzola ekzekutive është baza për krijimin e këtyre rregulloreve, me

të cilën organi ligjvënës e autorizon qeverinë ose e rekomandon të sjellë rregullore përmes cilës më saktësisht do të rregullohet sferë e caktuar e marrëdhënieve. Në këtë situatë, qeveria ka obligim të sillet në kufijtë e autorizimeve të dhëna. Këto rregullore ekzistojnë derisa ekziston ligji.

Dispozitat me fuqi ligjore sillen në raste të nevojës, si për shembull, në situata të luftës, fatkeqësive elementare, etj. Me këto rregullore mund të rregullohen dispozita ligjore dhe kushtetuese, ndërsa njëkohësisht rregullohen marrëdhënie që janë lëndë e rregullimit ligjor. Pas kalimit të nevojës, rregullorja duhet të parashtrohet në vërtetim tek organi ligjvënës, sepse bëhet fjalë për materie legjislativë.

Gjithashtu janë të njohura të ashtuquajturat rregullore-ligje si lloj i rregullave me fuqi ligjore. Këto rregulla sillen me qëllim të rregullohen të gjitha raportet shoqërore që trupi ligjdhënës nuk mund t'i rregullojë me ligj. Lihet mundësia nga ana e parlamentit, raporte të caktuara të cilat janë materie ligjdhënëse, me vlerësim diskrete të qeverisë të rregullohen me rregulla.

Dispozitat me fuqi ligjore shpesh takohen gjatë ekzistimit të tendencave për pavarësim të pushtetit ekzekutiv ndaj atij legjislativ ose në kushte të krizave politike dhe kur qeveria e shpërndan parlamentin.

Në teorinë juridike takohet edhe *nocioni legjislativë* e dekretuar, që është legjislativë që realizohet me ndihmën e rregulloreve – ligjeve, gjegjësisht rregulloreve me fuqi ligjore.

Në Republikën e Maqedonisë, sipas nenit 126 të Kushtetutës, dispozita me fuqi ligjore sjell Qeveria, edhe atë në gjendje ushtarake ose të jashtëzakonshme. Autorizimi i qeverisë të sjellë rregullore me fuqi ligjore zgjat deri në përfundimin e gjendjes ushtarake ose të jashtëzakonshme, për çka vendos Kuvendi i Republikës së Maqedonisë.

Urdhëresa

Urdhëresa është akt juridik nënligjor që sillet nga organet e administratës shtetërore, gjegjësisht ministrive resore, me qëllim të zbatimit të ligjeve dhe dispozitave tjera. Me këtë akt rregullohet situatë përkatëse me rëndësi të përgjithshme. Urdhëresa është akt përmes të cilit diçka urdhërohet. Ajo përmban urdhër përkatës, i cili është i kushtëzuar dhe i lidhur për situatë të caktuar. Ky urdhër për nga natyra e tij nuk është urdhër konkret, por ka karakter të përgjithshëm. Ajo u referohet numrit të pacaktuar të njerëzve që gjenden në situatë të caktuar. Urdhri e gjen bazën e tij në ligj ose akt tjetër. Me urdhëresën përpunohen dhe shpjegohen pjesë të caktuara nga ndonjë akt më të lartë se ajo, si për shembull, rregullore. Me urdhëresën, për subjektet e të drejtës nuk krijohen të drejta dhe obligime që nuk janë të bazuara me ligj.

Nevojitet të kryhet dallimi i urdhëresës si akt juridik nënligjor, nga urdhëresa si akt individual juridik, që është lëshuar në kuptim të urdhëresës, porosi e dërguar ndaj personit konkret.

Rregullorja

Rregullorja paraqet akt juridik të përgjithshëm nënligjor që e sjellin organet administrative (ministrinë, sekretariate).

Në sistemin tonë juridik, rregulloret miratohen vetëm për zbatim dhe përpunim të ligjeve dhe rregullave të tjera dhe akte të kuvendeve të komuniteteve shoqërore-politike dhe ngjashëm.

Me ndihmën e rregulloreve mundësohet të rregullohet organizimi i brendshëm për punën e organit të caktuar. Si aktet e tjera nënligjore edhe rregullorja miratohet në bazë të miratimit të mëparshëm që është i vërtetuar me akt konkret, ligj, dispozitë etj. Te ne këto akte i miratojnë funksionarë të lartë administrativ, si për shembull, rregullore për ministrin e mbrojtjes publike me çka rregullohet pyetja e formës, ngjyrës, veshjes së ushtarakëve.

Udhëzimi

Udhëzimin si akt juridik nënligjor sipas rregullit e sjellin organet administrative, përmes të cilit përcaktohet si duhet të zbatohet ndonjë akt juridik më i lartë ose më i ulët, si për shembull, ligj, rregullore. Në shkallën hierarkike, krahasuar me aktet tjera, ky akt disponon fuqi më të ulët juridike, sepse normat e tij kanë karakter teknik. Në këtë mënyrë vërtetohet se ai nuk mund të krijoj normat të reja, sepse mund vetëm ta përsosë mënyrën e zbatimit të normave juridike tanimë të miratuara.

Me udhëzimin mund të përcaktohen edhe norma të përgjithshme përkatëse, të cilat përcaktohen për krijimin e drejtave dhe obligimeve përkatëse të qytetarëve.

Sjellja e udhëzimit e supozon ekzistimin e autorizimit, që është përshkruar me ligj ose akt tjetër juridik. Udhëzimet mund të kenë fuqi obliguese vetëm ndaj organeve që u dedikohen.

Vendimi

Sjellja e akteve të përgjithshme juridike në nivel të komunës, si njësi e vetëqeverisjes lokale, quhet vendim. Vendimet paraqesin aktet më të larta nënligjore juridike që i sjell këshilli komunal.

Shpesh shpjegohet se ato janë ligje komunale, sepse për sjelljen e tyre kuvendi komunal ka dhënë autorizim me ligj. Për sjelljen e vendimit parashikohet procedurë me akt më të lartë juridik, gjegjësisht statusi. Me vendimet rregullohen pyetjet dhe marrëdhëniet të cilat kanë rëndësi lokale, si për shembull, çështjet nga sfera e urbanizmit, veprimtarive komunale, arsimit fillor, mbrojtjes themelore, etj.

Krahasuar me statusin që paraqet aktin më të lartë themelor juridik në komunë, vendimi si akt më i ulët duhet të jetë në pajtim me të. Si akte të përgjithshme juridike të sjella nga komu-

na, vendimet i nënshtrohen vlerësimit të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë.

Në teorinë juridike janë paraqitur mendime për diferencimin e vendimeve të pavarura dhe plotësuese. Me vendimet e pavarura plotësohen të a.q. zbrazëtira, që u dedikohen pyetjeve të cilat nuk janë rregulluar me ligj. Ndryshe, me vendimet plotësuese përpuhohet normë përkatëse juridike dhe e njëjta përsoset për kushtet e veçanta të komunës. Ato vendime mund të sillen vetëm me autorizim të veçantë të përcaktuar me ligj.

Vendimi si akt juridik nënligjor që sillet nga këshilli komunal, (këshillat e komunave). E njëjta dallon nga vendimet e sjella, për shembull, nga parlamentet, kuvendi dhe qeveritë e shteteve.

Përveç statusit dhe vendimit, nëpër komuna mund të sillen edhe akte tjera të përgjithshme, si për shembull, urdhëresa, aktvendime, rekomandimet, udhëzime, buxhet, llogari përmbyllëse, etj.

Gjitha aktet e miratuara nga komuna obligueshëm duhet të jenë në pajtim me Kushtetutën, ligjet dhe me aktet e organeve më të larta dhe aktet e njëjta duhet të jenë në pajtim me vendimet e kuvendit komunal. Jo gjitha aktet e sjella nga komuna janë juridike, gjegjësisht nuk kanë karakter juridik, si për shembull, sjellja e rekomandimit.

Dekreti

Dekreti paraqet akt nënligjor të cilin e miraton shefi i shtetit si organ individual (kryetar i republikës, monark) ose organ kolektiv (prezidium ose kryesi).

Sipas fuqisë juridike, dekreti çdoherë e ndërmerr vendin pas ligjit. Dekreti mund të jetë i përgjithshëm ose individual. Në rast kur shefi i shtetit me dekretin emëron përfaqësues diplomatik, persona të lartë ushtarak, ai përmban normë juridike individuale e cila është edhe konkrete dhe në këtë rast paraqitet si akt individual. Në rast

të tillë, akti i miratuar bëhet rregullore me fuqi ligjore e cila nga rregullorja e miratuar nga qeveria dallon vetëm për nga miratuesi. Për ne është e pranuar një pikëpamje që gjendet në shkencë dhe sipas së cilës dekreti sqarohet si akt specifik, që mund të ketë karakter të aktit të përgjithshëm dhe të veçantë.

Në Republikën e Maqedonisë dekretin e sjell kryetari i shtetit për emërim, revokim të ambasadorëve dhe përfaqësuesve tjerë diplomatik-konsullor të RM-së jashtë shtetit për shpallje të ligjeve. Dekretin për shpalljen e ligjit patjetër duhet ta firmosin kryetari i republikës dhe kryetari i kuvendit.

7. Burimet e veçanta të së drejtës (burime juridike për plotësimin e zbrazëtirave juridike)

Në praktikën juridike, si burime të së drejtës janë paraqitur akte të përgjithshme juridike të miratuara nga organet shtetërore ose subjekte tjera të autorizuara. Në praktikën juridike ka pasur raste kur një raport shoqëror nuk është rregulluar me burim juridik, sepse nuk është krijuar normë juridike për zgjidhjen e tij. Në rast të tillë bëhet fjalë për ekzistim të zbrazëtirës juridike.

Zbrazëtirat juridike krijohen si rezultat i faktit që ligjvënësi nuk është në mundësi t'i parashikojë dhe në mënyrë normative t'i rregullojë gjitha raportet shoqërore, sidomos në kushte të ndryshimit të vazhdueshëm të raporteve shoqërore.

Nëse raporti shoqëror nuk është rregulluar me normë të përgjithshme juridike, atëherë ai obligueshëm do të rregullohet me normë individuale juridike, për shembull, nëse një person kërkon mbrojtje juridike para gjykatës për shkak të mosmbajtjes së fjalës së dhënë nga person tjetër që i ka premtuar se bashkë do të shkojnë në kinema, gjykata në këtë rast nuk mund të diskuton sipas padisë së parashtruar, sepse raporti i tillë nuk është juridik.

Mirëpo, nëse një person huazon para ose gjësend nga një person tjetër dhe nëse personi tjetër nuk i kthen paratë ose gjësendin, gjykata juridikisht do ta mbrojë huadhënësin sepse në këtë rast bëhet fjalë për raport shoqëror, pasi ekziston zbrazëtirë juridike.

Veçanërisht duhet të theksohet se norma individuale juridike që është sjellë në rast të zbrazëtirës juridike, nuk mund të paraqet burim formal të së drejtës. Normat e tilla në të drejtën llogariten si norma në kuptimin formal-juridik dhe material. Në rast të zbrazëtirës juridike, gjykata ose ndonjë organ tjetër ka të drejtë në mënyrë arbitrare të sjellë normë individuale juridike sipas vlerësimit të lirë dhe të shqyrton cili vendim do të jetë i dobishëm për interesin e bashkësisë shoqërore. Në lidhje me zbrazëtirat juridike, në teori janë krijuar mendime të ndryshme për atë se cilat mjete juridike mund të përdoren për zgjidhjen e gjitha atyre raporteve juridikisht të parregulluara shoqërore. Përveç akteve të përgjithshme juridike, si burime të së drejtës mund të paraqiten zakoni, praktika gjyqësore, shkenca juridike, etj.

8. Aktet individuale juridike

Aktet individuale juridike janë aktet të cilat përmbajnë normë individuale juridike. Këto akte zgjidhin situatë përkatëse konkrete me ndihmën e të cilave fillon dhe mbaron ekzistimi i tyre. Bazë dhe burim i akteve individuale juridike janë aktet gjegjësisht normat e përgjithshme juridike. Normat e përgjithshme juridike të cilat janë inkorporuar në aktet e përgjithshme juridike, nuk kanë mundësi të drejtpërdrejtë për zbatim.

Rregullat e sjelljes, të përmbajtura në normat e përgjithshme juridike, në moment të caktuar duhet të konkretizohen. Ky moment i konkretizimit nis nga norma më e ulët juridike, e cila në fund mbaron me normë juridike individuale, gjegjësisht konkrete.

Në situata të caktuara ekziston normë e përgjithshme juridike dhe e njëjta mund të zbatohet drejtpërdrejtë pa sjellje të normë individuale juridike, për shembull: personi me mbushje të moshës 18 vjeçare fiton të drejtën e votës. Shumica e normave të përgjithshme juridike nuk mund të zbatohen drejtpërdrejtë, andaj nevojitet sjellje e normave individuale juridike. Për shembull, nëse kemi normë të përgjithshme e cila i obligon qytetarët të paguajnë tatim të pronës së poseduar, në këtë rast nuk mund të realizohet norma e përgjithshme juridike pa akt individual juridik, me të cilin përcaktohet se personi I. V. obligohet ta paguajë tatimin në shumë konkrete, paraprakisht të përcaktuar nga organi kompetent.

9. Llojet e akteve individuale juridike

Në shkencën juridike, aktet individuale juridike ndahen sipas miratuesit të aktit dhe sipas përmbajtjes së normës juridike.

Sipas ndarjes së parë, gjegjësisht miratuesit, ato ndahen në akte individuale juridike të sjella nga organet shtetërore dhe akte nga persona privat. Në akte të sjella nga organet shtetërore bëjnë pjesë: aktet individuale juridike administrative dhe gjyqësore, ndërsa akte të personave privat konsiderohen çështjet juridike (veprimet juridike).

Sipas përmbajtjes së normës juridike, ato ndahen në të plota dhe të paplota, varësisht nga fakti nëse në akt kemi vetëm dispozicion ose vetëm sanksion, ose mund të jenë të përmbajtura të dyja elementet normative.

Si akte të paplota individuale juridike konsiderohen ato të cilat përmbajnë vetëm një element nga norma juridike. Të plota konsiderohen ato që i përmbajnë të dyja elementet. Aktet e plota juridike krijohen vetëm në rast të ekzistimit të zbrazëtirës juridike. Aktet e plota juridike mund të paraqiten atëherë kur dispozicioni dhe sanksioni janë dispozitive, për shembull, shqiptim i dënimit në rast të mos-

plotësimit të marrëveshjes. Në praktikën juridike në masë të madhe janë përfaqësuar aktet individuale gjyqësore juridike, krahasuar me aktet individuale administrative juridike. Shembull për akt të plotë individual gjyqësor kemi kur gjykata do ta përcaktojë dispozicionin sipas të cilit një person obligohet t'i paguajë personit tjetër shumë prej 5.000 denarë. Në rast të mospagesës, do të ndëshkohet.

Akti administrativ

Aktin administrativ si akt individual juridik e sjell organi i administratës në kryerjen e veprimtarisë së tij. Sikurse gjitha aktet tjera juridike, edhe akti administrativ mund të përkufizohet në kuptimin formal dhe material.

Në kuptimin formal, akti administrativ paraqet akt individual juridik, të cilin e sjell organi i administratës në procedurë veçanërisht të përcaktuar. Në kuptimin material, akti administrativ çdoherë përmban normë individuale juridike. Me aktin administrativ konkretisht përcaktohet dispozicioni i normës së përgjithshme juridike. Akti individual juridik duhet të jetë në pajtim me aktin e përgjithshëm juridik nga i cili buron.

Përveç organeve të administratës të cilat janë tërësisht të autorizuar të sjellin akte administrative, në përjashtim akte të tilla mund të sjellin edhe organe legjislative dhe gjyqësore. Ky miratim nuk mund të jetë në kuptim formal, por vetëm në atë material.

Krahasuar me procedurën gjyqësore e cila është tepër e ngadalshme dhe më e përgjithësuar, procedura administrative është më e shkurtër, më e shpejtë dhe më efikase. Organet e administratës veprojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë. Për shembull, nëse një person kalon rrugën në vend të ndaluar, pjesëtari i policisë, si person i autorizuar, ka të drejtën e ndëshkimit në vendngjarje. Tek organet gjyqësore, gjendja është tepër e ndryshme,

sepse organi gjyqësor do të veprojë pas krijimit të veprimit, për shembull, inicim nga ana e subjektit përkatës. Shumica e akteve administrative, si akte individuale, paraqiten në formë të aktvendimeve (aktvendim për ndërtim të shtëpisë), lejeve (leje për mbajtje të armës), etj. Nëse ekziston kontradiktë, paligjshmëri, në rast të tillë akti anulohet. Si mjete juridike të cilat mundësojnë mbrojtje të plotë nga sjellja e akteve të paligjshme juridike janë ankesa dhe padia.

Akti gjyqësor

Akti gjyqësor është akt individual juridik të cilin e sjell gjykata gjatë vendosjes së çështjeve në kompetencë të saj. Sikurse aktet tjera, edhe ky akt mund të shqyrtohet në kuptimin formal dhe material.

Në kuptimin formal, atë e sjell gjykata në procedurë të caktuar. Në kuptimin material është akt me të cilin përcaktohet sanksioni ose raporti juridik. Sidomos është karakteristike që akti gjyqësor në kuptimin material çdoherë është i ndërlidhur me cenimin e dispozicionit të normës juridike.

Për dallim nga procedura administrative, procedura gjyqësore është shumë më e ndërlikuar, më e ngadalshme dhe më e rreptë. Ajo përcaktohet në kode ose ligje më të mëdha (penale, civile dhe procedura jashtëkontestimore).

Akti gjyqësor të cilin e sjell gjykata, parimisht ka për qëllim zgjedhjen e kontestit të caktuar dhe vendosjen e marrëdhënieve të drejta të cilat më herët janë çrregulluar. Me vetë shqiptimin e sanksionit me aktin gjyqësor mundësohet qëndrueshmëri e plotë dhe funksionim i rendit juridik.

Për dallim nga akti administrativ, i cili mund të ndryshohet edhe pas kalimit të kohës së caktuar, akti gjyqësor nuk lejon ndryshueshmëri. Akti gjyqësor, pasi të zgjidh një kontest për vlerësimin e

ligjshmërisë për atë që ka ndodhur në të kaluarën dhe kur përfundimisht të përcaktojë dhe sjell vendim, nuk lejon që të ndryshohet. Rendi juridik, me përjashtim dhe me ekzistim të kushteve, mund të lejojë përtëritjen e procedurës.

10. Kushtetutshmëria dhe ligjshmëria

Nocioni ligjshmëri në teorinë e të drejtës përcaktohet ndryshe. Rëndom nën nocionin ligjshmëri nënkuptohet harmonizimi i gjitha akteve juridike dhe materiale me ligjin në kuptimin formal.

Sipas parimit të ligjshmërisë, gjitha aktet më të ulëta nga ligji duhet të jenë në pajtim me ligjin, pa marrë parasysh nëse bëhet fjalë për akte juridike të përgjithshme ose individuale. Teoricien të caktuar e shpjegojnë ligjshmërinë në një kuptim më të ngushtë, i cili duhet të jetë në pajtim vetëm me aktet juridike individuale, e në këtë rast nocioni ligj pranohet në kuptim material, e jo si ligj në kuptimin formal.

Parimi i ligjshmërisë në rendin juridik mundëson gjitha pjesët e tij të ndërlidhen në tërësi të vetme unike, që të mund rendi juridik të funksionojë. Harmonizimi i elementeve të rendit juridik çdoherë do të varet nga aktet më të larta juridike, Kushtetutën dhe ligjet. Vendi i çdo akti juridik sipas shkallës varet nga fuqia juridike e aktit juridik.

Fuqia juridike e aktit juridik paraqet shkallën e ndikimit të një akti juridik mbi tjetrin, masë e cila përcakton cili është akt juridik më i ulët, e cili më i lartë.

Fuqia juridike e aktit juridik varet nga pozita e aktit juridik në hierarkinë e sistemit juridik. Hierarkia e sistemit juridik përcaktohet sipas kriterëve vijuese formale-juridike: e para, organi kompetent që e sjell aktin juridik, e dyta, procedura në të cilën sillen akti juridik dhe e treta, lloji gjegjësisht forma e sjelljes së

aktit juridik. Në shkallën hierarkike të akteve juridike, në vend të parë është kushtetuta, e pas saj vijnë ligjet, vijojnë aktet e përgjithshme juridike nënligjore, sikur: rregullore, vendime, por vetëm kur përmbajnë normë të përgjithshme juridike, urdhëresa, por vetëm kur përmbajnë normë të përgjithshme juridike dhe në fund të shkallës janë aktet juridike individuale, gjegjësisht aktet administrative, rëndom në formë të aktvendimeve dhe akteve gjyqësore, tek të cilat më i rëndësishëm është aktgjykimi. Më së poshti në shkallën hierarkike gjenden veprimet materiale, të cilat duhet të jenë në pajtim me gjitha aktet juridike autoritative.

Nëse ka kundërshtim në raportin akt juridik më i ulët dhe më i lartë, ose kundërshtim i veprimeve materiale ndaj akteve juridike, atëherë bëhet fjalë për padrejtësi. Nëse ky mospajtim i dedikohet kundërshtimit të akteve më të ulëta dhe veprimeve materiale krahasuar me ligjin, padrejtësinë e emërtojmë paligjshmëri. Nëse mospajtimi i dedikohet kundërshtimit të ligjeve, akteve më të ulëta juridike nga ligji dhe veprimeve materiale, krahasuar me Kushtetutën, atëherë këtë mospajtim e quajmë pakushtetueshmëri.

Padrejtësia formale-juridike ekziston kur akti juridik është sjellë nga organ jokompetent, në kundërshtim me procedurën përkatëse dhe me formën e parashikuar.

Padrejtësia materiale-juridike reflektohet kur përmbajtja e një akti më të ulët juridik është në kundërshtim me aktet më të larta juridike. Pasojat juridike nga padrejtësia e akteve juridike janë abrogimi ose anulimi i akteve juridike. Anulimi i aktit juridik domethënë se nga ai moment, norma e anuluar juridike tashmë nuk mund të zbatohet, gjegjësisht nëse faktikisht zbatohet, nuk prodhon pasoja juridike. Megjithatë, me anulimin e normës juridike pranohen gjitha pasojat juridike të cilat ajo i ka prodhuar deri në momentin e anulimit të saj. Anulimi i normës juridike sjell asgjësim të gjitha pasojave

juridike të prodhuara nga momenti i sjelljes së saj. Me anulimin krijohet fiksion juridik se ajo normë as që ka ekzistuar ndonjëherë.

Aktet materiale mund të paraqiten si të pajtueshme me rendin juridik dhe si të kundërligjshme. Ligjshmëria si parim ndërmerr vend kyç në funksionimin e rendit juridik dhe në përgjithësi në funksionimin e shtetit.

Ligjshmëria rezulton me siguri juridike, që është një nga vlerat themelore të së drejtës, pa të cilën nuk mund të garantohet rendi, paqja dhe liria e njerëzve.

Plotfuqishmëria dhe zbatueshmëria

Plotfuqishmëria e akteve administrative dhe gjyqësore është nocion tepër i rëndësishëm në komunikacionin juridik dhe është në lidhje të ngushtë me mbrojtjen e raporteve juridike. Akti administrativ ose gjyqësor në moment të caktuar nevojitet të bëhet *përfundimtar*, gjegjësisht palët të mos mund më tej ta sulmojnë. Mossulmimi i tillë i akteve gjyqësore dhe juridike në të drejtën quhet *plotfuqishmëri formale*. Ajo, nga ana tjetër, për pasojë ka plotfuqishmërinë materiale, gjegjësisht kompetencën e përmbajtjes së aktit të tillë, që domethënë se palët e marrëdhënies juridike, si dhe gjitha organet tjera, janë të obliguar ta respektojnë aktin formal – të plotfuqishëm. Esenca e plotfuqishmërisë formale përbëhet nga pamundësia e sulmit të mëtejshëm të aktit me mjete juridike, ndërsa plotfuqishmëria materiale i dedikohet përmbajtjes së aktit, bashkë me pasojën, për përmbajtjen e aktit të aktit formal – të plotfuqishëm të jenë të ndërlidhur dhe t'u referohen sikur palët e marrëdhënies juridike, ashtu edhe gjitha subjektet dhe organet.

Akte të pavlefshme janë ato që çrregullojnë vlera të interesit më të madh shoqëror. Aktet e tilla zhvlerësohen "ex tunc", gjegjësisht nga momenti i hyrjes në fuqi të aktit të kundërligjshëm. Domethënë, këtu nuk zhvlerësohet vetëm akti, por anulohen edhe

gjitha pasojat juridike të cilat në ndërkohë ai akt juridik i ka shkaktuar.

Akt i kundërligjshëm përmbysës është ai që çrregullon vlera më të vogla shoqërore. Procedura për përmbysjen e aktit të atillë iniciohet nga palët e interesuara. Tek akti përmbysës e kemi veprimin "ex pips", gjegjësisht kur sillet akt i ri juridik, ndërpritet vlefshmëria e të vjetrit, pa u futur në pasojat e shkaktuara nga akti i vjetër juridik. Mundësia për parashtrimin e kërkesës për fillimin e procedurës për përmbysje të aktit të kundërligjshëm është e kufizuar në kohë.

Mjetet juridike me të cilat pala ose prokurori publik e fillon procedurën për pavlefshmërinë, përmbysjen ose ndryshimin e aktit formal juridik, emërohen si *mjete të jashtëzakonshme juridike*, gjegjësisht *mjete juridike*.

Në grupin e mjeteve të jashtëzakonshme juridike numërohen: përtëritja e procedurës, ankesa për anulimin e aktgjykimit, vëzhgimi i instancës dhe kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Në të drejtën penale ekzistojnë institutet amnisti dhe falje. Këto institute e zbusin rreptësinë e plotfuqishmërisë formale dhe materiale. Falja e akt individual juridik me të cilin persona të caktuar lirohen nga ndjekja penale, u falet dënimi (plotësisht ose pjesërisht), dënimi i shqiptuar ulet, ndryshohet në dënim me kusht ose mënjahen pasojat juridike nga aktgjykimi. Falja është në ingerenca të Kryetarit të shtetit.

Amnistia është akt i përgjithshëm juridik ku personat individualisht nuk janë përcaktuar, ndërsa përcaktimi kryhet sipas karakteristikat të përgjithshme, që për të drejtën penale janë me rëndësi; për shembull, autor të veprave të caktuara penale ose persona të gjykuar që vuajnë dënim me burg në Republikën e Maqedonisë. Amnistia është në kompetenca të organi ligjvënës.

Ankesa në të drejtën emërohet si mjet i rregullt juridik. Palët në marrëdhënien juridike kanë të drejtën e dyshimit në drejtësinë e akteve juridike që miratohen nga organet shtetërore në shkallë të parë. Ankesa mund t'i dedikohet ose cenimit të rregullave procesore (cenim i procedurës, vendim i miratuar nga organ jokompetent) ose cenimit të normave materiale (kundërshtim ose paligjshmëri e përmbajtjes së aktit juridik me akt më të lartë juridik). Sipas rregullit, ankesa e anulon plotfuqishmërinë dhe zbatueshmërinë e aktit juridike të miratuar në shkallë të parë, gjegjësisht ka veprim suspendues. Përjashtimet nga ky rregull i veprimit suspendues të ankesës janë të rralla dhe në parim janë të padëshiruara (rëndom në marrëdhëniet juridike financiare). Përmes ankesës, pala ka mundësi që lënda e zgjidhur në shkallë të parë sërish të shqyrtohet dhe të rivendoset në shkallë të dytë. Parimi i dyshkallshmërisë, që është i pranishëm në gjitha sistemet gjyqësore, domethënë se kundër çdo vendimi të miratuar nga organ gjyqësor ose administrativ në shkallë të parë, lejohet e drejta e ankesës në afat të caktuar dhe deri tek organi më i lartë. Në RM, e drejta e ankesës është *e drejtë personale e garantuar me kushtetutë*.

Ankesa i dorëzohet organit i cili e ka sjellë aktin në shkallë të parë, për ta përcjellë deri tek organi kompetent që vendos në shkallë të dytë. Organi i shkallës së parë është i obliguar që ankesën dhe dosjen (lëndën) e plotë t'ia dorëzojë organit që duhet të vendos në shkallë të dytë. Organi kompetent pas procedurës ankuese, nëse konstaton se vendimi i shkallës së parë është i paligjshëm, mund vetë të sjellë vendim të ri, ose me vërejtje konkrete t'ia kthen lëndën gjykatës së shkallës së parë që ajo vetë ta plotësojë të lëshuarën në procedurë dhe, sipas nevojës, të sjellë vendim të ri. Për organin i cili ka vendosur në shkallë të parë është i obligueshëm mendimi juridik i organit që vendos në shkallë të dytë. Nëse ky i fundit bindet në rrjedhshmërinë e drejtë të procedurës para gjykatës së shkallës së

parë dhe se vendimi i miratuar është ligjor, ankesa do të refuzohet si e pabazë.

Zbatueshmëria. Nën nocioni zbatueshmëri nënkuptojmë realizimin e të drejtave të krijuara dhe të parashikuara me marrëdhëniet juridike, edhe atë me ndërmjetësim të organit shtetëror. Të zbatueshme janë aktet e miratuara në procedurën civile, penale dhe administrative. Zbatueshmëria e aktgjykimit penal përbëhet nga ekzekutimi i dënimit. Bëhet fjalë për intervenim të atyre organeve shtetërore, pa ndihmën e të cilave aktgjykimet e tilla nuk mund të realizohen. Kusht për inicimin e procedurës zbatuese është i a.q. *titull zbatues* dhe ai sipas rregullit përputhet me aktin formal – të plotfuqishëm.

Veprimet zbatuese drejtohen vetëm në bazë të kërkesës. Nëse bëhet fjalë për kërkesë për dorëzim të lëndës, veprime përkatëse do të ndërmarrë organ i caktuar shtetëror (policia), veprime që përbëhen nga konfiskimi i detyrueshëm i pronës nga personi i paautorizuar dhe dorëzim tek ai ligjor dhe, me marrëdhënien juridike, bartës përkatës i atij autorizimi juridik. Nëse bëhet fjalë për kërkesë në para, nga pala e obligimit juridik detyrueshëm do të konfiskohet shuma e marrë deri në sasinë e borxhit; sipas nevojës në ankand publik detyrueshëm shitet pronë e caktuar dhe, në këtë bazë, shlyhet borxhi përkatës. Gjatë kësaj, çdoherë duhet të mbahet llogari që në procedurën zbatuese (ekzekutive) çdoherë të zgjidhen mjete të atilla, përmes të cilave bartësit të obligimit juridik do t'i shkaktohet minimumi i dëmit dhe njëkohësisht do të arrihet efekti i dëshiruar. Mjetet përfundimtare, për shembull, përdorim i detyrimit të ashpër fizik, do të zbatohen vetëm atëherë kur mjetet e deriatëhershme të detyrimit nuk rezultojnë me plotësim të obligimit juridik.




Figura 15



Figura 16




Figura 17

Pyetje:

1. Përkufizoni nocionin akt juridik!
2. Numëroni llojet e akteve juridik!
3. Çfarë janë burime materiale, e çfarë burime formale të së drejtës?
4. Çfarë është kushtetuta e oktrouar?
5. Çfarë kushtetute ka Anglia?
6. Përkufizoni ligjin në kuptimin material dhe formal?
7. Çfarë është vacatio legis?
8. Çfarë janë ligjet latente?
9. Çfarë janë akte nënligjore juridike dhe kush i miraton?
10. Çfarë akti paraqet rregullorja dhe numëroni llojet e saj?
11. Çfarë është urdhëresa?
12. Shpjegoni dallimin ndërmjet rregullores dhe udhëzimit?

13. *Cili është dallimi ndërmjet vendimit dhe statusit?*
14. *Çfarë është dekreti dhe çfarë përmban?*
15. *Çfarë nënkuptohet nën nocionin burime të së drejtës?*
16. *Çfarë janë aktet juridike individuale dhe tregoni një shembull të tillë?!*
17. *Si ndahen aktet individuale juridike sipas asaj kush i miraton?*
18. *Shpjegoni konceptet e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë!*
19. *Çfarë nënkuptohet nën nocionin fuqi juridike?*

KAPITULLI XI

Marrëdhëniet juridike

1. Marrëdhëniet juridike (nacioni)

Njerëzit ndërmjet tyre janë në relacione dhe marrëdhënie të vazhdueshme, si për shembull, blerje, shitje, martesë, regjistrim në fakultet, etj. Gjithashtu ndodhin edhe marrëdhënie negative, sikur përleshje, vrasje, vjedhje, fyerje, etj. Pjesa më e madhe e marrëdhënieve të ndryshme ndërmjet njerëzve janë rregulluar me norma juridike. Thuajse as nuk mund të kujtohem cilat marrëdhënie ndër-njerëzore nuk janë rregulluar me të drejtën, për shembull, disa relacione intime si miqësia, dashuria, etj.

Rrjedhimisht, marrëdhënien juridike mund ta përkufizojmë si marrëdhënie shoqërore që është rregulluar me normë juridike. Për shembull, për të blerë veturë duhet të futeni në marrëdhënie juridike, domethënë të ndiqni disa rregulla juridike, siç janë firmosje e marrëveshje, verifikim i marrëveshjes, tejkalim i veturës në emër të pronarit të ri, etj.

Shteti me rregullat juridike i rregullon marrëdhëniet shoqërore. Ato janë parashikuar, gjegjësisht janë përcaktuar dhe rregulluar para kohe. Rregullat për marrëdhëniet shoqërore janë të obligueshme për të gjithë.

Shteti me intensitet të ndryshëm i rregullon marrëdhëniet shoqërore. Disa marrëdhënie juridike janë rreptësisht të përcaktuara me rregulla juridike kategorike (për shembull, elementet e veprës penale vjedhje, si dhe dënimi i parashikuar për atë vepër janë

saktë të përcaktuar në Kodin penal). Marrëdhënie tjera juridike janë të rregulluara me norma dispozitive (për shembull, në Ligjin për marrëdhënie obligative është përcaktuar afat për kthimin e gjësendit të dhënë në shërbim, por palët kontraktuese lirisht mund të përcaktojnë edhe afat më të ndryshëm).

Shteti përmes aparatit të tij detyruet të reflektuar përmes gjyqësorit, ushtrisë, policisë, do të intervenojë në gjitha rastet kur subjektet e marrëdhënies juridike nuk i realizojnë obligimet e tyre, që nuk ndodh te marrëdhëniet tjera shoqërore.

2. Elementet e marrëdhënies juridike

Në marrëdhënien juridike ekzistojnë dy palë të cilat mund të jenë persona fizik ose juridik, të cilët quhen subjekte të së drejtës. Njëri subjekt është i autorizuar diçka të kërkon, të gëzon, të merr, ndërsa subjekti tjetër është i obliguar diçka të jep, të vuan, të kryej, të refuzojë, etj. Ndërmjet autorizimit dhe obligimit ekziston korrelacion, gjegjësisht çdo autorizim i një subjekti njëkohësisht paraqet obligim për subjektin tjetër. Nga aspekti juridik, në strukturën e marrëdhënies juridike esenciale janë dy elemente:

- autorizimi juridik (gjegjësisht e drejta) dhe
- detyrimi juridik (gjegjësisht obligimi).

3. Autorizimi juridik

Autorizimi juridik është elementi i parë i marrëdhënies juridike, që është sjellje e përcaktuar e subjektit të së drejtës që e drejta e mbron. Bartësi i detyrimit juridik në marrëdhënien juridike dhe gjithë të tjerët, janë të obliguar ta respektojnë këtë autorizim. Subjekti i detyrimit juridik, krahasuar me bartësin e autorizimit juridik, obligimin e tij mund ta plotësojë me sjellje aktiv ose me veprim, ose me sjellje pasive ose mosveprim, varësisht nga përmbajtja e autorizimit juridik.

Autorizimi juridik mund të paraqitet në dy lloje, edhe atë: si e drejtë subjektive dhe kompetencë.

Nën *të drejtë subjektive* nënkuptojmë autorizimin e subjektit të së drejtës ta mbrojë interesin e tij personal në bazë të normave të së drejtës objektive. Subjektit të autorizimit, norma e përgjithshme juridike (e drejtë objektive) i lejon diçka të veprojë (të punojë, të votojë, të shkollohet, të lëviz) ose diçka të posedojë.

Një nga ndarjet më të rëndësishme të së drejtave subjektive janë të a.q. të drejta absolute ose reale dhe relative ose obligative. Diferenca ndërmjet të drejtave reale dhe obligative më së mirë do të shpjegohet me shembuj. Si shembull për të drejtë reale ose absolute është posedimi i ndonjë gjësendi (tundshmëri ose patundshmëri). Për shembull, tundshmëri janë vetura, libri, biçikleta; ndërsa patundshmëri janë shtëpia, banesa, trualli, etj. Prej aty edhe rrjedh emërtimi e drejtë reale, sepse bëhet djalë për lidhje ndërmjet subjektit të së drejtës dhe gjësendeve reale. E drejta reale vepron ndaj të gjithëve (erga omnes), kjo do të thotë se gjithë të tjerët kanë obligim ta respektojnë këtë të drejtë të personit përkatës, andaj njihet edhe si e drejtë absolute.

Si shembull për të drejtën obligative ose relative është e drejta e kreditorit të kërkon nga debitori larje të borxhit. Kështu për shembull, gjatë shitjes së veturës, shitësi i veturës ka të drejtë nga blerësi të kërkon pagesën e shumës së kontraktuar për veturën e shitur. Kjo e drejtë i dedikohet vetëm numrit të caktuar të personave parapra kisht të njohur (ius in personam).

Kompetenca është autorizim juridik me të cilën subjekti i të drejtës mbron interes të huaj, e jo të vetin. Këtu mbrohet interesi i subjektit tjetër juridik. Kompetenca nuk është vetëm autorizim juridik, por është edhe detyrim juridik. Subjekti, interesi i të cilit mbrohet, mund të jetë:

- person fizik që vetvetiu nuk është në gjendje ta mbrojë dhe realizon të drejtën e tij subjektive, për ç'arsye ajo mbrojtje i dorëzohet subjektit të kompetencës;
- person juridik në emër të cilit subjekti i autorizimit vepron si person ose organ i tij zyrtar.

Subjekti i kompetencës është i obliguar të veprojë ashtu siç do të vepronte ai, interesin e të cilit e realizon, nëse do të ishte në gjendje të veprimt racional ose në gjendje vetë ta bëjë atë. Pasi personi interesat e të cilit mbrohen, rëndom për shkak të sëmundjes, miturisë, mungesës, nuk mund të kujdeset për veten dhe interesat e tij, e drejta i mundëson subjektit të kompetencës vetë të vihet në pozitën e personit të mbrojtur dhe realizimin e interesit me vullnet racional.

E drejta e mbrojtjes juridike (e drejta e padisë) përbëhet nga autorizimi i subjektit të së drejtës të kërkon intervenimin e organit shtetëror të detyrimit me fuqinë e tij, me qëllim subjektet tjera të cilat janë të obliguara diçka të veprojnë ose të vuajnë siç rezulton nga marrëdhënia juridike, e nuk e respektojnë, këtë ta realizojnë përmes rrugës detyruese.

Përmes së drejtës së padisë, si mjet të mbrojtjes juridike, qytetarët kërkojnë mbrojtjen e të drejtave të tyre kur këto janë cenuar për shkak të sjelljes së subjekteve tjera.

Keqpërdorim i autorizimit juridik (abusus). Autorizimi juridik nuk është i pakufizuar, dhe me sjelljen e tij bartësi i autorizimit mund edhe ta keqpërdorë. Siç përmendëm, autorizimi juridik mund të jetë e drejtë subjektive dhe kompetencë, rrjedhimisht mund të paraqiten dy lloje të keqpërdorimit të autorizimit juridik: *keqpërdorim i të drejtës subjektive dhe keqpërdorim i kompetencës*.

Keqpërdorimi i të drejtës subjektive. Për keqpërdorim të së drejtës subjektive bëhet fjalë atëherë kur gjatë shfrytëzimit të së drejtës subjektive, arrihet në gjendje të pamundësimi të plotë

ose të pjesërishëm të subjektit tjetër në shfrytëzimin e të drejtës së tij subjektive. Domethënë, edhe përskaj asaj që nuk bëjmë asgjë të ndaluar, të palejuar, por diçka të lejuar, ne mund të rrezikojmë të drejtë të huaj subjektive. Shembulli vijues flet për këtë situatë: një person në oborrin e tij ngrit mur në kufirin ndërmjet oborrit të tij dhe të fqinjit, me këtë e pengon dritën e cila duhet të futet përmes dritares së fqinjit. Këtu, shfrytëzimi i njërës e pengon realizimin e të drejtës subjektive të subjektit tjetër. Për këto arsye ekziston normë juridike e cila ndalon keqpërdorimin e të drejtës subjektive.

Organi i thirrur për pengimin e keqpërdorimit, në çdo rast konkret dhe me normë konkrete juridike është i obliguar të vlerësojë nëse ekziston ose jo keqpërdorim. Keqpërdorimi i të drejtës subjektive, në rast të konstatimit, domosdoshëm duhet të kufizohet, gjegjësisht të pengohet.

Nocioni *keqpërdorim i të drejtës subjektive* është i ngjashëm me nocionin *përgjegjësi për rrezik*. Por ato dallojnë. Për shembull, gjatë rrënimit të një gjysme nga shtëpia e përbashkët, i shkaktohet dëm pronarit të gjysmës tjetër, të cilin dëmtuesi ia kompenson të dëmtuarit. Te përgjegjësia për rrezik kemi rast të tillë, kur me kryerje të plotë të së drejtës personale, tjetrit i shkaktohet dëm i cili paraprakisht është llogaritur dhe i cili tërësisht kompensohet. Dëmi i paraqitur te përgjegjësia për rrezik kompensohet dhe e drejta këtu nuk mund të kufizohet.

Keqpërdorim i kompetencës. Keqpërdorimi i kompetencës ekziston kur subjekti i kompetencës, me shfrytëzim të autorizimit të tij, në mënyrë të plotë ose të pjesërishme, e pamundëson realizimin e të drejtës subjektive të ndonjë subjekti tjetër. Mirëpo, ekziston edhe një mënyrë për krijimin e keqpërdorimit të kompetencës, e që nuk takohet te keqpërdorimi i të drejtës subjektive. Gjegjësisht, siç tashmë potencuam, përmes kompetencës, subjekti i kompetencës nuk mbron interes të tij, por interes të huaj, të ndonjë subjekti tjetër. Nëse subjekti i kompetencës nuk e kryen autorizimin e tij në interes

të subjektit të së drejtës subjektive, gjegjësisht nuk do të vepronte ashtu siç do të vepronte subjekti i përfaqësuar, nën supozimin për veprim racional, atëherë ai kryhen keqpërdorim të kompetencës.

4. Detyrimi juridik (obligimi, detyra)

Obligimi juridik është elementi i dytë esencial në strukturën e marrëdhënies juridike. Ai është gjendje kur subjekti i të drejtës në marrëdhënie përkatëse juridike, në bazë të dispozitave juridike, është i obliguar diçka të vuan, të jep ose të veprojë në interes të subjektit tjetër juridik.

Obligimi mund të përbëhet nga

- veprim i caktuar (sjellje aktive), ose
- mosveprim i caktuar (sjellje pasive, vuajtje).

Çdo mosplotësim i detyrimit ose obligimit juridik është i ndëshkueshëm.

Interesante është çështja për bartjen e autorizimeve dhe detyrimeve. Të bartura janë edhe autorizimet dhe obligimet me karakter imperativ. Për shembull, e drejta e pronës dhe obligimi për pagesë së borxhit mund të barten gjatë jetës ose pas vdekjes së personit fizik, gjegjësisht pas likuidimit të personit juridik. Autorizimet juridike, gjegjësisht detyrimet juridike, të cilat janë fortë të ndërlidhura për veçoritë personale të subjektit të tyre, nuk janë të bartura. Të tilla janë, për shembull, e drejta e votës, e drejta e bashkëshortit, e prindërve, ose obligimi për kryerje të shërbimit ushtarak, përpunimi i gjësendit ose veprës përkatëse artistike nga mjeshtër ose artist paraprakisht të njohur, etj.

5. Paraqitja, ndryshimi dhe ndërprerja e marrëdhënieve juridike

Paraqitja të marrëdhënies juridike kemi në momentin kur një normë juridike i obligon subjektet e të drejtës në sjellje përkatëse,

gjegjesisht u imponon sjellje normative. Ndryshe, marrëdhënia juridike ndërpritet në momentin kur për subjektet e të drejtës ndërpritet veprimi i obligimit të tillë juridik.

Ndryshim të marrëdhënies juridike ka kur obligimi nuk ndërpritet, por transformohet në një tjetër. Ndryshimi i marrëdhënies juridike e ka kuptimin e ndërprerjes së njëres dhe paraqitjen në të njëjtën kohë të marrëdhënies tjetër juridike. Domethënë, bëhet fjalë për raport të arsyes dhe pasojës, me ç'rast arsye është raporti ekzistues, ndërsa pasojë ai i porsakrijuar. Kështu për shembull, kur një subjekt, në bazë të borxhit ekzistues, obligohet ta paguajë interesin në vend të pjesës kryesore, ashtu siç eventualisht është arritur marrëveshje, në rast të këtillë paraqitet marrëdhënie e re juridike përmes së cilës shprehet obligim i ri juridik, gjegjesisht pagesë e interesit i cili drejtpërdrejtë buron nga obligimi paraprak: pagesë e rregullt e borxhit themelor. Pasi ekzistojnë norma juridike të kushtëzuara dhe të pakushtëzuara, edhe paraqitja e marrëdhënies juridike mund të jetë e ndryshme: marrëdhënie juridike të kushtëzuara dhe të pakushtëzuara. Gjatë ekzistimit të normës së kushtëzuar juridike, marrëdhënia juridike paraqitet vetëm me plotësim të kushtit. Për shembull, nëse norma thotë se qytetari i cili posedon pronë obligohet të paguaj tatim, ose nëse me normën kërkohet mbushja e 18 vjetëve për shërbim ushtarak, marrëdhënia juridike do të krijohet me plotësimin e kushteve të përshkruara – përfitim i pronës së caktuar, gjegjesisht mbushje e 18 vjetëve.

Në bazë të normës së pakushtëzuar, marrëdhënia juridike paraqitet drejtpërdrejtë nga norma e pakushtëzuar juridike e cila, nga ana tjetër, mund të jetë abstrakte ose konkrete. Për shembull, norma kushtetuese-juridike për lirinë e lëvizjes (normë abstrakte juridike) nuk ka kurrfarë kushti dhe drejtpërdrejtë mbi bazë të saj paraqiten marrëdhënie juridike.

6. Gjendjet juridike ose statusi juridik

Gjendja juridike është përmbledhje e autorizimeve dhe detyrimeve juridike me të cilat, si tërësi, në kohë të caktuar disponon dhe ngarkohet subjekti i marrëdhënies juridike. Gjendja juridike është në fakt pozita statusore e subjekteve të së drejtës. Shembull për pozitë të tillë statusore është prindi, trashëgimtari, bashkëshorti, kujdestari, studenti, blerësit, shitësi, deputeti, etj.

Në të drejtën, gjendjet juridike janë të shumëllojshme. Në gjendje juridike hynë edhe mundësia e fitimit të disa autorizimeve dhe detyrimeve të reja, përkaj atyre ekzistuese, që rezultojnë nga gjendja përkatëse juridike; për shembull, gruaja të përfiton edhe statusin e nënës, ose qytetari me të drejtë pasive të votës të zgjidhet për deputet, kryetar shteti, ministër, etj.

7. Objekti i marrëdhënies juridik

Gjësendet nga bota e jashtme materiale (truall, veturë, piano, anije, godinë, etj.) ose ndonjë veprim ose cilësi njerëzore (këndim, qepje, ngjyrosje, etj.) në lidhje me cilat krijohet marrëdhënia juridike, paraqesin objekte të marrëdhënies juridike. Objekt i marrëdhënies juridike nuk është rreptësisht gjësendi material, por mund të jenë edhe gjësende jomateriale. Të mirat jomateriale (edukim i fëmijëve – marrëdhënia ligjërishit e rregulluar ndërmjet prindërve dhe fëmijëve; raporti ndërmjet mësuesit dhe nxënësit – raport arsimor).

Objekti i marrëdhënies juridike është arsyeja për të cilën subjektet e të drejtës janë në marrëdhënie të caktuar juridike. Nuk ka marrëdhënie juridike pa objekt. Objekti i marrëdhënies juridike është qëllim konkret praktik për të cilin ajo marrëdhënie ekziston dhe konstituohet. Objekti është “ratio” e marrëdhënies juridike, arsyeja për të cilën vullnetet njerëzore takohen.

Objektet e të drejtës janë arsyeja për harmonizimin e vullneteve të palëve në marrëdhënien juridike. Objektet e të drejtës

janë vlera të përcaktuara shoqërore, pasi në to është inkorporuar mund njerëzor. Te shitblerja e veturës, blerësi është i interesuar për veturën, ndërsa shitësi për paratë. Ata takohen: a) në treg, b) shkëmbejnë vlerat e disponuara dhe c) kështu i realizojnë interesat e tyre. Ky proces afarist realizohet përmes veprave juridike.

Objekti i marrëdhënies juridike mund të paraqitet në më tepër lloje të tij. Kryesisht ekzistojnë pesë grupet vijuese të marrëdhënies juridike:

- gjësendet fizike (pasuritë xeherore, llojet e ndryshme të energjisë, frutat për ushqim, etj.) janë objekti më i shpeshtë i marrëdhënies juridike. Statusi i gjësendit fizik në komunikacionin juridik drejtpërdrejtë buron nga veçoritë e tija specifike dhe vlera e tij përdorëse.
- veprimi njerëzor është aktivitet i caktuar njerëzor (vojitje e veturës, gropim i bunarit, ngjyrosje) – këtu njëra palë e kërkon aktivitetin, ndërsa tjetra e jep me kompensim të caktuar;
- mosveprimi njerëzor (përmbajtje, vuajtje) – këtu insistohet që subjekti të anulon ose përmbahet nga veprimi që në raste normale rregullisht e realizon;
- virtyt njerëzor (nder, dinjitet, imazh, dukje) – këtu rëndom bëhet fjalë për mbrojtje juridike të këtyre virtyteve;
- veçori specifike njerëzore subjektive (aftësi intelektuale dhe autoriale njerëzore) – këtu bëhet fjalë për mbrojtje të së drejtës autoriale, patentuese dhe të licencuar.


8. Faktet juridike

Paraqitja, ndryshimi dhe ndërprerja e marrëdhënies juridike, varet nga paraqitja, ndryshimi ose zhdukja e fakteve juridike relevante. Marrëdhëniet juridike janë në varshmëri të drejtpërdrejtë nga faktet juridike. Parashtrohet pyetja, çfarë janë faktet juridike? Ato

janë ngjarje natyrore (tërmet, vërshim, epidemi, zjarr, etj.) dhe veprime njerëzore (vjedhje, vrasje, mashtrime, fshehje e tatimit, vozitje e shpejtë) në jetën e njerëzve të cilat janë parashikuar me të drejtën objektive dhe nën veprimin direkt të cilave paraqiten, ndërpriten ose ndryshojnë marrëdhëniet juridike.

Ngjarjet juridike paraqiten pavarësisht nga njeriu. Njeriu nuk mund me vetëdijen, vullnetin, diturinë dhe fuqinë e tij të ndikon mbi këto ngjarje. Ato janë natyrisht të determinuara. Ngjarje të tilla janë: lindja, vdekja, sëmundja shpirtërore ose trupore, tërmeti, vërshima, zjarri që nuk është shkaktuar nga njeriu, ndryshimi natyror i rrjedhës së lumit, etj.

Veprime njerëzore janë veprimet trupore ose psikike të shkaktuara nga njeriu në bazë të vetëdijes së shëndoshë dhe vullnetit të zgjuar. Veprime të tilla, për shembull, janë: ndërtimi i shtëpisë, gropimi i bunarit, sjellja e aktit të përgjithshëm juridik ose firmosja e marrëveshjes për shitblerje, si dhe veprime tjera psikike të njeriut – mendim, ndjenjë, etj. Ndaj kësaj ndarjeje shtohet edhe faktori kohë, gjegjësisht parashkrimi dhe mirëmbajtja.

**Figura 18****Pyetje:**

1. Përkufizoni nocionin marrëdhënie juridike?
2. Cilat janë elementet e marrëdhënies juridike?
3. Shpjegoni dallimin ndërmjet autorizimit juridik dhe detyrimit juridik!
4. Çka është objekt i marrëdhënies juridike?
5. Çfarë janë faktet juridike?

KAPITULLI XII

Subjektet e të drejtës

1. Nocioni për subjektet e të drejtës

Marrëdhëniet juridike mund të ekzistojnë vetëm ndërmjet njerëzve. Njerëzit paraqiten si individ ose persona fizik, mirëpo individët gjithashtu bashkohen me qëllim të realizimit të qëllimeve përkatëse, duke formuar asociacione, shoqata. Në fakt, njerëzit por edhe shoqatat e tyre janë subjekte të së drejtës. Në teorinë e të drejtës, subjekti i të drejtës përcaktohet në mënyrën vijuese: subjekti i të drejtës është person, i përcaktuar në mënyrë individuale ose kolektive, që në bazë të dispozitave të së drejtës pozitive (objektive) futet në marrëdhënie juridike me person tjetër në kuadër të autorizimeve dhe detyrimeve të tija juridike.

Subjekti i të drejtës nënkuptohet çdo person të cilin e drejta diçka e autorizon ose e obligon, pa marrë parasysh nëse personi i tillë disponon vetëdije dhe vullnet. Kur personi nuk ka vetëdije dhe vullnet (p.sh. person i mitur ose mentalisht i sëmurë) për realizim të pandërprerë të autorizimeve dhe detyrimeve juridike, këtij personi i jepet mundësia për angazhim të përfaqësuesit.

2. Personi fizik dhe juridik

Në të drejtën ekzistojnë dy lloje të subjekteve: person fizik dhe person juridik. Në rastin e parë kemi punë me njeriun si individ, ndërsa në të dytin me më tepër njerëz të cilët përmes bashkimit mund të realizojnë dobi të caktuar.

Person fizik është çdo qenie njerëzore të cilës e drejta i pranon mundësinë e të qenurit bartës i autorizimeve dhe detyrimeve juridike. Njeriu me lindjen, në mënyrë automatike në të drejtën e merr atributin e personit fizik. Në mënyrë që personi fizik të ekzistojë si subjekt i të drejtës, qenia duhet: a) të jetë lindur e gjallë dhe b) të ketë formë njerëzore.

Lindja është ngjarje biologjike dhe në kuptim më të gjerë sociologjik është vetëm supozim i domosdoshëm për paraqitjen e cilësisë – njeri. Normalisht që i porsalinduri nuk mund menjëherë të merr pjesë në komunikacionin juridik. Për shembull, të gjithë e dimë se deri në moshën 18 vjeçare sipas së drejtës në shtetin tonë, ne jemi të mitur. Gjegjësisht, deri në moshën 18 vjeçare sipas së drejtës gëzojmë më tepër të drejta, e më pak obligime, domethënë kemi vetëm aftësi juridike, e ende jo të punës. Rrjedhimisht, flasim për dy lloje të aftësisë së personit fizik: aftësi juridike dhe afariste.

Aftësia juridike e personit fizik është aftësia që si subjekt i të drejtës të jetë bartës i autorizimeve juridike. Personi fizik me aftësinë juridike mund të jetë trashëgimtar ose të pranojë dhurata dhe nuk mund të jetë bartës i obligimeve, domethënë autorizimi juridik (ose e drejta) është karakteristikë (atribut) i personit fizik me aftësi juridike. Personi fizik me aftësi juridike nuk mund të jetë pjesëmarrës në komunikacionin juridik, sepse nuk disponon vullnet të shëndoshë dhe vetëdije të ngritur.

Nga ky rregull përjashtim bën instituti juridik – fiksim juridik. Fiksimi juridik është gjendje e atillë në të drejtën kur diçka e pavërtetë, e pasaktë ose joekzistuese llogaritet si e vërtetë, e saktë ose

ekzistuese. Shembull për këtë është kur fëmija i fekonduar (nasciturus) supozohet se është i gjallë në brendinë e nënës dhe në bazë të këtij supozimi (i cili nuk është patjetër të realizohet, gjegjësisht se fëmija do të lindet i gjallë dhe në formë njerëzore), fëmijës së palindur i pranohet aftësia juridike dhe e drejta mund t'i garantojë autorizime të caktuara juridike, për shembull, të drejtën e trashëgimisë. Përveç përfitimit të aftësisë juridike para lindjes, në teorinë është i njohur edhe vazhdimi i aftësisë juridike edhe pas vdekjes. Shembull është testamenti, gjegjësisht thuhet se me vetë pranimin e vullnetit të shprehur të vdekurit, vazhdon aftësia e tij juridike.

Aftësia afariste (e punës) e personit fizik nënkupton aftësinë e personit fizik që si subjekt i të drejtës të mund vetvetiu, me veprime personale, të merr pjesë në mënyrë aktive në komunikacionin juridik, të krijoj, ndryshon ose abrogon marrëdhënie juridike. Moshë me të cilën përfitohet aftësia juridike është e ndryshme në shtete të ndryshme (në RM përfitohet me 18 vjet, në SHBA me 21 vjet).

Te përfitimi i aftësisë juridike gjithashtu kemi dy përjashtime:

- në rastin e parë, e drejta e përcakton më lartë kufirin e parashikuar prej 18 vjetëve, ndërsa
- në rastin e dytë, ky kufi në moshë zhvendoset mbrapa.

Në rastin e parë bëhet fjalë për institutin emancipim ose njohje e aftësisë së kufizuar afariste. Emancipimi është përfitim i aftësisë afariste të personit fizik edhe para mbushjes së minimumit ligjor të parashikuar të moshës për përfitim të aftësisë juridike. Si shembull për emancipim rëndom përmendet hyrja në martesë e personit të mitur. Personi i mitur i cili vendos të hyj në martesë në bazë të certifikatës mjekësore për gjendjen e tij shëndetësore dhe me leje speciale të kujdestarit (prindërve ose organit të kujdestarisë), bëhet person i aftë afarist dhe mund të hyj në martesë, gjegjësisht mund t'i bartë obligimet nga bashkësia martesore.

Mundësia për përfitim të aftësisë së kufizuar afariste është e shkallëzuar sipas moshës së personave. Aftësi afariste në asnjë rast nuk mund të kenë personat të cilët ende nuk kanë mbushur dhjetë vite. Personat me moshë prej 10 deri 14 vjet në të drejtën llogariten si fëmijë; personat nga 14 deri 16 vjet llogariten të mitur më të ri, ndërsa nga 16 deri 18 vjet për të mitur më të vjetër. Varësisht nga kategoria të cilës i përket i mituri, do të varet edhe volumi dhe cilësia e obligimeve dhe detyrimeve me të cilat mund personalisht të disponon.

Në rastin e dytë bëhet fjalë për përfitim të vonshëm të aftësisë afariste, gjegjësisht pamundësisë që person i caktuar të përfiton aftësinë juridike me 18 vjet (që është kufiri i moshës në RM). Rëndom kjo ndodh me personat mentalisht të sëmurë. Këta persona nuk mund të përfitojnë aftësi afariste derisa zgjat sëmundja ose derisa ndjehen pasojat nga ajo. Gjithashtu, për shkak të arsyeve të caktuara, ekziston mundësi që aftësia tashmë e fituar afariste përkohësisht ose përherë të humbet dhe mundësia për kthimin e saj. Aftësia juridike, ngjashëm sikur ajo juridike, përhershëm humbet me vdekjen.

Për të drejtat dhe obligimet e personit të paaftë juridik kujdeset kujdestari i tij. Kujdestari mund të paraqitet si kujdestar ligjor (kujdestar i personit të paaftë afarist) dhe si kujdestar juridik (organ i kujdestarisë i përcaktuar nga organ kompetent shtetëror). Kujdestari, përveç për kurimin dhe edukimin e personit të paaftë afarist, është i obliguar të kujdeset për realizimin e drejtë të të drejtave të tij.

Personi juridik është përmbledhje e më tepër personave fizik të cilët janë bashkuar në bazë të dispozitave juridike, me qëllim të arritjes së ndonjë qëllimi të përbashkët. Me vetë krijimin (me aktin për miratimin e veprimtarisë), personi juridik njëkohësisht përfiton edhe aftësi juridike, delikte dhe procesore-juridike. Personi juridik nuk është identik me subjektivitetin e anëtarësisë së tij, gjegjësisht ai është përmbledhje e thjeshtë e anëtarëve, por krijesë tërësisht e re shoqërore me subjektivitet të ri juridik.

Për çdo bashkim konkret vendos shteti, gjegjësisht organ kompetent shtetëror. Rrjedhimisht, çdo qëllim bashkërisht i përcaktuar i personave fizik për themelimin të personit juridik nuk pranohet edhe nuk është i pranueshëm për shtetin i cili edhe në këtë plan e ka fjalën kryesore. Kur shteti jep leje për konstituimin e personit juridik, domosdoshëm udhëhiqet nga arsytimi i atij interesi për realizimin e qëllimeve të caktuara të personave të bashkuar fizik dhe pamundësia që interesi i tillë të realizohet në mënyrë individuale. Njëkohësisht, shteti mban llogari në ç'mënyrë realizimi i atij interesi do të reflektohet mbi qëndrueshmërinë e rendit juridik.

Për themelimin e një personi juridik domosdoshëm nevojitet ekzistimi i kushteve vijuese: qëllim, anëtarësi, organe, mjete, statut, unitet dhe identitet. Qëllimi i një organizate ka karakter vendimtar nëse organet shtetërore do të lejojnë themelimin e saj ose do ta konsiderojë të palejuar, për ç'arsye edhe nuk do ta aprovojë themelimin e saj (parti politike, organizatë prodhuese ose ent shëndetësor). Anëtarësia ose kolektivi është i domosdoshëm që organizata të vihet në lëvizje. Mjetet, gjegjësisht lloji dhe cilësia e mjeteve të nevojshme është në lidhje më të ngushtë me qëllimin e personit juridik. Për shembull, një organizate prodhuese do t'i nevojiten mjete tërësisht të ndryshme sesa ndonjë enti, gjegjësisht fakulteti ose spitali. Organet paraqesin grup të veçuar, të cilat udhëheqin dhe përfaqësojnë personin juridik. Personi juridik duhet të disponon statusin e tij. Për përfitimin e aftësisë juridike të personit juridik, nevojitet që statusi paraprakisht të miratohet nga ana e organit përkatës shtetëror.

Personi juridik, pavarësisht pjesëve të tij (anëtarësi dhe organe), paraqet tërësi të veçantë që nuk përputhet dhe nuk mund të barazohet me përmbledhjen e thjeshtë të anëtarësisë së tij. Në komunikacionin juridik, personat juridik paraqiten vetëm për arsye se, juridikisht thënë, janë inpersonale.

Theksuam se personi juridik nuk është përmbledhje e thjeshtë e anëtarësisë së tij. Ai ka subjektivitet të veçantë juridik, andaj në

mënyrë analoge personat juridik nuk mund të lidhen për persona të caktuar. Personat juridik e ndërlidhin ekzistimin e tyre për dispozitat ekzistuese juridike. Anëtarësia ndryshohet, ndërsa personi juridik edhe më tutje ka vazhdimësi juridike dhe identitetin e tij. Rezulton se personi juridik, përveç që është inpersonal, njëkohësisht është edhe transpersonal.

Përfaqësues është person i aftë afarist që në emër të personit fizik të paaftë afarist dhe në emër të personit juridik kryhen veprime juridike.

Persona të paaftë afarist janë personat e mitur, personat e privuar nga aftësia afariste për shkak të sëmundjes dhe çrregullimeve tjera dhe persona që mungojnë, të cilët nuk janë në gjendje të kryejnë veprime juridike. Këta persona nuk mund të firmosin veprime juridike. Që të plotësohet nevoja në mënyrë që këta njerëz të jenë pjesëmarrës në komunikacionin juridik, e drejta gjen zgjidhje të përshtatshme me konstituimin e institutit përfaqësues. Kjo do të thotë se gjitha pasojat juridike nga vepra përkatëse juridike, e firmosur nga përfaqësuesi, bien në barrë të personit të përfaqësuar, e jo përfaqësuesit. Përfaqësues mund të ketë edhe person i aftë afarist dhe i pranishëm, kur këtë vetë do ta kërkojë dhe me vullnet të shprehur me shkrim do t'i caktojë vetes përfaqësues (avokat).

Përfaqësuesi sipas rregullohet përcaktohet me ligj, për shembull, prindi është përfaqësues ligjor i fëmijëve të tij të mitur, kujdestari është përfaqësues i personi të sëmurë mental, drejtori është përfaqësues i ndërmarrjes, etj. Në situatë të caktuar mund të përcaktohet edhe autorizues dhe atëherë përfaqësuesi ligjor me autorizim autorizon person tjetër të aftë afarist për përfaqësim.

Llojet e personave juridik. Ndarja themelore e personave juridik është: persona juridik të së drejtës publike dhe persona juridik të së drejtës private. Personat juridik të së drejtës publike kanë karakter shtetëror-juridik, gjegjësisht formimi i tyre është rezultat i sovranitetit shtetëror. Sovraniteti shtetëror shprehet me faktin që vetëm shteti

posedon pushtet publik, gjegjësisht të drejtë që në mënyrë detyruese, përmes normave të së drejtës pozitive, t'i rregullojë marrëdhëniet shoqërore. Persona juridik të së drejtës publike janë ministritë si organe më të larta administrative, si dhe trupat dhe agjencitë e pa-varura shtetërore rregulluese (Komisioni për letra me vlerë, Agjencia për komunikime elektronike, Këshilli për radio-difuzion, etj.).

Personat juridik të së drejtës private kanë karakter joshtetëror dhe formohen mbi normat e të drejtës pozitive, por nuk posedojnë pushtet publik. Të tillë janë shoqatat tregtare (T-Mobile, Birraria e Shkupit, etj.), shoqatat e qytetarëve (Shoqata e pensionistëve, Shoqata e alpinistëve, etj.) dhe fondacionet. Megjithatë, ndarja e personave juridik nga e drejta publike dhe private është kontestuese në shkencën bashkëkohore juridike. Gjegjësisht, edhe vetë ndarja në të drejtë publike dhe private është temë e debateve shkencore, duke marrë parasysh se degë të tëra juridike, si për shembull, e drejta e punës, bien njëkohësisht edhe në të drejtën publike edhe në atë private. Njëkohësisht edhe në degët tradicionale të së drejtës private, sikur e drejta familjare, e drejta trashëguuese, e drejta obligative, shteti e kufizon vullnetin e lirë (autonominë) e subjekteve.

Ndarje tjetër e personave juridik është në komerciale dhe jokomerciale, gjegjësisht fitimprurëse dhe jofitimprurëse. Personat juridik komercial (fitimprurës) formohen me qëllim të arritjes së fitimit (profitit). Shembull tipik për këtë janë shoqatat tregtare (kompanitë) të cilat punojnë për përfitime. Persona juridik jokomercial (jofitimprurës) janë ato që parimisht formohen për realizim të ndonjë interesi publik ose interesi të grupit të caktuar të njerëzve, por qëllimi esencial i të cilëve nuk është përfitimi. Të tillë janë, për shembull, entet publike (biblioteka qytetare "Vëllezërit Milladinovci" nga Shkupi) ose shoqatat e lartpërmendura të qytetarëve dhe fondacionet.

Shkenca juridike njih edhe ndarje të personave juridik të cilët paraqesin përmbledhje të personave (universitas personam) dhe persona juridik të cilët paraqesin përmbledhje të gjësendeve

(universitas rerum). Shembull tipik për përmbledhje të personave janë shoqatat e qytetarëve, ndërsa përmbledhje të gjësendeve janë fondacionet. Megjithatë, edhe kjo ndarje shkakton debate, sepse persona të caktuar juridik, si për shembull, shoqatat tregtare, janë njëkohësisht edhe përmbledhje e personave, edhe përmbledhje e gjësendeve (njerëz dhe kapital). Gjithashtu, ekzistimi i anëtarësisë dhe pronës së personave juridik janë elemente esenciale për ekzistimin e cilitdo person juridik.




Figura 19

3. Modalitetet juridike (nocioni)

Dispozitat sekondare në aktet individuale juridike, nga plotësimi ose mosplotësimi i të cilave varet fati i akteve individuale juridike, quhen modalitete juridike.

Në të drejtën ekziston mundësi që përmes dispozitave sekondare ose modifikimeve plotësuese të ndryshohet edhe dispozita kryesore, esenca e marrëdhënieve të caktuara juridike. Për shembull, prindërit arrijnë marrëveshje për kujdes të përjetshëm, ku shprehin vullnetin e tyre që pronën pas vdekjes t'ia lënë njërit prej tre fëmijë-

ve, me kusht që ai fëmijë të kujdeset për ta deri në vdekjen e tyre. Nga ky kusht varet realizimi ose mosrealizimi i marrëveshjes. Kushti në këtë rast quhet modalitet juridik.

Modalitetet juridike rëndom i takojmë në të drejtën civile, sidomos në atë obligative, në çështjet private-juridike ndërmjet njerëzve dhe në marrëdhëniet afariste ndërmjet subjekteve juridike, por ato nuk janë të panjohura edhe gjatë sjelljes së akteve individuale juridike të organeve publike, gjegjësisht shtetërore.

Modalitetet juridike paraqiten si kusht, afat dhe urdhëresë.

Kushti si dispozitë sekondare juridike shënon gjendje të ardhme, të pasigurt, por të supozuar, kërkesë në të cilën insiston njëra nga palët kontraktuese, me çka edhe e kushtëzon realizimin e aktit juridik. Për shembull, blerës i caktuar e pranon çmimin e shitësit të veturës së dorës së dytë, vetëm me garanci se me të do të kalojë 10.000 km pa asnjë defekt. Ekzistojnë dy lloje të kushteve: kusht i anuluar dhe i ndërprerë.

Afati paraqet dispozitë sekondare që është e ndërlidhur me rrjedhën e kohës së saktë, si rezultat i së cilit realizohet ose anulohet akti juridik. Afati si modalitet juridik, ngjashëm sikur kushti, mund të paraqitet sikur: i anuluar dhe i ndërprerë. Tek afati i anuluar, për kohë saktë të përcaktuar në të ardhmen anulohet fillimi i veprimit të marrëdhënies juridike. Afati i ndërprerë sugjeron se me paraqitjen e tij pushon së ekzistuari marrëdhënia ekzistuese juridike.

Urdhëresa paraqet bartje të autorizimeve të veçanta juridike nga një te subjekti tjetër juridik, si pasojë e asaj që urdhërpranuesi ka pranuar, në dobi ose me dëshirë të urdhërdhënësit, në një periudhë të ardhme kohore ta realizojë dëshirën ose interesin e tij.

Urdhëresë ka në marrëveshjen për mirëmbajtje të përhjetshme, dispozitë kryesore në marrëveshje. Me këtë, urdhërdhënësi tërë pronën e tij pas vdekjes ia vë në dispozicion mirëmbajtësit. Qëllimisht morëm shembull të këtillë, edhe pse urdhëresa si modalitet

specifik juridik mund të paraqitet edhe me modifikime të shumta tjera specifike. Me rëndësi është të rikujtohet se derisa zgjat urdhëresa, në çdo moment, si rezultat i paraqitjes së arsyeve të veçanta juridike, njëra nga palët kontraktuese mund të kërkon abrogimin e saj.




Figura 20

Pyetje:

1. Çfarë janë subjektet e të drejtës?
2. Cili është dallimi ndërmjet agjentit juridik – përfaqësuesit dhe institutit kompetencë?
3. Çfarë është personi juridik?
4. Bëni dallimin ndërmjet aftësisë juridike dhe afariste!
5. Çfarë është fiksimi juridik?
6. Kur personat juridik përfitojnë aftësi afariste?

PËRKUJTUESI

A

Aftësi afariste, aftësi e personit fizik si subjekt i të drejtës, të mund në mënyrë të pavarur dhe me veprime personale të krijoj marrëdhënie juridike, t'i ndryshojë dhe abrogon të njëjtat;

Aftësi juridike, mundësi e çdo personi për të qenë subjekt i të drejtave dhe obligimeve;

Akt juridik, mjet për krijimin dhe zbatimin e të drejtës;

Apatrid, person pa nënshtetësi;

Autorizim, vullnet i shprehur me shkrim i një subjekti që autorizon subjekt tjetër që në emër të tij dhe në llogari të tij të ndërmarrë të drejta dhe obligime në qarkullimin juridik;

B

Bipatrid, person me nënshtetësi të dyfishtë;

D

Demokraci e drejtpërdrejtë, formë e regjimit politik ku vetë populli vendos për çështjet përkatëse;

Demokraci, sundim i popullit që bazohet në sistematizim të caktuar institucional (ndarje e pushtetit), forma racionale teknike të sundimit (parti politike, zgjedhje) dhe vlera të caktuara shoqërore;

Dispozicion, pjesë përbërëse e normës juridike dhe urdhëresë për sjelljen e njerëzve;

E

Eksterritorialitet, e drejta e një shteti të ketë territor në shtet tjetër, ku do të zbatohet edhe e drejta e atij shteti;

Emancipim, përfitim i aftësisë afariste para mbushjes së 18 vjetëve;

F

Fiksim juridik, situatë në të drejtën kur diçka e pasaktë dhe e pavërtetë konsiderohet e saktë dhe e vërtetë;

Fuqi juridike, ndikim i një akti juridik mbi një tjetër;

K

Karakteristika të shtetit, pjesë nga të cilat përbëhet shteti;

Konfederatë, aleancë e lirë e shteteve;

Kuorum, numër minimal i trupit kolektiv që duhet të merr pjesë në punën e tij dhe që duhet të deklarohet për miratimin e ndonjë vendimi;

L

Ligj, akt i përgjithshëm juridik me të cilin garantohet e drejta e qytetarëve ose u urdhërohet të veprojnë në mënyra të caktuara;

Ligjshmëri, harmonizim me ligjin;

M

Marrëdhënie juridike, marrëdhënie shoqërore e rregulluar me normë juridike;

Metodë, mënyrë në të cilën studiohet lënda e një shkence, rrugë ose përmbledhje e procedurave dhe mjeteve, me çka mundësohet fitimi i të dhënave për qëllim të caktuar;

Modalitet juridik, dispozitë sekondare që ekziston në akt individual juridik;

Monarki, formë e sundimit ku shefi i shtetit vjen në pushtet përmes rrugës trashëguese;

Moral, rregull e pashkruar për sjelljen e njerëzve, me të cilin gjykohet çfarë është mirë e çfarë keq;

N

Nënshtetësi, marrëdhënie juridike ndërmjet shtetit dhe individit – anëtarë të bashkësisë përkatëse shtetërore, prej ku burojnë të drejta dhe obligime, si për shtetin ashtu edhe për individin;

Normë juridike, rregull i shkruar nga shteti;

O

Organ shtetëror, element themelor i aparatit shtetëror, që disponon ligj dhe i cili ka autorizime dhe drejtime përkatëse;

P

Përfaqësim, ndërmarrje e të drejtave dhe obligimeve në emër dhe llogari të personit tjetër;

Person juridik, përmbledhje e personave fizik që janë bashkuar në bazë të dispozitave juridike për arritjen e një qëllimi të përbashkët;

Polipatrid, person me më tepër se dy nënshtetësi;

Popullatë, karakteristikë e shtetit që i përfshin njerëzit të cilët jetojnë në territor të përcaktuar shtetëror;

Pushtet, marrëdhënie juridike ndërmjet dy subjekteve, nga të cilat njëri posedon të drejtën e urdhërimit, ndërsa tjetri të dëgjon dhe t'i zbatojë urdhrat;

R

Rend juridik, rend i organizuar i marrëdhënieve shoqërore të rregulluara me normë juridike;

Rr

Rregullim shtetëror, mënyrë e rregullimit të marrëdhënieve ndërmjet organeve qendrore dhe lokale të pushtetit në shtet;

S

Sistem politik, mënyrë e organizimit të pushtetit më të lartë në shtet;

Sh

Shoqëri, bashkësi e organizuar e njerëzve ku krijohen marrëdhënie nga më të ndryshmet;

Shtet, institucion shoqëror-politik që disponon aparat të detyrimit fizik;

Shtetas, individ (subjekt) në gërshetim specifik të të drejtave dhe obligimeve me shtetin përkatës;

Z

Zakon, rregull e pashkruar që krijohet me përsëritje të përditshme të një sjelljeje të caktuar;

Zbatueshmëri, hyrje në fuqi e aktit juridik dhe subjektet janë të obliguar të sillen sipas tij;

LITERATURA E SHFRYTËZUAR:

Балаџиџев Димитар, *Вовед во ѓравоиџо: ѓраво*, Македонска Ризница, Куманово 1999;

Балаџиџев Димитар, *Вовед во ѓравоиџо: гржава*, Графос, Куманово, 2006;

Чокревски Томислав, *Социолоџија на ѓравоиџо*, Правен факултет, „Јустинијан Први“, Скопје 2007;

Пеливанов Тодор, *Меџодолоџија*, НИП Студентски збор, Скопје, 2002;

Климовски Саво, *Усџавно ѓраво и џолиџички сисџем*, Просветно дело, Скопје 2006;

Ковачевип-Куштримовип Радмила, Лазип Мирослав, *Увод у ѓраЈјанско ѓраво*, Гип Пунта, Ниш, 2008;

Живковска Родна, *Оџшџ дел на ѓраџанскоџо ѓраво*, “Европа 92” Кочани, Скопје, 2011;

Павлова Марил, *Гоажданско ѓраво, обиџџа часџ*, Софил, 2002;

Обичајното право на македонскиот народ, Македонска академија на науките и уметностите, Скопје, 2000;

Гризо Наум, Гелевски Симеон, Давитковски Борче, Павловска Данева Ана, *Админисџраџивно ѓраво*, Скопје, 2008;

Ravnic Anton, *Osnove radnog prava - domaceg, usporednog, medzunarodnog*, Pravni fakultet, Zagreb;

Weiss Manfred, *Labour law and Industrial Relations in Germany*, Deventer, 1987; Durand Paul, *Traite de droit du travail*, II, Paris, 1950;

Старова Гзиме, *Трудово Право*, Просветно дело АД Скопје, 2009;

Спировиќ-Трпеновска Љиљана, *Семејно право*, Скопје, 2004;

Спировиќ-Трпеновска Љиљана, *Наследно право*, Скопје, 2009;

Мицковиќ Дејан, *Семејството во Европа XV!-XXI век*, Културна установа Блесок, Скопје, 2008;

Чавдар Кирил, *Коментар на Законот за семејството*, Академик, Скопје, 1998;

Чавдар Кирил, *Коментар на Законот за наследувањето*, Академик, Скопје, 1996;

Живковска Родна, *Субјективитетот на физичките лица во граѓанското право*, Скопје 2008;

Станковиќ О., Водинелип В.В., *Увод у граѓанско право (ието неизмењено издање)*, Београд, Номос, 2007;

Попов Д., *Граѓанско право, оштии део, ието измењено и доуњено издање*, Нов Сад, 2007;

В.В. Водинелип, *Права личности*, Југословенски преглед бр. 11/83;

Спировиќ -Трпеновска Љиљана, *Семејно право*, Скопје, 2004;

Спировиќ - Трпеновска Љиљана, *Наследно право*, Скопје, 2009;

Мицковиќ Дејан, *Семејството во Европа X//1-XXI век*, Културна установа Блесок, Скопје, 2008;

Чавдар Кирил, *Коментар на Законот за семејството*, Академик, Скопје, 1998;

Чавдар Кирил, *Коментар на Законот за наследувањето*, Академик, Скопје, 1996;

Камбовски Владо, *Казнено право-ошш дел*, четврто изменето и дополнето издание, Скопје, 2011;

Камбовски Владо, *Казнено право-йосебен дел*, четврто дополнето издание, Скопје, 2003;

Камбовски Владо, *Кривичен законик (интегрален текст) иредговор, крајки објаснувања и рејисар на йоими*, Скопје 2011

Камбовски Владо, *Коментар на Кривичниот законик на Република Македонија*, Скопје, 2011;

Камбовски Владо, *Судско право*, Скопје, 2010;

Арнаудовски Љупчо, *Судски менаџмент*, Скопје 2011;

Гавроска Поликсена, Дескоски Тони, *Меѓународно приватно право*, Скопје, 2011

Фрчкоски Д Љубомир, Георгиевски Сашо, Петрушевска Татјана, *Меѓународно јавно право*, Табернакул, 2011 година

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë numër 52/1991;

Ligji për nënshtetësinë, Gazeta zyrtare e RM, numër 67/1992;

Ligji për marrëdhëniet obligative, Gazeta zyrtare e RM, numër 18/2001;

Ligji për kuvendin, Gazeta zyrtare e RM, numër 104/2009.

PËRMBAJTJA

| | |
|-----------------|---|
| PARATHËNIE----- | 3 |
|-----------------|---|

KAPITULLI I

| | |
|---|---|
| Lënda dhe metodat----- | 5 |
| 1. Lënda e disiplinës mësimore - shkencore – bazat e të drejtës----- | 5 |
| 2. Metoda për studimin e shtetit dhe të drejtës----- | 7 |
| 3. Llojet e metodave ----- | 9 |

KAPITULLI II

| | |
|---|----|
| Krijimi i shtetit----- | 14 |
| 1. Krijimi i shtetit----- | 14 |
| 2. Qasjet e ndryshme në aspekt të krijimit të shtetit ----- | 19 |
| 3. Qasja filozofike----- | 19 |
| 4. Qasja juridike----- | 20 |
| 5. Qasja sociologjike----- | 21 |
| 6. Krijimi i shtetit te popuj të caktuar ----- | 22 |

KAPITULLI III

| | |
|--|----|
| Shteti në sistemin politik të shoqërisë ----- | 24 |
| 1. Vendi i shtetit në sistemin politik ----- | 24 |
| 2. Ndikimi reciprok i shtetit dhe i të drejtës ----- | 24 |

KAPITULLI IV

| | |
|--|----|
| Regjimi politik----- | 26 |
| 1. Regjimi politik (nocioni) ----- | 26 |
| 2. Llojet e regjimit politik ----- | 26 |
| 3. Regjimi politik jodemokratik (absolutist)----- | 27 |
| 4. Demokracia (nocioni) ----- | 29 |
| 5. Demokracia indirekte dhe e drejtpërdrejtë ----- | 29 |
| 6. Institucionet themelore të demokracisë përfaqësuese ----- | 30 |
| Sistemet zgjedhore në demokracinë përfaqësuese ----- | 31 |
| 1. Demokracia e drejtpërdrejtë----- | 32 |
| 2. Referendumi ----- | 33 |

KAPITULLI V

| | |
|--|-----------|
| Karakteristika të shtetit ----- | 38 |
| 1. Përgjithësisht për karakteristikat e shtetit ----- | 38 |
| 2. Territori si karakteristikë e shtetit ----- | 38 |
| 3. Popullata si karakteristikë e shtetit ----- | 41 |
| Mënyrat e përfitimit dhe humbjes së nënshtetësisë ----- | 42 |
| 4. Pushteti publik si karakteristikë e shtetit ----- | 43 |
| Sovraniteti i pushtetit shtetëror ----- | 44 |
| Funksionet e shtetit (nocioni) ----- | 46 |
| Pikëpamjet e ndryshme për funksionet e shtetit ----- | 47 |
| a. Pikëpamja teologjike ----- | 47 |
| b. Pikëpamja analitike ----- | 47 |
| c. Pikëpamja analitike-historike----- | 48 |
| ç. Pikëpamja analitike-juridike ----- | 48 |

KAPITULLI VI

| | |
|---|-----------|
| Format e shtetit ----- | 51 |
| 1. Nocioni shëf i shtetit ----- | 51 |
| 2. Monarkia (nocioni) ----- | 52 |
| 3. Llojet e monarkive ----- | 53 |
| 4. Republika ----- | 55 |
| 5. Llojet e republikave ----- | 56 |
| 6. Format e rregullimit shtetëror (nocioni rregullimi shtetëror) ----- | 59 |
| 7. Shteti unitar ----- | 60 |
| 8. Shteti i përbërë ----- | 62 |
| 9. Federata ----- | 62 |
| 10. Konfederata ----- | 64 |
| 11. Protektorati ----- | 65 |

KAPITULLI VII

| | |
|--|-----------|
| Organizimi shtetëror ----- | 68 |
| 1. Nocioni dhe parimet e organizimit shtetëror ----- | 68 |
| 2. Parimet e organizatës shtetërore ----- | 69 |
| 3. Organin shtetëror (nocioni dhe karakteristika) ----- | 69 |
| 4. Llojet e organeve shtetërore ----- | 70 |
| 5. Organet e pushtetit ligjvënës ----- | 71 |

| | |
|---|----|
| 6. Parlamenti (Kuvendi) ----- | 71 |
| 7. Organet e pushtetit ekzekutiv-politik ----- | 71 |
| 8. Shefi i shtetit (prijësi shtetëror) ----- | 72 |
| 9. Këshilli i ministrave (Qeveria) ----- | 72 |
| 10. Organet e pushtetit gjyqësor----- | 73 |
| 11. Organet vetëqeverisëse lokale ----- | 75 |
| 12. Klasifikimi sipas llojit dhe mënyrës së zbatimit të veprimtarisë së organeve shtetërore ----- | 75 |
| 13. Organet e armatosura dhe civile ----- | 75 |
| 14. Llojet e organeve të armatosura ----- | 76 |
| 15. Organet zgjedhore dhe jozgjedhore ----- | 77 |
| 16. Organet politike, burokratike dhe ideologjike ----- | 77 |
| 17. Organet vendimmarrëse dhe ekzekutive ----- | 78 |
| 18. Organet shtetërore kolektive dhe individuale ----- | 79 |

KAPITULLI VIII

| | |
|---|----|
| Sundim i të drejtës----- | 83 |
| 1. Sundim i të drejtës (nocioni) ----- | 83 |
| 2. Origjina dhe kuptimi i termit drejtësi ----- | 86 |
| 3. Nocioni dhe karakteri i të drejtës ----- | 87 |

KAPITULLI IX

| | |
|--|-----|
| Rendi juridik ----- | 95 |
| 1. Rendi juridik (nocioni dhe elementet) ----- | 95 |
| 2. Nocioni dhe elementet e normës juridike ----- | 96 |
| 3. Hipoteza (supozimi) ----- | 96 |
| 4. Dispozicioni (llojet e dispozicioneve) ----- | 97 |
| 5. Cenim i të drejtës (delikti) ----- | 100 |
| 6. Sanksioni ----- | 101 |
| 7. Interpretim i të drejtës (nocioni) ----- | 102 |
| 8. Llojet e interpretimeve të normave juridike ----- | 103 |
| 9. Interpretimi i organeve shtetërore ----- | 103 |
| 10. Interpretimi i subjekteve joshtetërore ----- | 107 |
| 11. Interpretimi shkencor i normave juridike ----- | 107 |
| 12. Sistemi i të drejtës (nocioni) ----- | 109 |
| 13. Elementet e sistemit juridik----- | 110 |
| 14. Instituti juridik ----- | 111 |

| | |
|--|-----|
| 15. Dega juridike ----- | 112 |
| 16. E drejta kushtetuese ----- | 112 |
| 17. E drejta administrative ----- | 113 |
| 18. E drejta gjyqësore ----- | 114 |
| 19. E drejta penale ----- | 116 |
| 20. E drejta civile ----- | 117 |
| 21. E drejta personale dhe familjare ----- | 119 |
| 22. E drejta tregtare ----- | 119 |
| 23. E drejta e punës ----- | 123 |
| 24. E drejta ndërkombëtare ----- | 125 |

KAPITULLI X

| | |
|---|-----|
| Aktet juridike ----- | 130 |
| 1. Akti juridik (nocioni) ----- | 130 |
| 2. Llojet e akteve juridike ----- | 130 |
| 3. Burimet formale të së drejtës (llojet e akteve të përgjithshme juridike) ----- | 132 |
| 4. Kushtetuta ----- | 132 |
| A) Marrëveshja e Ohrit ----- | 134 |
| B) Arsyet socio-politike për krizën politike dhe të sigurisë në Republikën e Maqedonisë ----- | 135 |
| C) Amendamentet kushtetuese nga viti 2001 ----- | 137 |
| 5. Ligji ----- | 138 |
| 6. Aktet juridike nënligjore ----- | 140 |
| Dispozita ----- | 141 |
| Urdhëresa ----- | 143 |
| Rregullorja ----- | 143 |
| Udhëzimi ----- | 144 |
| Vendimi ----- | 144 |
| Dekreti ----- | 145 |
| 7. Burimet e veçanta të së drejtës (burime juridike për plotësimin e zbrazëtirave juridike) ----- | 146 |
| 8. Aktet individuale juridike ----- | 147 |
| 9. Llojet e akteve individuale juridike ----- | 148 |
| Akti administrativ ----- | 149 |
| Akti gjyqësor ----- | 150 |

| | |
|---|------------|
| 10. Kushtetutshmëria dhe ligjshmëria ----- | 151 |
| <i>Plotfuqishmëria dhe zbatueshmëria</i> ----- | 153 |

KAPITULLI XI

| | |
|--|------------|
| Marrëdhëniet juridike ----- | 160 |
| 1. Marrëdhëniet juridike (nocioni) ----- | 160 |
| 2. Elementet e marrëdhënies juridike ----- | 161 |
| 3. Autorizimi juridik ----- | 161 |
| 4. Detyrimi juridik (obligimi, detyra) ----- | 165 |
| 5. Paraqitja, ndryshimi dhe ndërprerja e marrëdhënieve juridike ----- | 165 |
| 6. Gjendjet juridike ose statusi juridik ----- | 167 |
| 7. Objekti i marrëdhënies juridik ----- | 167 |
| 8. Faktet juridike ----- | 168 |

KAPITULLI XII

| | |
|--|------------|
| Subjektet e të drejtës ----- | 171 |
| 1. Nocioni për subjektet e të drejtës ----- | 171 |
| 2. Personi fizik dhe juridik ----- | 172 |
| 3. Modalitetet juridike (nocioni) ----- | 178 |
| PËRKUJTUESI ----- | 181 |
| LITERATURA E SHFRYTËZUAR: ----- | 185 |
| PËRMBAJTJA ----- | 188 |